EUROPEAN CENTRE FOR MINORITY ISSUES KOSOVO

CLARD

Doracak Ligjorë

Grupet e cënuara dhe të margjinalizuara në Kosovë

Pravni Priručnik

Ugrožene i marginalizovane grupe na Kosovu

A Legal Handbook

Vulnerable and Marginalised Groups in Kosovo

Working Towards a Stable Multi-Ethnic Kosovo



Enhancing the Positive Impact of the Law for Vulnerable and Marginalised Groups in Kosovo
An EU-funded project managed by the European Commission Liaison Office

Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e ECMI Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Ova publikacija je napravljena uz pomoć Evropske Unije. Sadržaj ove publikacije je isključiva odgovornost ECMI Kosovo i ne predstavlja stavove Evropske Unije.

This publication has been produced with the assistance of the European Union. The contents of this publication are the sole responsibility of ECMI Kosovo and can in no way be taken to reflect the views of the European Union.

Të drejtat e autorit
© Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave – ECMI Kosova, dhjetor 2012. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthyeshëm apo të përdoret në ndonjë formë apo mënyrë tjetër, elektronike, mekanike, të fotokopjimit, dhe incizimit, jashtë marrëveshjes paraprake me ECMI KosovënAutorska prava

Autorska prava
© Evropski centar za pitanja manjina, Kosovo (ECMI Kosovo), decembar 2012. godine. Sva prava zadržana. Nijedan deo ove publikacije ne sme se reprodukovati,čuvati u sistemu ili se prenositi u ma kojem obliku ili na bilo koji način, elektronski, mehanički, fotokopiranjem, snimanjem ili drugačije, bez prethodnog odobrenja ECMI Kosovo.

Copyright
© European Centre for Minority Issues Kosovo (ECMI Kosovo), December 2012. All rights reserved. No part of this publication may be reproduced, stored in retrieval system or transmitted in any form or by any means, electronic, mechanical, photo-copying, recording or otherwise, without the prior permission of ECMI Kosovo.

RRETH NESH

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) në Kosovë

ECMI Kosova avancon marrëdhëniet në mes të shumicës dhe minoriteteve nëpërmjet mbrojtjes dhe promovimit të komuniteteve minoritare dhe interesave të tyre, me qëllimin e përgjithshëm për të zhvilluar institucione përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, të cilat mbështesin një Kosovë shumetnike të qëndrueshme.

ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimi i legjislacionit relevant dhe praktikave të mira në qeverisje, dhe mbështet institucionalizimin e organeve qeveritare relevante për komunitetet , ndërsa ngrit kapacitetet e përfaqësuesve të komuniteteve nga shoqëria civile, partitë politike dhe qeveria që të angazhohet me njëri-tjetrin në një mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

ECMI Kosova angazhohet në projekte të orientuara nga veprimi që synojnë stabilizimin e marrëdhënieve ndëretnike në periudhën e tranzicionit në Kosovë, dhe në mbështetjen e qeverisë në zhvillimin e praktikave efektive marrëdhëniet në mes të shumicës dhe pakicave. Duke punuar ngushtë me autoritetet e Kosovës, palët e interesuara nga minoritetet dhe agjencitë ndërkombëtare, ECMI ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e politikave për të drejtat e minoriteteve dhe komunitetet gjatë dekadës së kaluar. ECMI Kosova tani fokusohet në stabilizimin e tranzicionit në pavarësi në Kosovë dhe për të siguruar që zotimet ndaj pakicave do të zbatohen në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive.

Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD)

Misioni i CLARD është që të promovojë dhe të mbrojë të drejtat e njeriut, me qëllim të veçantë për të lehtësuar qasje më të mirë në drejtësi të individëve të cenueshëm, për vendosjen e sundimit të ligjit dhe për të nxitur përfshirjen sociale dhe ekonomike të segmenteve të margjinalizuar të popullsisë.

Stafi i CLARD paraqet një profil shumetnik me të kuptuar të thellë të shoqërisë së Kosovës dhe të kornizës ligjore dhe ekonomike, dhe është përfshirë në disa projekte, përfshirë:

- Ofrimin e ndihmës juridike dhe sociale dhe të këshillave personave të zhvendosur brenda vendit, refugjatëve, të kthyerve, minoriteteve dhe grupeve të cenueshme;
- Aktivitete pasuese dhe zhvillimin e sistemit juridik, sidomos në fazën e zbatimit të ligjeve të ndryshme, dhe
- Organizimin e fushatave publike o dhe trajnimeve në qëllim të ngritjes së vetëdijes së popullsisë, sidomos në fushën e ligjit dhe çështjeve sociale.

ECMI Kosovo I ecmikosova.org I info@ecmikosova.org I +381 (0) 38 224 473
CLARD I www.clardkosovo.org I clardkosovo@gmail.com I +381 (0)38 223 759

O NAMA

Evropski centar za pitanja manjina (ECMI) Kosovo

ECMI Kosovo unapređuje većinsko-manjinske odnose putem zaštite i unapređenja manjinskih zajednica i njihovih interesa, sa glavnim ciljem da se razviju inkluzivne, reprezentativne i prema zajednicama orjentisane institucije koje podržavaju multi-etničko Kosovo.

ECMI Kosovo doprinosi razvoju, jačanju i sprovođenju relevantnog zakonodavstva i najboljih praksi u vladavini i podržava institucionalizaciju vladinih organa koji se odnose na zajednice, i povećava kapacitete pripadnika zajednice iz civilnog društva radi međusobnog angažovanja na konstruktivan i održiv način.

ECMI Kosovo je angažovan na projektima orjentisanim ka delovanju koji imaju za cilj da stabiliziju među etničke odnose u period tranzicije na Kosovu i podržava Vladu u stvaranju efektivnih praksi u većinsko-manjinskim odnosima. Tesno sarađujući sa kosovskim vlastima, partnerima iz manjinskih zajednica i međunarodnim agencijama, ECMI je imao značajnu ulogu u razvoju prava manjina i politike prema zajednica,a tokom proteklih deset godina. ECMI Kosovo se danas usredsređuje na stabilizaciju tranzicije ka nezavisnosti na Kosovu in a obezbeđivanje da će obaveze prema manjinama biti sprovedene na održiv i učinkovit način.

Centar za pravnu pomoć i regionalni razvoj (CLARD)

Zadatak CLARD –a je da promoviše i štiti ljudska prava, sa posebnim osvrtom na olakšavanja boljeg pristupa pravdi ugroženih pojedinaca, uspostavljanje vladavine zakona i jačanje socijalnog i ekonomskog uključivanja marginalizovanih delova stanovništva.

Zaposleni CLARD-a predstavljaju multi-etnički profil sa dubokim shvatanjem kosovsksog društva i njegovim pravnim i ekonomskim okvirom i uradili su nekoliko projekata, uključujući:

- Pružanje pravne i socijalne pomoći i savetovanja interno raseljenimlicima, izbeglicama, povratnicima, manjinama i ugroženim grupama
- Aktivnosti praćenja i razvoja pravnog sistema, posebno u fazi sprovođenja različitih zakona; i
- Organizovanje javnih kampanja i obuke sa ciljem podizanja svesti stanovništva , posebno u oblastima zakona i socijalnih pitanja.

ECMI Kosovo I ecmikosova.org I info@ecmikosova.org I +381 (0) 38 224 473
CLARD I www.clardkosovo.org I clardkosovo@gmail.com I +381 (0)38 223 759

ABOUT US

European Centre for Minority Issues (ECMI) Kosovo

ECMI Kosovo advances majority-minority relations through the protection and promotion of minority communities and their interests, with the overarching aim to develop inclusive, representative, community-sensitive institutions that support a stable multi-ethnic Kosovo.

ECMI Kosovo contributes to the developing, strengthening and implementation of relevant legislation and best practices in governance and supports the institutionalisation of communities-related governmental bodies, while it enhances the capacity of community representatives from civil society, political parties and the government to engage with one another in a constructive and sustainable way.

ECMI Kosovo engages in action-oriented projects that aimed at stabilising inter-ethnic relations in the transition period in Kosovo and supporting the government in generating effective practices in majority-minority relations. Working closely with the Kosovo authorities, minority stake-holders and international agencies, ECMI has had a significant role in developing minority rights and community policy over the past decade. ECMI Kosovo now focuses on stabilising the transition to independence in Kosovo and on ensuring that commitments to minorities will be implemented in a sustained and effective way.

Centre for Legal Aid and Regional Development (CLARD)

The mission of CLARD is to promote and protect human rights, with a particular view to facilitating a better access to justice to vulnerable individuals, to the establishment of rule of law and to foster social and economic inclusion of marginalised segments of the population.

CLARD staff presents a multi-ethnic profile with a deep understanding of Kosovo society and its legal and economical framework and has been committed to several projects, including:

- Providing legal and social assistance and counselling to internally displaced persons, refugees, returnees, minorities and vulnerable groups;
- Follow-up activities and development of legal system especially in stage of implementation of different laws; and
- Organisation of public campaigns and trainings in purpose of raising the awareness of population especially in the field of law and social issues.

ECMI Kosovo I ecmikosova.org I info@ecmikosova.org I +381 (0) 38 224 473
CLARD I www.clardkosovo.org I clardkosovo@gmail.com I +381 (0)38 223 759

Përmbajtja

KAPITULLI 1. Hyrje 16
KAPITULLI 2. Barazia dhe jo-diskriminimi 17
2.1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës 17
2.2 Ligji Kundër Diskriminimit 18
2.3 Udhëzimi Administrativ nr. 04/2006 për Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit 20
2.4 Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane 20
2.5 Rastet gjyqësore 21
2.5 Konkluzione dhe rekomandime 23
KAPITULLI 3. Çështjet gjinore 25
3.1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës 25
3.2 Ligji për Familjen 25
3.3 Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 26
3.4 Ligji për Barazi Gjinore 27
3.5 Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare 28
3.6 Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane 28
3.7 Rast studimor 32
3.8 Konkluzione dhe rekomandime 33
KAPITULLI 4. Personat me aftësi tw kufizuara 35
4.1 Kushtetuta 35
4.2 Ligji për Aftësimin, Riaftësimin, Rehabilitimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara 35
4.3 Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë 37
4.4 Ligji për Përkrahje Materiale Familjeve me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme 38
4.5 Ligji për Personat e Verbër 38
4.6 Ligji i Punës 39
4.7 Udhëzimi Administrativ nr. 2/2003 për prezantimin e të miturve dhe personave me aftësi të kufizuara mendore në Media 39
4.8 Udhëzimi Administrativ nr. 09/2004 për procedurat e paraqitjes së kërkesës për pension të aftësisë së kufizuar 40
4.9 Udhëzimi Administrativ nr. 15/2004 për zbatimin e pensioneve për persona me aftësi të kufizuara 40
4.10 Udhëzimi Administrativ nr. 07/2010 dhe 03/2009 mbi kompletimin e udhëzuesit administrativ për përcaktimin e procedurave zbatuese për realizimin e aë drejtës në ndihmë materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme 40
4.11 Strategjia dhe plani i veprimit për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës 2009-2011 dhe Plani kombëtar I veprimit për persona me aftësi të kufizuara 40

4.12 Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane 41
4.13 Rastet 44
4.14 Konkluzione dhe rekomandime 45
KAPITULLI 5 Komunitetet minoritare 47
5.1 Kushtetuta 47
5.2 Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë 48
5.3 Ligji për Vetëqeverisje Lokale 49
5.4 Ligji për Përdorimin e Gjuhëve 50
5.5 Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës 53
5.6 Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës 54
5.7 Udhëzimi Administrativ për zbatimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë dhe rishikimi i ndryshimeve për sa i përket Rastit: gjuha Rome me elemente te historisë dhe kulturës, nr. 7/2010 54
5.8 Udhëzimi mbi përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e gjuhëve Nr 2007/06 54
5.9 Rregullorja e Qeverisë Nr 07/2012 mbi Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve 55
5.10 Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009 – 2013 55
5.11 Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas në Republikën e Kosovës, 2009 – 2015 55
5.12 Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane 56
5.13 Rastet 59
5.14 Konkluzione dhe rekomandime 60
KAPITULLI 6. Të kthyerit dhe personat e riatdhesuar 62
6.1 Kushtetuta 62
6.2 Ligji për ripranim 62
6.3 Rregullorja nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim 62
6.4 Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009 – 2013 62
6.5 Strategjia e Rishikuar e Kosovës për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar 64
6.6 Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane 64
6.7 Konkluzione dhe rekomandime 68
CHAPTER 7. Institucionet 69
7.1 Institucionet e nivelit qendror 69
7.1.1 Ministria e Drejtësisë 69
7.1.2 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale 69
7.1.3 Ministria për Komunitete dhe Kthim 71

7.1.4 Zyra për Qeverisje të Mirë 72
7.1.5 Zyra për Çështje të Komuniteteve 72
7.1.6 Këshilli Konsultativ për Komunitete 73
7.2 Institucionet e nivelit komunal 73
7.2.1 Njësia Komunale të Drejtat e Njeriut 73
7.2.2 Zyrtari Komunal për Barazi Gjinore 73
7.2.3 Komiteti Komunal për Komunitete 74
7.2.4 Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim 74
7.2.5 Zëvendës-Kryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete 74
7.2.6 Nënkryetari i Komunës për Komunitetet 75
7.2.7 Qendra për Punë Sociale 75
7.3 Institucionet e pavarura 75
7.3.1 Reformimi i Sistemit Gjyqësor të Kosovës - Ligji për Gjykatat 75
7.3.2 Këshilli Gjyqësor i Kosovës 76
7.3.3 Gjykata Kushtetuese 77
7.3.4 Gjykata Supreme 77
7.3.5 Gjykatat e Qarkut 77
7.3.6 Gjykatat Komunale 78
7.3.7 Këshilli Prokurorial i Kosovës 78
7.3.8 Oda e Avokatëve të Kosovës 78
7.3.9 Instituti Gjyqësor i Kosovës 79
7.3.10 Komisioni për Ndihmë Juridike 79
7.3.11 Policia e Kosovës 79
7.3.12 Agjencia Kosovare e Pronës 79
7.3.13 Avokati i Popullit 80

Sadržaj

POGLAVLJE 1. Uvod 82
POGLAVLJE 2. Jednakost i nediskriminacija 83
2.1 Ustav republike Kosovo 83
2.2 Zakon protiv diskrimnacije 83
2.3 Administrativno uputstvo br.04/2006 o primeni zakona protiv diskriminacije 85
2.4 Međunarodno i evropsko zakonodavstvo i standardi 86
2.5 Slučajevi 87
2.6 Zaključci i preporuke 88
POGLAVLJE 3 Pitanja polova 90
3.1 Ustav Republike Kosovo 90
3.3 Zakon o Porodici 90
3.3 Zakon o zaštiti od nasilja u porodici 91
3.4 Zakon o ravnopravnosti polova 92
3.5 Zakon o socijalnim i porodičnim uslugama 93
3.6 Međunarodno i evropsko zakonodavstvo i standardi 93
3.7 Ispitivanje slučaja 97
3.8 Zaključci i preporuke 97
POGLAVLJE 4. Osobe sa ograničenim sposobnostima 99
4.1 Ustav 99
4.2 Zakon o stručnim sposobnostima, rehabilitaciji i zapošljavanju osoba sa invaliditetom 99
4.3 Zakon o invalidskim penzijama na Kosovu 101
4.4 Zakon o materijalnoj pomoći porodicama dece sa trajnim ograničenim sposobnostima 102
4.5 Zakon o slepim licima 102
4.6 Zakon o radu 103
4.7 Uputstvo br.2/2003 o predstavljanju maloletnika i osoba sa mentalnim ograničenim sposobnostima u medijima 103
4.8. Uputstvo br.09/2004 o procedurama podnošenja zahteva za penzionisana lica sa invaliditetom 104
4.9 Uputstvo br. Zakon 15/2004 o sprovođenju penzija za osobe sa invaliditetom 104
4.10 Uputstvo br.07/2010 do 03/2009 o završetku upravnih smernica za utvrđivanje odredbi i procedura za ostvarivanje materijalne pomoći porodicama sa decom sa trajno ograničenim sposobnostima 104
4.11 Strategija i akcioni plan za ljudska prava u Republici Kosovo 2009-2011 i nacionalni akcioni plan za lica sa ograničenim sposobnostima 104
4.12 Međunarodno i evropsko zakonodavstvo i standardi 105

4.13 Slučajevi 108
4.14 Zaključci i preporuke 108
POGLAVLJE 5 Manjinske zajednice 111
5.1 Ustav 111
5.2 Zakon o zaštiti i unapređenju prava zajednica i njenih pripadnika na Kosovu 111
5.3 Zakon o lokalnoj samoupravi 113
5.4 Zakon o upotrebi jezika 114
5.5 Zakon o obrazovanju u opštinama Republike Kosova 116
5.6 Zakon o osnovnom i srednjem obrazovanju u Republici Kosovo 117
5.7 Uputsvo za sprovođenje akcionog plana za integraciju zajednice RAE i pregled promena na slučaju: Romski jezik sa elementima kulture i istorije, br.7/2010 117
5.8 Uputstvo o utvrđivanju procedura za sprovođenje Zakona o upotrebi jezika, Br. 2007/06 117
5.9 Uredba Vlade Br. 07/2012 o Kancelariji Komesara Jezika 118
5.10 Strategija za zajednice i povratak 2009-2013 118
5.11 Strategija za integraciju zajednice Roma, Aškalija i Egipćana u Republici Kosovo, 2009-2015 118
5.11 Međunarodno i evropsko zakonodavstvo i standardi 119
5.12 Slučajevi 122
5.13 Zaključci i preporuke 123
POGLAVLJE 6 Povratnici i lica vraćena u domovinu 125
6. 1 Ustav 125
6.2 Zakon o readmisiji 125
6.3 Odredba br. 02/2010 o opštinskim kancelarijama za zajednice i povratak 125
6.4 Strategija za zajednice i povratak 2009-2013 125
6.5 Revidirana strategija Kosova za reintegraciju lica vraćenih u domovinu 126
6.6 Međunarodno i evropsko zakonodavstvo i standardi 127
6.7 Zaključci i preporuke 130
POGLAVLJE 7. Institucije 131
7.1. Institucije na centralnom nivou 131
7.1.1 Ministarstvo pravde 131
71.2 Ministarstvo rada i socijalne zaštite 131
7.1.3 Ministarstvo za zajednice i povratak 133
7.1.4 Kancelarija za dobro upravljanje 133
7.1.5 Kancelarija za pitanja zajednica 134
7.1.6 Savetodavno Veće za zajednice 134

7.2 Institucije na opštinskom nivou 135
7.2.1 Opštinska jedinica za ljudska prava.....135
7.2.2 Opštinski službenik za pitanja rodne ravnopravnosti 135
7.2.3 Opštinski odbor za zajednice 135
7.2.4 Opštinska kancelarija za zajednice i povratak.....136
7.2.5 Zamenik predsedavajućeg skupštine opštine za zajednice.....136
7.2.6 Zamenik gradonačelnika za zajednice.....136
7.2.7 Centar za socijalni rad 136
7.3 Nezavisne institucije 136
7.3.1 Reforma pravosudnog sistema Kosova – Zakon o sudovima 136
7.3.2 Sudski savet Kosova 138
7.3.3 Ustavni sud.....138
7.3.4 Vrhovni Sud.....139
7.3.5 Okružni sudovi 139
7.3.6 Opštinski sudovi 139
7.3.7 Tužilački Savet Kosova 139
7.3.8 Advokatska komora Kosova 140
7.3.9 Kosovski insitut za pravosuđe 140
7.3.9 Komisija za pravnu pomoć 140
7.3.10 Kosovska policija 140
7.3.11 Kosovska agencija za imovinu 141
7.3.12 Zaštitnik građana/Ombudsman 141

Table of Contents

CHAPTER 1. Introduction 143
CHAPTER 2. Equality and Non-Discrimination 144
2.1 The Constitution of the Republic of Kosovo 144
2.2 The Anti-Discrimination Law 145
2.3 Administrative Instruction No.04/2006 on Implementation of the Anti-Discrimination Law 146
2.4 International and European Legislation and Standards 147
2.5 Cases 148
2.5 Conclusions and Recommendations 150
CHAPTER 3. Gender Issues 152
3.1 Constitution of the Republic of Kosovo 152
3.2 Law on Family 152
3.3 Law on Protection Against Domestic Violence 153
3.4 Law on Gender Equality 154
3.5 Law on Social and Family Services 155
3.6 International and European Legislation and Standards 155
3.7 Case Study 159
3.8 Conclusion and Recommendations 160
CHAPTER 4. People with Disabilities 162
4.1 Constitution 162
4.2 Law on Vocational Ability, Rehabilitation and Employment of People with Disabilities 162
4.3 Law on Disability Pensions in Kosovo 164
4.4 Law on Material Support for Families of Children with Permanent Disability 165
4.5 Law for Blind Persons 165
4.6 Law on Labour 166
4.7 Instruction no.2/2003 on Introduction of Minors and People with Mental Disabilities in Media 166
4.8 Instruction no.09/2004 on the Procedures of Application for Retired Persons with Disabilities 167
4.9 Instruction no. Law 15/2004 on the Implementation of Pensions for Disabled Persons 167
4.10 Instruction no.07/2010 to 03/2009 Completion of Administrative Guidance for Determining the Regulation and Application Procedures for the Realization of Material Support for Families with Children with Permanent Disabilities 167
4.11 Strategy and Action Plan for Human Rights in the Republic of Kosovo 2009-2011 and National Action Plan for Persons with Disabilities 167
4.12 International and European Legislation and Standards 168

4.13 Cases 171
4.14 Conclusion and Recommendations....171
CHAPTER 5. Minority Communities 174
5.1 Constitution 174
5.2 Law on the Protection and Promotion of the Rights of Communities and their Members in Kosovo 174
5.3 Law on Local Self Government....176
5.4 Law on the Use of Languages....177
5.5 Law on Education in the Municipalities of the Republic of Kosovo 180
5.6 Law on Pre-University Education in the Republic of Kosovo 180
5.7 Instruction for the Implementation of the Action Plan for the Integration of the RAE Communities and Review of Changes to the Case: Roma Language with Elements of Culture and History, nr.7/2010 181
5.8 Instruction on Determination of Procedures for Implementation of Law on the Use of Languages, No. 2007/06....181
5.9 Government Regulation Nr 07/2012 on the Office of the Language Commissioner....181
5.10 Strategy for Communities and Returns 2009-2013 182
5.11 Strategy for the Integration of Roma, Ashkali and Egyptian Communities in the Republic of Kosovo, 2009-2015 182
5.12 International and European Legislation and Standards....183
5.13 Cases 186
5.14 Conclusion and recommendations 187
CHAPTER 6. Returnees and Repatriated Persons 189
6.1 Constitution 189
6.2 Law for Readmission 189
6.3 Regulation No. 02/2010 for the Municipal Offices for Communities and Return 189
6.4 Strategy for Communities and Returns 2009-2013 189
6.5 Kosovo Revised Strategy for Reintegration of Repatriated Persons....190
6.6 International and European Legislation and Standards....191
6.7 Conclusion and Recommendation 194
CHAPTER 7. Institutions....196
7.1. Central-Level Institutions....196
7.1.1 Ministry of Justice 196
7.1.2 Ministry of Labour and Social Welfare....196
7.1.3 Ministry for Communities and Returns....198
7.1.3 Office on Good Governance....198

7.1.4 Office for Community Affairs 199
7.1.5 Consultative Council for Communities 199
7.2 Municipal-Level Institutions 200
7.2.1 Municipal Human Rights Unit 200
7.2.2 Municipal Officer for Gender Equality 200
7.2.3 Municipal Committee for Communities 200
7.2.4 Municipal Office for Communities and Returns 201
7.2.5 Deputy Chairperson of the Municipal Assembly for Communities 201
7.2.6 Deputy Mayor for Communities 201
7.2.7 Centre for Social Work 201
7.3 Independent Institutions 202
7.3.1 Reforming the Kosovo Judicial System – The Law on Courts 202
7.3.2 Kosovo Judicial Council 203
7.3.3 Constitutional Court 204
7.3.4 Supreme Court 204
7.3.5 District Courts 204
7.3.6 Municipal Courts 204
7.3.7 Kosovo Prosecutorial Council 205
7.3.8 Kosovo Chamber of Advocates 205
7.3.9 Kosovo Judicial Institute 205
7.3.9 Legal Aid Commission 205
7.3.10 Kosovo Police 206
7.3.11 Kosovo Property agency 206
7.3.12 Ombudsperson 206

Doracak Ligjorë:

Grupet e cënuara dhe të margjinalizuara në Kosovë

KAPITULLI 1. Hyrje

Ky doracak ligjor është produkt i punës së Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) në Kosovë, në bashkëpunim me Qendrën për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD). Ai është pjesë e projektit "Rritja e ndikimit pozitiv të ligjeve për grupet e rrezikuara dhe të margjinalizuara (GRM-të) në Kosovë", financuar nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Ky projekt është implementuar gjatë viteve 2011 – 2012, me qëllim të rritjes së ndikimit pozitiv të ligjit për personat nga që u takojnë GRM-ve në Kosovë. Në përputhje me këtë objektiv, janë implementuar disa aktivitete, përfshirë ofrimin e ndihmës juridike falas GRM-ve nëpërmjet klinikave juridike, që gjenden në tërë Kosovën, sjellja para gj0ykatave e disa rasteve gjyqësore strategjike (p.sh. rastet me interes të gjerë shoqëror) dhe avokimit-(përkrahjes) së synuar dhe fushatave të vetëdijesimit.

Ky projekt-doracak do të ofrojë një pasqyrë fillestare dhe vlerësim të kuadrit ligjor dhe institucional ekzistues për mbrojtjen e GRM-ve në Kosovë. Si i tillë doracaku do të shërbejë si dokument udhëzues për stafin e projektit, por gjithashtu mund të përdoret nga profesionistët e tjerë që kanë të bëjnë me GRM-të në Kosovë. Dokumenti do të finalizohet në fund të projektit nga fundi i vitit 2012, kur të gjitha përvojat dhe njohuritë e fituara përmes implementimit të projektit do të përfshihen në këtë dokument.

Ky doracak bazohet në përvojën e fituar gjatë dy viteve të implementimit të projektit dhe ofron një pasqyrë dhe vlerësim të kornizës ligjre dhe institucionale për mbrojtjen e GRM-ve që ekziston në Kosovë. Ndonëse ky dokument synon të jetë gjithëpërfshirës, ai nuk synon të jetë ezaurues. GRM-të konsistojnë nga grupe të shumëllojshme që përballen me një gamë të gjerë problemesh që janë çdoherë në ndryshim e sipër dhe të cilat është vështirë të përfshihen në një publikim të vetëm. Sidoqoftë, shpresojmë që ky doracak të shërbejë si bazë e mirë fillestare për profesionistë (ligjorë apo të tjerë) që merren me GRM në Kosovë.

Doracaku është i strukturuar si në vijim: ai ndahet sipas katër llojeve të GRM-ve – gratë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet minoritare, si dhe të kthyerit dhe personat e riatdhesuar. Për secilin grup Doracaku ofron një vështrim të përgjithshëm të dispozitave kushtetuese, si dhe të legjislacionit primar e sekondar, udhëzimeve administrative dhe dokumenteve të tjera të zbatueshme në Kosovë. Një kapitull i veçantë i dedikohet Ligjit Kundër Diskriminimit, një çështje kjo 'horizontale' për të gjitha GRM-të. Në fund është ofruar një vështrim mbi institucionet më të rëndësishme përgjegjëse për trajtimin e GRM-ve.

Pyetjet dhe komentet mirëpriten dhe mund të drejtohen te:
Lars Burema
Menaxher i Projektit – ECMI Kosovo
Rruga Nëna Terezë 41/29
Prishtinë, Kosovë
Email: burema@ecmikosova.org
Tel. +381 (0) 38 224 473

KAPITULLI 2. Barazia dhe jo-diskriminimi

2.1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës është bazohet, ndër të tjera, në parimet e barazisë[1] dhe mos-diskriminimit[2], përfshirë barazinë e të gjithë individëve para ligjit[3], barazinë gjinore[4], të drejtën për mbrojtje të barabartë ligjore, pa diskriminimin[5], mbrojtjen e barabartë të të drejtave në procedura para gjykatave[6], mundësitë e barabarta për arsimim për të gjithë[7], barazinë efektive në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve[8], qasje të barabartë në gjykata[9] dhe qasje të barabartë në drejtësi.[10]

Për më tepër, Kushtetuta përcakton qartë se "askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinionit politik ose tjetër, origjinës kombëtare ose shoqërore, lidhjes me cilindo komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal."[11] Përveç kësaj, për të siguruar barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve, Kushtetuta inkurajon miratimin e masave adekuate, (p.sh. diskriminimin pozitiv) në favor të grupeve të rrezikuar dhe të margjinalizuar në shoqëri.[12]

Përveç kësaj, neni 22 parasheh zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare të specifikuara aty[13], dhe neni 53 parasheh se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë interpretohen në harmoni me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

[1] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 3.2, 7, 24.1, 24.3, 31.1, 37.2, 45.2, 47.2, 50.2, 58.4, 71.2, 101.1, 102.2, 104.2, 108.2, 108.4, 109.4, 110.1, 110.3, 114.3, 119.2, 123.2.
[2] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7.1, 24.1, 24.2, 57.2, 58.3, 58.4, 58.7, 59.13.
[3] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 3.2.
Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7.2.
[5] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 24.1.
[6] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 31.1.
[7] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 47.2.
[8] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 58.4.
[9] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 102.2.
[10] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 110.1.
[11] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 24.2.
[12] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 24.3.
[13] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22 liston të gjitha instrumentet ligjore ndërkombëtare të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht: Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj, Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventën kundër Torturës dhe Trajtimit e Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese.

2.2 Ligji Kundër Diskriminimit

Me qëllim të harmonizimit të legjislacionit vendor me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 2004/32 Kundër Diskriminimit (në tekstin e mëtejmë, "LKD") më 30 korrik 2004.[14]

Sipas shumicës së studiuesve, ekspertëve dhe raporteve për të drejtat e njeriut, LKD i Kosovës është një nga më të avancuarat e këtij lloji në Evropë.[15] Ai synon që të shërbejë për tri funksione kryesore. Së pari, ai konsolidon dhe forcon dispozitat tashmë ekzistuese për mbrojtjen e barazisë në Kosovë duke e bërë këtë në pajtueshmëri me standardet adekuate ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian. Së dyti, ai promovon uniformitetin në gjykimin e një shumëllojshmërie të formave të diskriminimit për një shumëllojshmëri të grupeve të rrezikuar, përfshirë pakicat etnike, fetare dhe gjuhësore, gratë dhe fëmijët, personat e zhvendosur brenda vendit, personat me aftësi të kufizuara, etj. Së fundmi, ai siguron mjete kompensuese juridike dhe administrative për viktimat e çfarëdo forme të diskriminimit dhe një sistem të sanksioneve për të adresuar shkeljet, si në sektorin publik, ashtu edhe atë privat.[16]

LKD bazohet në tri parime: parimin e trajtimit të barabartë, të përfaqësimit të drejtë dhe mirëkuptimit, dhe atë të tolerancës ndëretnike.[17] Ndonëse LKD bazohet në dy Direktivat kryesore Evropiane – Direktivën 2000/43/EC të Këshillit të Bashkimit Evropian, të 29 qershorit 2000, dhe Direktivën 2000/78/EC të Këshillit, të 27 nëntorit 2000 – ajo ofron mbrojtje më të gjerë dhe efektivisht me gamë të gjerë. Ndërsa direktiva e parë promovon trajtim të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht nga prejardhja racore ose etnike, LKD përfshin ndalimin e diskriminimit në çfarëdo baze, bazuar në nenin 21 (1) të Kartës së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore.[18] Ngjashëm, direktiva e fundit parasheh trajtimin e barabartë në punësim dhe profesione, ndërsa LKD shkon më tej duke ndaluar diskriminimin në qasjen dhe gëzimin e të drejtave të përcaktuara me ligjet në fuqi.[19] Për më tepër, është i ndaluar diskriminimi në bazë të një ose disa bazave, për shembull, një grua rome mund të pretendojnë se është diskriminuar në bazë të gjinisë ose origjinës etnike, apo të dyjave.[20]

Neni 3 përmban një shpjegim të qartë të formave të ndryshme të diskriminimit. Përveç diskriminimit të drejtpërdrejtë, si lloji më klasik i diskriminimit, LKD gjithashtu mbron kundër diskriminimit të tërthortë.[21] Megjithatë, nëse një dispozitë, kriter apo praktikë justifikohet objektivisht nga një synim legjitim dhe mjet për ta bërë atë janë të përshtatshme, nuk mund të konsiderohet diskriminim i tërthortë.[22] Neni 3

[14] Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, *Raport – Zbatimi i Ligjit Kundër Diskriminimit* (janar 2007) fq. 4.
[15] Raport i OSBE Kosovës, *Implementing the Anti-Discrimination Law: A Challenge for Kosovo* (2007) fq .42.
[16] Raport i OSBE Kosovës, *Implementing the Anti-Discrimination Law: A Challenge for Kosovo* (qershor 2007) fq. 4.
[17] Ligji Kundër Diskriminimit, Neni 2.
[18] Karta e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, Nice, (Dhjetor 2000).
[19] Fabian, Gregory. *Implementation of the Anti-Discrimination Law in Kosovo: A Plan in Need of Execution*. (Janar 2006); Ligji nr. 2004/3, Nenet 2(a) dhe neni 4.
[20] Raport i OSBE Kosovës, *Implementing the Anti-Discrimination Law: A Challenge for Kosovo* (qershor 2007) fq. 27.
[21] Ligji Kundër Diskriminimit nr. Nr. 2004/3, Neni 3 (b).
[22] Ibid.

gjithashtu përcakton forma të tjera të diskriminimit, të tilla si ngacmimi, udhëzimi për të diskriminuar, viktimizimi dhe segregimi.[23]

Neni 4 diskuton fushëveprimin e zbatimit. Ai ndalon çfarëdo veprimi ose mosveprimi i cili shkel të drejtat e cilitdo personi fizik apo juridik ndaj të drejtave që mbrohen nga LKD dhe çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me ligjet në fuqi.[24] Me synimin për të siguruar barazi të plotë në praktikë, ligji gjithashtu thekson mund të ndërmerren veprime pozitive në favor të grupeve të rrezikuar dhe të margjinalizuar, dhe se kjo nuk duhet të konsiderohet si diskriminim.[25] Përveç kësaj, personat që ushtrojnë funksione publike duhet të sigurojnë që kontratat, kreditë e grantet publike, ose përfitime të tjera të këtij lloji, të jepen në përputhje me LKD, ose përndryshe do të shpallen të pavlefshme nga organi që i ka dhënë.[26]

Në aspektin e procedurave dhe sanksioneve, ligji ofron disa mundësi disa të ndjekur një kërkesë, qoftë përmes organeve administrative ose përmes gjykatave të juridiksionit kompetent.[27] Për më tepër, ligji u ofron viktimave një mënyrë të mundshme për të dëshmuar diskriminimin; ai parasheh zhvendosjen e barrës së provës në rastet civile, sapo që të vendoset një rast *prima facie*, duke kërkuar se "i mbetet të padituri që të dëshmojë se ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë."[28] Për më tepër, një dëshmi e tillë mund të krijohet edhe me anë të dëshmive statistikore.[29]

Sa u përket sanksioneve, LKD përcakton kompensim për dëme materiale dhe jo-pasurore, si dhe gjoba monetare, të cilat do të vendosen në një fond që duhet të themelohet me qëllim të financimit të ndihmës juridike falas për personat fizikë ose juridikë të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat për trajtim të barabartë të parapara me këtë ligj. Megjithatë, organi përkatës administrativ apo gjyqësor mund të imponojë çfarëdo sanksionesh të tjera që janë në dispozicion sipas cilitdo ligji tjetër të zbatueshëm në Kosovë.[30]

LKD gjithashtu autorizon Ombudspersonin e Kosovës që të pranojë dhe të hetojë ankesa në lidhje me shkeljet e të drejtave që kanë për bazë diskriminimin.[31] LKD, në parim, ka përparësi ndaj të gjitha ligjeve të mëparshme në të njëjtën fushë; megjithatë, dispozitat e ligjeve të tjera në fuqi ende janë të vlefshme dhe duhet të zbatohen në qoftë se janë më të favorshme se dispozitat e LKD-së.[32]

[23] Ibid., Neni 3.
[24] Ligji Kundër Diskriminimit, Nr. 2004/3, Neni 4.
[25] Ibid., Neni 6.1.
[26] Ibid., Neni 6.2; 6.3.
[27] Ibid., Neni 7.
[28] Ibid., Neni 8.1.
[29] Ligji Nr. 2004/3, Neni 8.2; D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (Numri i rastit: 57325/00), Aktgjykim i Dhomës së Madhe, i datës 13 nëntor 2007.
[30] Ligji Kundër Diskriminimit, Nr. 2004/3, Neni 9.2; 9.4 dhe 9.6.
[31] Ligji Kundër Diskriminimit, Nr. 2004/3, Neni 10.
[32] Ligji Kundër Diskriminimit, Nr. 2004/3, Neni 11.

2.3 Udhëzimi Administrativ nr. 04/2006 për Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit

Në maj të vitit 2006, Kryeministri i Kosovës miratoi Udhëzimin Administrativ nr. 04/2006 për Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit.[33] Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është që të përcaktojë rregullat praktike, lehtësirat strukturore dhe fizike për zbatimin e LKD-së dhe që të promovojë trajtimin e barabartë të të gjithë personave, pa diskriminim mbi çfarëdo baze.[34] Kuptimi i saktë i këtyre rregullave praktike, dhe lehtësirave strukturore e fizike është dhënë në nenin 2.

Udhëzimi mbush në zbrazësi në kapitullin III të Ligjit Kundër Diskriminimit dhe identifikon organet përgjegjëse për promovimin e trajtimit të barabartë, të cilat janë Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Njësitë për të Drejtat e Njeriut në kuadër të ministrive.[35] Ngjashëm, ai kërkon themelimin e një Divizioni për të Drejtat e Njeriut në kuadër të Zyrës për Qeverisje të Mirë, me qëllim të lehtësimit të realizimit të detyrave të përcaktuara me këtë Udhëzim.[36]

Zyra për Qeverisje të Mirë do të përgatisë, publikojë dhe shpërndajë informata në lidhje me institucionet përkatëse ku viktimat e supozuara të diskriminimit mund të paraqesin ankesat e tyre dhe të ndjekin procedurat për dorëzimin e ankesave të tilla në këto institucione dhe në gjykatat kompetente.[37] Së fundmi, Zyra për Qeverisje të Mirë është bërë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Udhëzimi Administrativ.[38]

2.4 Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut[39] (KEDNj) dhe protokollet e saj, drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë përmes nenit 22 të Kushtetutës, trajton anti-diskriminimin nëpërmjet nenit 14, i cili ndalon diskriminimin në bazë të, ndër të tjera, seksit, racës, origjinës kombëtare ose sociale, përkatësisë një minoriteti kombëtar apo ndonjë statusi tjetër.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se neni 14 parasheh një 'të drejtë të ndërlidhur' në barazi në gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga KEDNj. Prandaj, neni 14 nuk mund të përdoret më vete, por vetëm 'në ndërlidhje me' të drejtat substanciale.[40] Kjo është riafirmuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) në *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*[41], ku Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 14 të Konventës (diskriminimi mbi bazën e origjinës etnike) në ndërlidhje me nenin 2 të Protokolli nr. 1 (e drejta për arsimim), ku dëshmitë statistikore kishin treguar se një numër disproporcional i fëmijëve romë ishin vendosur në shkolla të veçanta. Kushtetuta, më tej, i

[33] Zyra e Kryeministrit, Kosovë, Zyra për Qeverisje të Mirë. Raport (janar – qershor 2006) mbi aktivitetet në fushën e anti-diskriminimit, anti-korrupsionit, anti-trafikimit me qenie njerëzore dhe të drejtat e njeriut. fq. 6.
[34] Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2006 për Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit, Neni 1.
[35] Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2006, Neni 3 dhe 4.
[36] Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2006, Neni 5.
[37] Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2006, Neni 6.
[38] Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2006, Neni 8.
[39] Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në dispozicion në http://www.echr.coe.int/NR/rdonlyres/D5CC24A7-DC13-4318-B457-5C9014916D7A/0/Convention_ENG.pdf
[40] Interights. Non-Discrimination in International Law – A Hdhebook for Practitioners. (2011). fq. 22, 40.
[41] Dhoma e Madhe e GjEDNj-së. D.H. dhe Others v the Czech Republic (Numri i rastit: 57325/00). 13 Nëntor 2007.

obligon gjykatat kombëtare që dispozitat për të drejtat e njeriut t'i interpretojnë në përputhje me vendimet e GjEDNj-së.[42]

Duke njohur nevojën për një të drejtë 'të pavarur' për të forcuar mbrojtjen nga KEDNj të barazisë, në nëntor 2000 u nënshkrua Protokolli nr. 12, dhe hyri në fuqi më 1 prill 2005.[43] Neni 1 i Protokollit nr. 12 është kështu dispozitë 'e ndarë' që ndalon diskriminimin në gëzimin e çfarëdo të drejte ose përfitimi sipas ligjit kombëtar ('çfarëdo të drejte të paraparë me ligj'), përveç të drejtave të parapara në KEDNj.

Ngjashëm, direktivat si burim sekondar i legjislacionit të BE-së, promovojnë barazinë dhe ndalojnë diskriminimin mbi baza të ndryshme.[44] Në mesin e tyre, Direktiva për Barazi Racore (2000/43/EC)[45], dhe Direktiva Kornizë për Barazi në Punësim (2000/78/EC)[46], ndonëse jo ligjërisht të detyrueshme në Kosovë, kanë shërbyer si referenca kryesore për hartimin e Ligjit Kundër Diskriminimit Kosovës.[47]

Përveç KEDNj-së, neni 22 i Kushtetutës parasheh zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të një numri të marrëveshjeve dhe instrumenteve të tjerë ndërkombëtarë të cilët përmbajnë dispozita mbi barazinë dhe mos-diskriminimin, përkatësisht Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut[48], Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj[49], Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare[50], Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor[51], Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave[52], Konventën për të Drejtat e Fëmijës[53] dhe Konventën kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Mizor, Çnjerëzor apo Degradues.[54]

2.5 Rastet gjyqësore

Viktimat e supozuara të formave të ndryshme të diskriminimit u kanë paraqitur rastet e tyre një numri gjykatash vendore; megjithatë, gjykatat kanë dhënë zakonisht aktgjykime në bazë të ligjeve të tjera në fuqi, duke injoruar pretendimin për diskriminim, duke shfaqur kështu mungesë të mundshme të njohurive mbi Ligjin Kundër Diskriminimit apo mungesa të gatishmërisë për të njohur praktika të tilla. Dy rastet e paraqitura në vijim janë shembuj të rasteve të tilla.

[42] Kushtetuta, Neni 53.
[43] Protokolli Nr. 12. Në dispozicion në http://www.echr.coe.int/NR/rdonlyres/D5CC24A7-DC13-4318-B457-5C9014916D7A/0/Convention_ENG.pdf
[44] Evelyn Ellis, EU Anti-discrimination Law. (2005). Oxford University Press. fq. 14. http://fds.oufq.com/www.oufq.co.uk/pdf/0-19-926683-2.pdf fq.18
[45] Direktiva 2000/43, OJ [2000] L180/22.
[46] Direktiva 2000/78, OJ [2000] L303/16.
[47] Broshurë e OSBE-së, Implementing the Anti-Discrimination Law: A Challenge for Kosovo (qershor 2007) fq. 27.
[48] Universal Declaration of Human Rights. Nenet 1, 7, 10, 16(1), 21(2) 23.2, 26(1).
[49] International Covenant on Civil dhe Political Rights, Nenet 3, 4.1, 14.1, 20.2, 23.4, 24.1, 25(c), 26.
[50] Council of Europe Framework Convention for the Protection of National Minorities, Nenet 4.1, 4.3, 6.2, 9.1, 9.2, 12.3.
[51] Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination, Nenet 1.1, 1.3, 1.4, 2.1(a), 2.1 (b), 2.1(c), (d), 2.2, 4(a), 4(b), 4(c), 5(a), 5(c), 5(e)(i), 5(e)(vi), 6, 7.
[52] Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination Against Women, Nenet 1, 2(a), 2(b), 2(c), 2(d), 2(e), 2(f), 2(g), 3, 4.1, 4.2, 7, 8, 9.1, 9.2, 10(a), 11.1(d), 11.2(a), 12.1, 13, 14.2(e), 14.2(g), 15.1, 15.2, 16.1, 23.
[53] Convention on the Rights of the Child, Nenet 2.1, 2.2, 28, 29.1(d), 31.2, 40(2)(b)(iv).
[54] Convention against Torture dhe Other Cruel, Inhumane or Degrading Treatment or Punishment, Nenet 1.1.

Arjeta Halimi kundër Komunës së Vitisë, Gjykata Kushtetuese – Lënda nr. KI 36/11, 30 shtator 2011[55]

Parashtruesja e kërkesës ishte nxënëse e shkollës së mesme, e cila u përjashtua nga Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës" në Viti sepse po mbante veshur shami islamike. Parashtruesja e kërkesës pretendonte, ndër të tjera, shkeljen e së drejtës së saj kushtetuese për arsimim (Neni 47), lirisë për manifestimin e fesë (neni 38) dhe mos-diskriminimin në bazë të fesë (Neni 24).

Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën e parashtrueses të papranueshme me arsyetimin se ajo nuk i kishte shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore dhe se faktet e paraqitura nuk justifikonin pretendimet e një shkeljeje të së drejtës kushtetuese. Prandaj, edhe pse në këtë rast kishte diskriminim të pretenduar *de jure* dhe *de facto*, gjykata nuk dha asnjë argument thelbësor për çështjen e diskriminimit. Për më tepër, pasi shpalli rastin të papranueshëm, gjykata procedoi me diskutimin e meritave të rastit, në të cilin i referohej jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut se shtetet laike mund të ndalojnë praktikën e veshjes së shamisë islamike në shkolla[56]; megjithatë, edhe në këtë diskutim Gjykata Kushtetuese nuk hyri në thelbin e pretendimit të diskriminimit.

Ćemailj Kurtiši kundër Komunës së Prizrenit, Gjykata Kushtetuese – Rasti nr. KO 01/09, 18 mars 2010[57]

Z. Kurtishi, Zëvendës-Kryesues për Komunitete i Kuvendit Komunal të Prizrenit, paditi Komunën me pretendimin se stema, e cili përbëhet nga shtëpia e Lidhjes së Prizrenit, rrethuar me formulimin "1878 – Prizren", ishte diskriminuese ndaj pjesëtarëve të komuniteteve minoritare. Ai theksoi se stema madhëron vetëm identitetin e komunitetit shqiptar, duke injoruar karakterin shumetnik të Prizrenit.

Gjykata Kushtetuese urdhëroi Komunën që të ndryshonte Statutin e vet dhe stemën. Gjykata vuri në dukje se neni 7 i Statutit të Komunës, i cili imponon një simbol që nuk mund të konsiderohet si simbol të përbashkët i të gjitha komuniteteve të Prizrenit, shkel nenet 3 (barazinë para ligjit), 7,1 (vlerat që mbron Kushtetuta), 58 (Përgjegjësitë i Shtetit) dhe 59 (Të Drejtat e Komuniteteve dhe të Pjesëtarëve të tyre) të Kushtetutës. Gjykata theksoi se Statuti duhet t'u mundësojë të gjitha komuniteteve që të ruajnë identitetin e tyre nën një simbol të përbashkët, d.m.th stemën. Stema, që përbën shprehjen më të fuqishme të identitetit të të gjitha komuniteteve, duhet të paraqesë simbolin e një shoqërie shumetnike, që përfaqëson komunitetet shumicë dhe ato jo-shumicë, dhe duhet të promovojë frymën e tolerancës, dialogut dhe pajtimit në mes të komuniteteve.

Ndonëse këto dispozita theksojnë barazinë dhe mos-diskriminimin, gjykata asnjëherë nuk u shpreh drejtpërdrejt nëse neni 7 i Statutit të Komunës apo vetë janë diskriminuese ndaj pjesëtarëve të minoriteteve që jetojnë në Prizren.

[55] Në dispozicion në http://www.gjk-ks.org/repository/docs/KI_36_11_ang.pdf
[56] Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, *Ligji Kundër Diskriminimit nw Kosovw – shtatw vjet pas* (Dhjetor, 2011) fq. 173.
[57] http://www.gjk-ks.org/repository/docs/ko_01_09_Ven_ang.pdf

2.5 Konkluzione dhe rekomandime

Përkundër cilësisë së lartë të dispozitave dhe sanksioneve që përmban, LKD mbetet tipi "ligji në letër".[58] Prandaj ka **nevojë urgjente që qeveria të shtojë përpjekjet e saj për të siguruar zbatimin e LKD-së;** pothuaj nuk ka asnjë rast para gjykatave vendore që thirret në dispozitat e LKD-së[59], dhe gjyqtarët janë ose të painformuar mbi ekzistencën e tij, ose kanë një mungesë të përgjithshme të ekspertizës mbi anti-diskriminimin, duke i bërë ata të hezitojnë të aplikojnë dispozitat e tij. Përveç kësaj, gjyqësori i Kosovës vazhdon të vuajë nga një numër shumë i madh i rasteve të grumbulluar, gjë që shkakton përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes së viktimave të diskriminimit.

Prandaj **rekomandohet që të themelohet një organ kuazi-gjyqësor** – ose që një organi ekzistues t'i jepet autoritet i qartë – që të vendosë mbi rastet e anti-diskriminimit dhe që të jetë në gjendje të nxjerrë vendime ligjërisht të detyrueshme që reflektojnë praktikat e mira evropiane.[60] Përmes një organi të tillë kuazi-gjyqësor do të sigurohej që rastet e diskriminimit të trajtohen me shpejtësi dhe nga gjykatësit me ekspertizë adekuate në fushën e anti-diskriminimit.

Aktualisht ka pështjellim në lidhje me organet e përfshira në zbatimin e ligjit. Kapitulli II, mbi procedurat ankimore dhe sanksionet, vetëm parasheh që "një organ administrativ i cili ka konstatuar se ka ndodhur shkelja e këtij ligji mund të shqiptojë sanksione". Megjithatë, Ligji nuk përcakton asgjë rreth procedurave për ngritjen dhe procedimin e ankesave, cilit organi administrativ duhet t'i dorëzohen, dhe në të çfarë afatesh kohore. Ligji duhet të ndryshohet për të sqaruar procedurat e tij, veçanërisht në lidhje me përgjegjësitë e organeve administrative dhe procedurat përkatëse. Organi i sipërpërmendur kuazi-gjyqësor mund të përmirësojë ndjeshëm paqartësitë e gjendjes aktuale në këtë aspekt.

Sipas LKD-së, organi i cili duhej të ishte përgjegjës për administrimin e kompensimit është **Qendra për Trajtim të Barabartë**[61], e cila kurrë nuk është krijuar, e as nuk përmendet më tej në dispozitat e mëpastajme të LKD-së.[62] Kur ishte hartuar LKD, Ombudspersoni kishte kundërshtuar idenë që kësaj qendre t'i jepeshin kompetenca që dyfishojnë ato të Institucionit të Ombudspersonit.[63] Rrjedhimisht, Neni 9.5 duhet të ndryshohet për të qartësuar atë se cili institucion (ekzistues) është përgjegjës për administrimin e fondit të mbledhur bazuar në nenin 9.2. (b).

Udhëzimi Administrativ nr. 04/2006 mbi Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit **përmban gabime të shumta drejtshkrimi dhe terminologjike në versionin e tij në serbisht**[64], gjë që rezulton në shkelje të ligjit për zbatimin e të cilit është hartuar. Versioni në serbisht i këtij Udhëzimi Administrativ duhet të ndryshohet në mënyrë që saktësisht të përputhet me versionin në shqip.

[58] UNION-Federata e Shoqatave tw PZHBV-ve, *Kosovo under Security Council Resolution 1244* (Tetor 2008) fq. 14.
[59] Raport i OSBE Kosovës, *Implementing the Anti-Discrimination Law: A Challenge for Kosovo* (Qershor 2007) fq.36.
[60] Shihni, për shembull Ireland's Equality Tribunal: http://www.equalitytribunal.ie/
[61] Ligji nr. 2004/3, Neni 9.5.
[62] OSBE, *Implementation Measures for Legislation Impacting Human Rights in Kosovo* (Shtator 2012) fq. 16.
[63] Raport i OSBE Kosovës, *Implementing the Anti-Discrimination Law: A Challenge for Kosovo* (Qershor 2007) fq. 35.
[64] Raport i OSBE Kosovës, *Implementing the Anti-Discrimination Law: A Challenge for Kosovo* (Qershor 2007) fq. 33.

Për më tepër, mbrojtja e plotë ligjore që ofrojnë dispozitat e këtij ligji për viktimat e diskriminimit nuk është pasuar nga mekanizma adekuatë të zbatimit[65], ndonëse Qeveria ka miratuar "Planin gjithëpërfshirës për zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit për vitet 2005 – 2007", ky plan veprimi nuk është azhurnuar akoma. Qeveria duhet të miratojë një plan të ri veprimi për zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit për periudhën 2013 – 2015, i cili të marrë parasysh të gjitha çështjet e ngritura më sipër në këtë doracak.

[65] Raport i OSBE Kosovës, *Implementing the Anti-Discrimination Law: A Challenge for Kosovo* (Qershor 2007) fq. 34.

KAPITULLI 3. Çështjet gjinore

3.1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Kosovës ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, dhe është dokumenti më i lartë i rendit juridik në Kosovë. Ajo mishëron barazinë gjinore si "vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, që ofron mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të tjera të jetës shoqërore".[66] Për më tepër, "të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me [...] marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare janë të garantuara me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe, në rast konflikti, kanë përparësi mbi dispozitat e ligjeve dhe aktet e tjera të institucioneve publike"[67]. Në mesin e marrëveshjeve dhe instrumenteve të tilla ndërkombëtare hyn një konventë që ka të bëjnë posaçërisht me çështjet gjinore, *Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË)*, si dhe llojet e mbrojtjes të përvijuara në *Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të të Njeriut dhe Protokollet e saj* (KEDNj) dhe *Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj* (KNDCP).[68]

3.2 Ligji për Familjen

Nën ombrellën e Kushtetutës, një nga dokumentet më të rëndësishme legjislative që rregullon të drejtat e grave është *Ligji për Familjen*, i cili mbron barazinë gjinore në kuadër të strukturës së familjes.

Paragrafi i parë i nenit 3 numëron parimet bazë të marrëdhënieve familjare, përfshirë "barazinë ndërmjet burrit dhe gruas, respektin dhe ndihmën e ndërsjellë ndërmjet tyre dhe anëtarëve të familjes".[69] Për më tepër, neni 4 thekson se "të gjithë personat gëzojnë trajtim të barabartë të të drejtave dhe detyrimeve të parapara me këtë Ligj. Nuk do të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj asnjë personi apo personave bazuar në gjini *[...]*"[70].

Sipas këtij ligji, gratë do të kenë të drejta të barabarta në çështjet personale dhe të pronës, dhe asnjë vendim nuk duhet të merret as të bëhet ndonjë ndryshim në lidhje me pronën e përbashkët, pa pëlqimin e shprehur të dy bashkëshortëve.[71] Sipas nenit 47, të dy bashkëshortët janë pronarë të barabartë të pasurisë së përbashkët.[72] Megjithatë, sipas këshilltarëve ligjorë të CLARD-it, pavarësisht nga ky status ligjor, barazia mbetet e pakapshme në praktikë: në rast të divorcit, gratë akoma shpesh

[66] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7.2.
[67] Ibid., Neni 22.
[68] Ibid., Neni 22 (Nenet 22.6, 22.2, 22.3). Marrëveshjet dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare përfshijnë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventën kundër Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Degradues.
[69] Ligji për familjen, Nr. 2004/32, neni 3.1.
[70] Ibid., neni 4
[71] Ibid., shih Seksionin IV) Marrëdhëniet pronësore të bashkëshortëve, nenet 45-58.
[72] Neni 47 u referohet të drejtave të të dy bashkëshortëve në pronën e fituar gjatë martesës, në mungesë të marrëveshjeve të tjera. Neni 58 gjithashtu përcakton se një grua dhe një burrë në një marrëdhënie jashtë-martesore kanë të drejta të barabarta ndaj pasurisë së fituar gjatë marrëdhënies së tyre.

humbasin më shumë se meshkujt dhe mund të kenë frikë të divorcohen për shkak të ndërgjegjësimit të ulët për të drejtat e tyre të pronësisë në një mjedis ku anëtarët meshkuj të familjes tradicionalisht kanë mbajtur të drejtat e pronësisë.

Ligji për Familjen gjithashtu vë theks të madh për sa i përket kujdesit të fëmijëve në rast divorci, kjo çështje është e rregulluar me nenin 139, i cili përcakton procedurat e ndërmarra kur vendoset se me kë do të jetojë fëmija/ët dhe çfarë kushte duhet të plotësohen. Megjithatë, puna në ofrimin e ndihmës juridike nga CLARD anekënd Kosovës ka konstatuar se vendimet e gjykatave lidhur me kujdestarinë e fëmijës nuk respektohen gjithmonë, veçanërisht nga baballarët.

3.3 Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

Ky ligj ka për qëllim parandalimin e të gjitha formave të dhunës në familje përmes masave të duhura ligjore për pjesëtarët e familjes që janë viktima të dhunës në familje, në veçanti fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Ky ligj nuk merret në mënyrë specifike me dhunën kundër grave; megjithatë, gratë janë veçanërisht të rrezikuara dhunës në familje, për shkak të statusit të tyre më të ulët socio-ekonomik në shoqëri.[73]

Neni 2, paragrafi 1.2 i ligjit jep një përkufizim gjithëpërfshirës të dhunës në familje, sipas së cilës 'dhuna në familje' nënkupton:

> "një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:
> 1.2.1. përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes;
> 1.2.2. çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike;
> 1.2.3. shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit;
> 1.2.4. sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;
> 1.2.5. ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;
> 1.2.6. përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qellim te përuljes se personit tjetër;
> 1.2.7. marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;
> 1.2.8. kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;
> 1.2.9. dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;
> 1.2.10. vënja e personit tjetër në pozitën qe ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike;
> 1.2.11. hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër;;
> 1.2.12. rrëmbimi."[74]

Ky ligj përshkruan hollësisht mënyrën dhe kohën kur një viktimë e dhunës në familje mund të paraqes kërkesën për urdhër mbrojtës të lëshuar nga gjykata, si dhe llojin e masave mbrojtëse që gjykata mund të përshkruajë në një urdhër të tillë mbrojtjeje.[75] E rëndësishme është se neni 15 thekson se gjykata

[73] Shikoni Raportin e OSBE-së, *Raport mbi dhunën në familje në Kosovë*, Korrik 2007, fq. 4
[74] Ligji për mbrojtje kundër dhunës në familje, Nr. 03/L-182, neni 2, paragrafi 1.2.
[75] Shih nenin 15. Për më tepër, neni 16 përshkruan kërkesat për urdhrin e gjykatës në rastet të jashtëzakonshme.

kompetente vendosë përkitazi me kërkesën për urdhër mbrojtjeje brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas pranimit të saj, ose brenda 24 orëve për një situatë emergjente[76]; megjithatë, në raste të shumta, të dhënat tregojnë se gjykatat as nuk kanë respektuar afatin prej 15 ditësh për lëshimin e urdhrave mbrojtës e as nuk u janë përgjigjur me shpejtësi kërkesave për urdhër të menjëhershëm (emergjent) mbrojtjeje.[77]

Sipas hulumtimit në terren, të kryer nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), gjatë periudhës kohore në mes të kërkesës dhe lëshimit të urdhrit për mbrojtje, bëhet më i madh rreziku për viktimën, që edhe një herë, t'i ekspozohet dhunës në familje.[78]

Është pra e qartë se dhuna në familje figuron në mesin e pengesave për gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe të lirisë për gratë në Kosovë. Përderisa Kosova ka ndërtuar një kuadër të avancuar ligjor, mbeten probleme të rëndësishme për sa i përket zbatimit të ligjit.

3.4 Ligji për Barazi Gjinore

Ligji kryesor për mbrojtjen dhe promovimin e barazisë gjinore në Kosovë është Ligji mbi Barazinë Gjinore, i cili përcakton barazinë gjinore si "pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat përkatëse të jetës shoqërore, status të barabartë, mundësi të barabarta për të drejtat e tyre dhe përdorimi i aftësive të tyre individuale për zhvillimin e shoqërisë dhe përfitim të barabartë nga rezultatet e një zhvillimi të tillë."[79] Ky ligj kërkon të "mbroj, trajtoj dhe vendos, barazinë ndërmjet gjinive si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë së Kosovës, duke siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fusha të tjera të jetës shoqërore."[80]

Sipas ligjit, barazia gjinore në pjesëmarrje arrihet kur pjesëmarrja e [çdo] "gjinie në institucione, organe ose në nivele të pushtetit është 40%"[81]. Në mënyrë që të arrihet ky synim, ligji parashikon se "zbatimi i masave ligjore dhe afirmative të vendos pjesëmarrjen e barabartë të femrave dhe meshkujve në legjislativ, ekzekutiv, organet gjyqësore të të gjitha niveleve dhe në institucionet publike, në mënyrë që pjesëmarrja e të dy gjinive në këto institucione të arrijë nivelin e saj të përfaqësimit të tyre në popullatën e përgjithshme të Kosovës."[82]

[76] Një urdhër i lëshuar me vendim gjykate ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën. Shih nenin 15.1 & nenin 16.1

[77] OSBE monitoroi dy raste në Prishtinë në 2008-2009 që përfshijnë vonesat gjyqësore në Kërkesat për urdhër mbrojtës, ku urdhrat mbrojtës janë dhënë gjashtë deri në nëntë javë pas dorëzimi të kërkesave, si dhe kanë monitoruar raste të shumta në Prizren në vitin 2009, ku janë vërejtur vonesa në lëshimin e vendimeve për urdhër mbrojtës emergjent jashtë afatit 24-orësh. Shih Raportin Mujor të Misionit të OSBE në Kosovës, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete: Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik, procedurat gjyqësore që përfshijnë dhunën në familje, shkurt 2009, faqe 5-6, ky raport mund te gjendet/shkarkohet në: http://www.OSBE.org/kosovo/40398

[78] Shih Raportin e Misioni të OSBE-së Departamenti për Decentralizim dhe Komunitete: Monitorimi i Sistemit Juridik në Kosovë, *Raport për rastet e dhunës në familje në Kosovë*, korrik 2007, faqe 8-9, në dispozicion në http://www.OSBE.org/kosovo/26282

[79] Ligji për barazi gjinore Nr. 2004/2 neni 2.1

[80] Ibid. Seksioni 1, paragrafi 1.1.

[81] Ibid. neni 3.2

[82] Ibid. neni 3.1 Sipas statistikave të UNIFEM, që nga viti 2008, në mbarë botën rreth 18% e anëtareve të parlamenteve kombëtare janë femra; dhe kjo do ti marr vendeve të zhvilluara 20 vite ndërsa te gjitha vendet e tjera rreth 40-vite për të arritur

Megjithatë, zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore përballet me sfida të shumta. Derisa është bërë progres në lidhje me përfaqësimin e grave në procesin e vendim-marrjes qeveritare, si dhe në punësim në institucionet publike dhe shtetërore, shteti ende duhet të ndërmarrë hapa konkret për të rritur përqindjen e grave të punësuara në sektorin privat[83]. Për më tepër, çështjet mbesin tek krijimi i një sistemi të rregullt të raportimit të shkeljeve të barazisë gjinore.

3.5 Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare

Ky Ligj përcakton dhe rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë në Kosovë: fushat në të cilat gratë, për shkak të pozitës së tyre socio-ekonomike në shoqëri, mund të mbeten veçanërisht të rrezikuara.

Shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë, siç përcaktohet në Nenin 1.3, kujdesin e drejtpërdrejtë social siç është ndihma me detyrat shtëpiake, lëvizshmërinë personale, ose komunikim, këshillim, ose në rrethana të jashtëzakonshme, asistencë materiale. Në mesin e grupit të përcaktuar si "njerëz në nevojë", janë ata që përballen me dhunën në familje, ata/ato që përballen me vështirësi të posaçme sidomos në marrëdhëniet familjare, dhe ata që janë në rrezik të dallueshëm shfrytëzimi, abuzimi apo trafikimi.

Edhe pse gratë nuk janë përmendur si një kategori e veçantë në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale, në praktikë, gratë në Kosovë ballafaqohen me sfida të veçanta si viktima të dhunës me bazë gjinore, që është tregues i nevojës për përkujdesje efektive sociale dhe një sistemi të mbështetjes.[84]

3.6 Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane

Rëndësia e mbrojtjes së të drejtave të grave dhe barazisë gjinore reflektohet në përpjekje të konsiderueshme ligjore të bëra në nivel ndërkombëtar dhe rajonal. Instrumentet përkatës kryesorë të së drejtës ndërkombëtare janë *Konventa* e Kombeve të Bashkuara *për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave* (CEDAW) si dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) Neni 14 për anti-diskriminim (e drejtë shtesë) dhe Nenin 1 të Protokollit 12 (dispozitë e pavarur).

Poashtu, janë me vlerë të përmenden Konventa e OKB mbi të Drejtat Politike të Grave dhe Deklarata e Vjenës dhe Programi i Veprimit të Konferencës Botërore të vitit 1993 për të Drejtat e Njeriut. Këto nuk janë ligjërisht të detyrueshme për Kosovën, por sigurojnë standarde ndërkombëtare të rëndësishme lidhur me të drejtat e grave.

---

nivelin e barazisë prej 40%-60% për sa I përket përfaqësimit të gruas në kuvendet kombëtare. Shih '*Progresi i Femrës në Botë 2008/2009*: Kush i përgjigjet femrës? Gjinia dhe Llogaridhënia', Kapitulli 2, faqe 17-34, në dispozicion në: http://www.unifem.org/gender_issues/democratic_governance/facts_figures.php

[83] Sipas një raporti të UNDP 2010 në Kosovë, natyra e sektorit privat në Kosovë është "kryesisht jozyrtare, të parregulluara dhe gjithnjë lufton për të ofruar punësim të besueshme, afatgjatë dhe të paguhen mirë". Shih Raportin e Zhvillimit Njerëzor në Kosovë, 2010, gjendet në:http://www.kosovo.undfq.org/repository/docs/HDR-2010-English.pdf. Statistikat mbi hendekun gjinor në mbarë botën hartuar nga UNIFEM-i në vitin 2008 tregojnë se gratë tentojnë të fitojnë më pak se sa burrat, dhe që të paguajë gjinore hendekun mes burrave dhe grave në përgjithësi është i madh në sektorin privat, në krahasim me sektorin publik. Kush i përgjigjet femrës? Gjinia & Llogaridhënia', Kapitulli 2, faqe 53-56.

[84] Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare, Nr. 02/L-17, Neni 12.1.

Më poshtë diskutohen më hollësisht dispozitat e këtyre ligjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe evropiane, në ndërlidhje me çështje specifike.

Barazia gjinore

Pjesa 1 e CEDAW fillon me një përkufizim autoritar për sa i përket diskriminimit ndaj grave, pra "çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e gjinisë, e që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë¸ ose të shfuqizojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga statusi i tyre martesor, mbi bazën e barazisë së burrave dhe të grave, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër"[85]. Megjithatë, shteti mban përgjegjësinë për zbatimin e masave të përshkruara nga CEDAW, për të siguruar që "në të gjitha fushat, në veçanti në fushat politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislacionin, për të siguruar zhvillimin e plotë dhe përparimin e grave , me qëllim që t'u garantojnë atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore mbi bazën e barazisë me burrat"[86].

KEDNJ dhe protokollet e saj përcaktojnë se gëzimi i ndonjë të drejte, duke përfshirë të drejtat dhe liritë e parashtruara në konventë nuk duhet të jenë subjekt diskriminimi në bazë të gjinisë.[87]

CEDAW shkon më tej në garantimin e lirisë së grave nga diskriminimi në të gjitha aspektet e jetës, veçanërisht në arsim (neni 10), punësim (neni 11)[88] dhe shëndetësi (neni 12). Këto nene përveç të drejtave të tjera, përmendin edhe të drejtën e grave të kenë qasje në trajnim, edukim (cilësor) dhe bursa, për të marrë pagesë të barabartë dhe përfitime sociale për punën e tyre, për t'u mbrojtur kundër diskriminimit dhe shkarkimit për shkak të sëmundjeve ose shtatzënisë, dhe të përfitojnë vëmendja të duhur mjekësore, sidomos gjatë shtatzënisë. Neni 14 shprehimisht pohon gjendjen shpeshherë të vështirë të grave që jetojnë në zonat rurale dhe bën thirrje për masa të veçanta dhe programet që duhet të zbatohen nga shteti në mënyrë që të sigurojnë që të drejtat e tyre janë të mbështetura.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i barazisë gjinore i mbrojtur në mënyrë specifike në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Politike të Grave është barazia në pjesëmarrjen politike pa diskriminim. Gratë kanë të "drejtë të votojnë në të gjitha zgjedhjet në kushte të barabarta me burrat"[89], ""Të drejtë për të zgjedhur në të gjitha organet e zgjedhura publike"[90] dhe "të drejtën për të mbajtur poste publike dhe për të ushtruar të gjitha funksionet publike, të përcaktuara nga ligji kombëtar, në

[85] CEDAW, neni 1
[86] Ibid., neni 3
[87] KEDNJ, neni 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe KEDNJ Protokoli 12, Neni 1.
[88] Shih gjithashtu nenin 119 të Paktit të Amsterdamit në lidhje me pagesë e barabartë për burrat dhe gratë.
[89] Konventa për të drejtat politike të grave, neni1.
[90] Ibid., neni 2.

kushte të barabarta me burrat"[91]. Për më tepër, shtetet e PNDCP-së (Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike) ne nenin 3 që shtetet palë/nënshkruese duhet të sigurojnë që burrat dhe gratë kanë të drejtë të barabartë në gjitha të drejtat civile dhe politike të përcaktuara në konventën e tij.

Prona

Përpjekjet e gjinisë femërore për të qenë pjesëmarrëse të barabarta në të drejtën pronësore kanë një histori të gjatë në mbarë botën. Ndërsa deri më sot asnjë instrument i së drejtës ndërkombëtare nuk i është përkushtuar në mënyrë specifike të drejtave të grave në pronë, dispozitat janë bërë në disa konventat ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian (BE) dhe disa marrëveshjeve për të mbrojtur këto të drejta. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut thekson me saktësi se "çdokush ka të drejtën për të poseduar pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkësi me të tjerët"[92]. Një parakusht themelor për të drejtat e pronësisë, kapacitetin ligjor dhe barazisë para ligjit, është thënë në mënyrë eksplicite ose shprehimisht, domethënë se: "Shtetet Palë i njohin gruas, në lëmin civil, zotësi juridike të njëjtë me atë të burrit dhe të njëjtat mundësi për të ushtruar këtë zotësi. Në veçanti, ato do t'i japin grave të drejta të barabarta për të lidhur kontrata dhe për të administruar pronën dhe do t'i trajtojnë ato në mënyrë të barabartë në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore"[93]. Kjo dispozitë përfshin edhe të drejtën e grave për "kredi bankare, hipoteka dhe forma të tjera të kredisë financiare"[94] që janë shpesh të domosdoshme për ta kthyer të drejtat pronësore në realitet.

Martesa, divorci dhe fëmijët

E drejta ndërkombëtare për familjen është ndjeshëm diskrete dhe procedurale; instrumentet kryesore kanë për qëllim të ofrojnë udhëzime për legjislacionin vendor dhe të lehtësojnë koordinimin ndërkombëtar; për shembull, *Konventa* e Kombeve të Bashkuara *mbi Pëlqimin për Martesë, Moshën Minimale për Martesë dhe Regjistrimin e Martesave* (nuk është ligjërisht e detyrueshme për Kosovën) thotë se "asnjë martesë nuk do të lidhet pa pëlqimin e plotë dhe të lirë të të dyja palëve, dhe një pëlqim i tillë shprehet nga palët personalisht, pas publicitetit të duhur dhe në praninë e autoritetit kompetent për ta bërë martesën solemne dhe të dëshmitarëve, siç është përcaktuara me ligj."[95]

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike gjithashtu i referohet, në nenin 23 të saj, të drejtës së burrave dhe grave të moshës së lejueshme martesore të martohen dhe të kenë familje. KEDNJ përmban një dispozitë të ngjashme në nenin 12, dhe gjithashtu thotë se "Bashkëshortët gëzojnë barazinë e të drejtave dhe përgjegjësive të karakterit të së drejtës private mes tyre, dhe në

[91] Ibid., neni 3. Në Evropën Qendrore dhe Lindore / CIS, në vitin 2008 një mesatare prej 29% e anëtarëve të kuvendeve në rajon kanë qenë ferma, që kanë ndryshuar në varësi të rajoneve nga 6-16%. Shih Raportin e UNIFEM-it "Kush i përgjigjet grave"? Gjinia & llogaridhënia (2008/2009), faqe 23.
[92] Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 17(1)
[93] CEDAW, neni 15.2.
[94] CEDAW, neni 13(b)
[95] *Konventa për Pëlqimin për Martesë, Moshën Minimale për Martesë dhe Regjistrimin e Martesave*, neni 1 (1). Konventa gjithashtu përcakton në nenin 2 se shtetet duhet "të marrin masa legjislative për të përcaktuar një moshë minimale për martesë. Ligjërisht asnjë martesë nuk duhet të lidhet nga ndonjë person nën këtë moshë, përveç në rastet kur një autoritet kompetent i ka dhënë një leje për moshën, për arsye të rënda, në interes të të martuarve "

marrëdhëniet e tyre me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe në rast të prishjes së saj."[96]

Nenit 17 i CEDAW riafirmon barazinë e burrave dhe grave për të hyr, për të rënë dakord dhe për ti dhënë fund martesës, në lidhje me kujdestarinë e fëmijës dhe mirëbesimin e fëmijës, dhe të drejtat personale, siç është e drejta për të mbajtur emrin e vet. Për më tepër, në përgjithësi sipas të drejtës ndërkombëtare është e kuptueshme se interesi i fëmijëve duhet të marrë prioritet mbi çështje të tjera, për shembull, CEDAW thekson rëndësinë e lindjes dhe të fëmijëve duke siguruar se "edukimi i familjes të përfshij të kuptuarit e duhur të maternitetit si një funksion social dhe të njohjes së përgjegjësisë së përbashkët të burrit dhe të gruas në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre duke bërë të qartë se interesi i fëmijëve është kusht kryesor në të gjitha rastet."[97]

Kështu, udhëzimet bazë për barazinë gjinore, mirëqenien e fëmijëve dhe të respektimit të vullnetit të lirë të dikujt për sa i përket martesës, divorcit dhe kujdestarisë së fëmijës mund të shihet si diçka që duhet të mbështetet nga e drejta ndërkombëtare dhe KEDNJ.

Dhuna ndaj grave

Instrumenti kryesor i ligjit ndërkombëtar në lidhje me dhunën ndaj grave është Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (nuk është ligjërisht e detyrueshme për Kosovën), i cili plotëson CEDAW. Neni i parë i Deklaratës jep një përkufizim shumë të përdorur për dhunën kundër grave, që thotë se "çdo akt i dhunës me bazë gjinore që rezulton, ose ka të ngjarë të rezultojë në dëmtim fizik, seksual ose psikologjik apo vuajtje për gratë, duke përfshirë edhe kërcënime për akte të tilla, detyrimin apo privimin arbitrar të lirisë, që ndodhin në jetë publike ose në jetën private"[98]. Duke vazhduar për më tepër me një listë të akteve të dhunës, duke përfshirë: "dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike që ndodhin në familje, duke përfshirë rrahjet, abuzimin seksual të fëmijëve femra në shtëpi, dhunë të ndërlidhur me prikë, përdhunimi martesor, gjymtimin gjenital femëror dhe të tjera praktikat tradicionale të dëmshme për gratë, dhunën jo bashkëshortore dhe dhuna në lidhje me shfrytëzimin."[99]

Kjo deklaratë thekson se shteti është aktori kryesor për të siguruar se të drejtat e grave janë duke u respektuar, dhe si i tillë është i obliguar që të mos "përdorë ndonjë zakon, traditë apo konsideratë fetare për të shmangur detyrimet e tyre në lidhje me eliminimin e saj"[100]. Neni 4 për më tepër përmend disa veprime dhe masat të mundshme për të arritur qëllimin e eliminimit të dhunës ndaj grave, ndër të cilat janë: "ushtrimi i kujdesit të duhur për të parandaluar, hetuar dhe, **në përputhje me legjislacionin kombëtar**, të dënojnë aktet e dhunës ndaj grave, nëse këto akte janë kryer nga shteti apo nga persona privatë" (Neni 4c), "përfshirja në buxhetin e qeverisë e burimeve të mjaftueshme për aktivitetet e tyre në lidhje me eliminimin e dhunës kundër grave" (neni 4n) dhe "lehtësimi dhe përmirësimi i punës së

[96] KEDNJ, Protokolli Nr. 7 (i ndryshuar me Protokollin Nr. 11), neni 5
[97] CEDAW, neni 5(b)
[98] *Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, neni* 1
[99] Ibid., neni 2a.
[100] Ibid., neni 4.

lëvizjeve të grave dhe organizatave jo-qeveritare dhe të bashkëpunimi me to në nivel lokal, nacional dhe rajonal" (neni 4p).

Përderisa luftimi i dhunës me bazë gjinore, veçanërisht asaj familjare, është i një rëndësie parësore për sa i përket agjendës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, një vëmendje adekuate që përputhet me këtë rëndësi nga Kosova është i domosdoshëm.[101]

3.7 Rast studimor

ECMI Kosova, në partneritet me CLARD, ka qenë i përfshirë në një numër rastesh që ndërlidhen me dhunën në familje. Rasti i përshkruar më poshtë thekson disa nga problemet me të cila jemi përballur në raste të tilla.

Në shkurt 2012, një parashtruese e cila pretendonte të kishte qenë viktimë e dhunës në familje, të kryer nga bashkëshorti i saj, kunata dhe vjehrra e saj, ka kërkuar këshilla ligjore nga një përfaqësues i CLARD-it. Parashtrueses i është dhënë ndihmë në paraqitjen e një kërkese për urdhër për mbrojtje, i cili do të lëshohej nga gjykata komunale.

Gjykata komunale dështoi të lëshonte një vendim mbi kërkesën për urdhër për mbrojtje brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh, siç kërkohej nga ligji. Një seri seancave gjyqësore ishin shtyrë për një sërë arsyesh, përfshirë mungesën e të pandehurve të rastit, në kundërshtim me nenin 15 (3), dhe mungesën e një gjyqtari të EULEX-it për të monitoruar këtë rast, pretendim ky për të cilën nuk ishte paraqitur asnjë provë.

Seancat gjyqësore vazhduar për një periudhë prej pesë muajsh, kur u lëshua një urdhër për mbrojtje; ky vendim i ishte komunikuar parashtrueses pas një periudhe prej dy muajsh. Në së paku tri seanca gjyqësore nuk ishin mbajtur të dhëna, në kundërshtim me Kapitullin X të *Ligjit* nr. 22/2012 *mbi Procedurën Kontestimore*.

Problemet kryesore:

- Dështimi i vazhdueshëm i autoriteteve gjyqësore të Kosovës për lëshimin e urdhrave për mbrojtje: ky rast nuk është një izoluar ose dukuri e pazakontë, por në të kundërtën, ai paraqet dështim të vazhdueshëm të autoriteteve gjyqësore të Kosovës për zbatimin e ligjit që lidhet me urdhrat për mbrojtje të lëshuara në rastet e dhunës në familje, brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj.

- Zbatimi arbitrar i ligjit nga zyrtarët e drejtësisë: mosrespektimi i Nenit 15 (3), i cili përcakton se një vendim mund të nxirret në mungesë të kryerësit të identifikuar të dhunës në familje

[101] Sipas OKB-së, vendet që kanë ligje në fuqi për të parandaluar dhunën në familje përjetojnë një prani të ulët të këtij lloji të dhunës, me një nivel më të ulët përkatës të qytetarëve të cilët besojnë se dhuna ndaj grave është e justifikuar. Shih Raportin e OKB-se për Gratë "*Progresi Botëror mbi Gruan: Në ndjekje të Drejtësisë", 2010/2011 faqe* 47, ne dispozicion në: http://www.unifem.org/gender_issues/resources.php?WebSectionID=

ndjeshëm minon ndikimin e urdhrave për mbrojtje;. mjet ky kyç për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

- Mungesa e kontrolleve dhe balancave të gjykatave komunale: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përmes vendimit të tij nr. 22/2012, ka njohur rëndësinë e nxjerrjes së menjëhershëm të urdhrave për mbrojtje, dhe për këtë arsye duhet të monitorojë gjykatat nga afër në këtë aspekt.

3.8 Konkluzione dhe rekomandime

Ndërkohë që ekziston një kuadër i plotë i ligjit ndërkombëtar dhe të BE, si dhe të mekanizmave vendor, që merren me çështjet gjinore, monitorimi dhe zbatimi i këtyre ligjeve mbetet një sfidë e rëndësishme për të siguruar që të gjithë qytetarët të gëzojnë qasje të barabartë në mbrojtje të përshkruara si në nivel kombëtar ashtu dhe atë ndërkombëtar.

Zbatimi i ligjit në lidhje me kujdesin ndaj fëmijëve në rastet e shkurorëzimit përballet me vështirësi praktike, shpesh sepse **vendimi i gjykatës mbi dhënien e kujdestarisë së fëmijës për njërin prind nuk është respektuar**. Ky problem vihet re shpesh kur gjykata i beson babait kujdestarinë e fëmijës, në raste të shumta etërit/baballarët nuk i kanë respektuar dispozitat juridike që i kanë dhënë të drejtë bashkëshorteve të tyre të mëparshme, duke i konsideruar të drejtat e tyre të mbizotëruara. Për më tepër, në raste të ndryshme, babai nuk është i gatshëm për t'i lejuar nënës për të parë fëmijët e saj pas divorcit, edhe kur gjykata e lejon atë që të shoh fëmijët në baza javore ose mujore. Baballarët të cilët i dërgojnë rregullisht fëmijët për t'u takuar me nënën e tyre, në përputhje me urdhrin gjyqësor, janë në të vërtetë pakicë. Si pasojë, shumë nëna të vuajnë si pasojë e këtij mohimi të të drejtave të tyre.

Gjykatave nga natyra u kërkohet të merren me raste të ndryshme, por **ekziston një nevojë urgjente që të ketë gjyqtarë të veçantë në kuadër të gjykatave për të punuar në rastet e dhunës në familje;** krijimi i planifikuar i departamenteve të veçanta për të drejtën familjare, brenda gjykatave të Kosovës, nga viti 2013 e tutje sipas ligjit e ri mbi gjykatat, është një zhvillim pozitiv në këtë drejtim. Këta gjyqtarë do të sillnin vendime më efikase dhe të sakta në përputhje me kuadrin ligjor. Institucionet përgjegjëse, në këtë rast Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, duhet të jenë të përfshira **në krijimin e një Qendre Kombëtare për Rehabilitimin e Viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të dhunës në përgjithësi**. Kjo Qendër do t'u sigurojë viktimave të dhunës në familje si në vijim: shërbime këshillimore, programe psiko-sociale rehabilitimi, ndihmë mjekësore dhe ligjore, të cilat janë në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës.[102] Qendra gjithashtu do të shërbejë si qendër kombëtare e trajnimit të specializuar për punonjësit që punojnë në këtë fushë.

Sipas Ligjit për barazi, Kuvendi i Kosovës duhet të emërojë një Prokuror/e për Barazi Gjinore, i/e cili ka kompetencë të plotë për të monitoruar zbatimin e ligjit.[103] Megjithatë, **asnjë Prokuror/e për Barazi Gjinore nuk është zgjedhur akoma** nga Kuvendi i Kosovës. Ky pozicion duhet të plotësohet sa më shpejt

[102] http://www.assembly.coe.int/Documents/WorkingDocs/doc02/EDOC9525.htm VIII 3
[103] Ligji për barazi gjinore, Nr. 2004/2, Seksioni 6

të jetë e mundur për të siguruar se ligji është zbatuar siç duhet dhe në përputhje me kërkesat për barazi gjinore.

Qeveria e Kosovës ka themeluar Agjencinë për Barazi Gjinore, e cila në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, ka mandatin për të monitoruar barazinë gjinore në punësim, në përputhje me standardet e përcaktuara me ligj. Sektori publik është gjithashtu i obliguar që t'i përmbahet këtij ligji.[104]

Me qëllim për të rritur ndërgjegjësimin mbi ekzistencën dhe rëndësinë e Ligjit për Familjen, Ligjit për Barazi Gjinore dhe Ligjit kundër dhunës në familje, si dhe të japin informacion mbi institucionet përgjegjëse dhe si t'i kontaktoni ato, **organizatat dhe shoqatat që përpiqen të mbrojnë të drejtat e grave duhet të organizojnë fushata që synojnë vetëdijesimin e grave**, sidomos të atyre që jetojnë në zonat rurale.

[104] Ibid., neni 5.2 a

KAPITULLI 4. Personat me aftësi të kufizuara

4.1 Kushtetuta

Kosova është e angazhuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili garanton të drejtat, lirinë qytetare dhe barazinë para ligjit për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë. Kushtetuta e Kosovës përcakton se "të gjithë janë të barabartë përpara ligjit" dhe se "askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose tjetër, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar apo ndonjë status tjetër personal."[105]

Njerëzit me aftësi të kufizuara kanë të drejtë, së bashku me të gjithë qytetarët e tjerë të Kosovës, për mbrojtjen e të drejtave të tyre të njeriut dhe barazisë para ligjit, pa nevojën që legjislacioni të ofrojë këto të drejta veç e veç. Për më tepër, ekzistojnë instrumente të veçanta ligjore ndërkombëtare që njohin çështjet dhe mbrojtjen e të drejtave të veçanta për personat me aftësi të kufizuara, aplikimi i drejtpërdrejtë i këtyre instrumenteve në sistemin ligjor të Kosovës është i garantuar me Kushtetutë.[106]

4.2 Ligji për Aftësimin, Riaftësimin, Rehabilitimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara

Gjendja e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë është veçanërisht sfiduese. Zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e kësaj kategorie të njerëzve deri tani ka dhënë pak rezultate, me përjashtim të Ligjit mbi Pensionet për Personat me Aftësi të Kufizuara. Zbatimi i këtij ligji ka qenë më i suksesshëm, sepse u miratua në vitin 2003, kohë në të cilën Kosova ishte ende nën administrimin ndërkombëtar, i cili ndihmoi për të siguruar që një buxhet i veçantë është caktuar për zbatimin e Ligjit. Zbatimi i Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me Aftësi të Kufizuara është stagnuar, kryesisht për shkak të neglizhencës së autoriteteve për të vënë mënjanë (ndarë) fonde të mjaftueshme për zbatimin e tij.[107]

Ky ligj përcakton dhe rregullon të drejtat, kushtet dhe format e formimit profesional, rehabilitim, dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që të integrohen në tregun e hapur të punës. Qëllimi i Ligjit është që të sigurojë mbështetje ligjore dhe institucionale për personat me aftësi të kufizuara në rehabilitimin, punësimin dhe trajnimin profesional, në përputhje me parimet e jo-diskriminimit dhe mundësive të barabarta. Ligji e thotë qartë se njerëzit me aftësi të kufizuara kanë të drejtën si për punësimin dhe kushtet e punës të përshtatshme për situatën e tyre.[108]

[105] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24, paragrafi 1 & 2
[106] Ibid., neni 22.
[107] Bislimi, Bekim: "Sfidat e personave me aftësi të kufizuara", intervistë me z. Gëzim Abazi, Drejtor i OJQ-së "Hdheicap Kosova", dhe z. Driton Bajraktari, Drejtor i OJQ-së "Dawn Syndrome Kosova", Radio Evropa e Lirë, 21 dhjetor 2010 (në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe). Në dispozicion në: <http://www.evropaelire.org/content/neni/2197411.html>, qasur më 4 tetor 2011.
[108] Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara Nr. 03/L-019, neni 11;

Sipas këtij ligji, aftësia profesionale dhe rehabilitimi janë përcaktuar si "të gjitha aktivitetet që kanë për qëllim sigurimin e aftësive, njohurisë dhe përvojës së nevojshme për punë efikase në kuadër të një profesioni të kryer më parë, para periudhës së paaftësisë, apo rikualifikim për një profesion të ri që ai/ajo mund të bëjë me sukses."[109] Institucionet e Kosovës, veçanërisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, përcaktojnë shkallën e kapacitetit të punës për njerëzit me aftësi të kufizuara pas procedurave të vendosura me ligj[110]. Në bazë të seriozitetit të dëmtimit të tyre, njerëzit me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të marrin pjesë në trajnime dhe aktivitete të rehabilitimit profesional të organizuara nga Qendra për aktivitete trajnuese dhe Rehabilitim Profesional e Kosovës[111].

Ligji gjithashtu i jep të drejtë njerëzve me aftësi të kufizuara të cilët janë të paaftë për punë në tregun e hapur të punës për të kërkuar punë në Qendrën për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësim, ku ata mund, më lehtë, të gjejnë vend që korrespondon me aftësitë e tyre[112]. Ndonëse edhe personat me aftësi të kufizuara janë të punësuar në tregun e hapur të punës, ata në përgjithësi përballen me vështirësi me kushtet e punës në këtë situatë, meqë Ligji zbatohet dobët, si nga sektori publik, ashtu edhe ai privat, dhe dënimet për dështim në zbatimin e këtij ligji janë të kufizuara.[113]

Në mënyrë domethënëse, sipas neneve 12.1 dhe 12.2, organet administrative shtetërore, punëdhënësit privat dhe publik dhe organizatat joqeveritare janë të obligueshme që të punësojnë së paku një person me aftësi të kufizuar për çdo 50 punëtorë, dhe për të siguruar kushte adekuate të punës për punonjësit e tyre me aftësi të kufizuara[114]. Punëdhënësit që nuk zbatojnë këtë dispozitë janë të detyruar të paguajnë një kontribut mujor[115], që shkon në buxhetin e Kosovës dhe përdoret për zbatimin e projekteve për njerëzit me aftësi të kufizuara. Gjobat sillen nga 500 deri 2.000 euro janë gjithashtu të parashikuara edhe për punëdhënësit që shkelin të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Handicap Kosova, OJQ që mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, ka shprehur shqetësime për përpjekjet e pamjaftueshme të bëra drejt zbatimit të këtij ligji, duke theksuar se organizatat joqeveritare, me ndihmën e donatorëve të ndryshëm, kanë bërë përpjekje të mëtejshme në këtë drejtim.[116]

[109] Ibid., neni 3
[110] Ibid., neni 7.1
[111] Ibid., neni 8, Pika 1.2 dhe Pika 4
[112] Ibid., nenet 11.1, 11.2, 11.3 & 11.4
[113] Kasapolli-Selani, Ariana: "Njerëzit me aftësi të kufizuara – jo të barabartë", intervistë me z. Afrim Maliqi, U.D. Drejtor i OJQ-së "Handikos", Radio Evropa e Lirë, 26 shtator 2010 (në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe). Në dispozicion në: **<http://www.evropaelire.org/content/neni/2168618.html>**, qasur më 4 tetor 2011
[114] Ibid., neni 12, paragrafi 1& 2.
[115] Ky kontribut përfaqëson 1% të pagës që korrespondon me pagën minimale që mund të bëhet nga një person me aftësi të kufizuara në kompani, shumëzuar me numrin e punonjësve me aftësi të kufizuara që duhet të jenë të punësuar. Për shembull, një kompani që punëson 200 persona, ku më puna më së paku e paguar që mund të bëhet nga një person me aftësi të kufizuara është paguar 300€-euro në muaj do të duhet të paguajë 4-katër herë, 3€-tre euro çdo muaj. Shihni nenin 12, paragrafin 3.
[116] Beqiri, Arta: "Personat me aftësi të kufizuara – në gjendje të rëndë", intervistë me z. Gëzim Abazi, Drejtor i OJQ-së "Kosova Handicap", gazeta Bota Sot, 21 dhjetor 2010 (në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe). Në dispozicion në: <http://www.botasot.info/def.php?category=30&id=94587>, qasur më 3 tetor 2011

Sipas përfaqësuesve të OJQ-së *Doën's Syndrome Kosova*, ligji nuk ka sjellë asnjë përmirësim thelbësor në mundësitë e punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Institucionet shtetërore nuk janë duke zbatuar plotësisht këtë aspekt të ligjit për shkak të mungesës së planit për të arritur objektivat. Në të vërtetë, detyrimi për ndërmarrjet, kompanitë dhe institucionet shtetërore për të punësuar së paku një person me aftësi të kufizuara për 50 të punësuar nuk është respektuar në shumicën e institucioneve shtetërore, me një nivel edhe më të ulët të përmbushjes së këtij detyrimi nga ndërmarrjet private dhe publike.[117]

4.3 Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë

Korniza ligjore e Kosovës përcakton se të gjithë njerëzit që i përmbushin kushtet për skemën sociale kanë të drejtë për asistencë sociale, por në praktikë, gjendja specifike e personave me aftësi të kufizuara, dhe sidomos nevoja e tyre për pajisje ndihmëse dhe asistencë personale në sektorin e punësimit, është e mbuluar në mënyrë të pamjaftueshme. *Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë* përmend këto përfitime, por për shkak të mungesës së udhëzimeve administrative nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ato nuk zbatohen. Pajisjet ortopedike, asistenca teknike dhe sanitare deri tani janë ofruar kryesisht nga OJQ-të, me mbështetjen e donacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Rasti i atyre që jetojnë me një vështirësi dëgjimi ilustron se si legjislacioni aktualisht në fuqi mund të kontribuojë në përjashtimin e personave me aftësi të kufizuara. Raporti mbi Standardet e Jetesës së Komunitetit të shurdhër tregon se 77% marrin përfitime sociale, 91% përfitojnë nga masat e përshtatura, 5% marrin pensione themelore, dhe vetëm 4% marrin pension invaliditeti[118]. Sipas Ligjit për pensionet e personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, "persona të aftë për punësim apo të punësuar aktualisht në çfarëdo mënyre, duke përfshirë çdo formë vetë-punësimi, siç përcaktohet në ligjet tatimore të Kosovës, nuk kanë të drejtë për pensione për persona me Aftësi të Kufizuara. Punësimi aktual, duke përfshirë vetë-punësimin, do të përbëjë provë të paragjykuar të ndërprerjes së aftësisë së kufizuar. Pagesat e pensionit të aftësisë së kufizuar do të pushojnë që nga data e parë e punësimit si i/e vetë-punësuar.[119] Njerëzit me aftësi të kufizuara janë përgjithësisht të pa-favorizuar nëpërmjet një përkufizim tepër të gjerë të aftësisë së tyre për të punuar dhe procedurave për të provuar aftësinë e tyre të kufizuar.

Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë po ashtu dekurajon dhe sanksionon njerëzit me aftësi të kufizuara që janë në gjendje të punojnë, duke kërkuar nga ata që të paguajë ndonjë

[117] Bislimi, Bekim: "Sfidat e personave me aftësi të kufizuara", intervistë me z. Gëzim Abazi, Drejtor i OJQ-së "Handicap Kosova" dhe z. Driton Bajraktari, Drejtor i OJQ-së "Dawn Syndrome Kosova", Radio Evropa e Lirë, 21 dhjetor 2010 (në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe). Në dispozicion në: <http://www.evropaelire.org/content/neni/2197411.html>, qasur më 4 tetor 2011.

[118] Raport Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara në vitin 2007, Projekti CARDS 2007

[119] Ligji për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, nr 2003/23, neni 3.4. Është përgjegjësi e individit për të treguar seriozitetin e paaftësisë së tij/saj te një mjek, duke respektuar këtë procedure: "Komisioni mjekësor mund ta mbështesë vendimin e vet për ekzistimin e paaftësisë totale dhe të përhershme në provat e depozituara nga kërkuesi dhe/apo në gjetjet dhe ekzaminimeve mjekësore të ndërmarra nga vetë komisioni i doktorëve. Të gjitha kërkuesit duhet t'i nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore që bëhen nga komisioni mjekësor. Komisioni mjekësor nuk është i detyruar të pranojë dëshminë mjekësore të siguruara nga Kërkuesi, por mund ta konsiderojnë atë në marrjen e vendimin. "Ibid., neni 4.6

shumë për kufirin e pensionit të aftësisë së kufizuar, të marra nga data e punësimit apo vetëpunësimit.[120] Si pasojë, njerëzit me aftësi të kufizuara kanë pak nxitje që në mënyrë aktive të kërkojnë punë, sepse kjo do të çojë në shkurtim të pensionit që vështirë se mund të kompensohet nga punësimi i përkohshëm potencialisht i paqëndrueshëm.

4.4 Ligji për Përkrahje Materiale Familjeve me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme

Në përputhje me Konventën ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijës në mbrojtje të fëmijëve nga çdo lloj diskriminimi, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me paaftësi të përhershme.[121] Qëllimi i këtij ligji është për të mbështetur financiarisht familjet që kanë fëmijë me paaftësi të përhershme, në mënyrë që të shmanget mbështetja në klinikat e specializuara sa më shumë që të jetë e mundur.[122] Ligji përcakton paaftësinë e përhershme si kusht i një fëmije që plotësisht dhe përgjithmonë nuk mund të lëvizin as të kryejnë aktivitetet e përditshme pa ndihmë, si dhe përshkruan kriteret kur një fëmijë mund të konsiderohet ligjërisht si fëmijë me paaftësi të përhershme, dhe moshën kur këta fëmijë kanë të drejtë të marrin/gëzojnë mbështetje financiare.[123] Ndër kushtet që konsiderohen si paaftësi të përhershme janë verbëria, pamundësia për të lëvizur, ecur, ngrënë dhe veshur në mënyrë të pavarur, ose për të kryer kujdesin personal. Mosha për fëmijët që ligjërisht të ketë të drejtë të përfitojnë mbështetje financiare shkon nga 1-18 vjeç.

4.5 Ligji për Personat e Verbër

Ligji për personat e verbër (nr. 04/L-092) është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 14 qershor 2012 dhe do të hyjë në fuqi më 1 janar 2013. Ky Ligji "rregullon statusin ligjor të personave të verbër" në Kosovë[124], dhe mbron personat e verbër nga, ndër të tjera, diskriminimi dhe shfrytëzimi.[125] Ky ligj përcakton se personat e verbër "përjashtohen nga çfarëdo lloj tatimi dhe taksat e drejtpërdrejta" [126], si dhe se kanë të drejta të veçanta në lidhje me punësimin dhe kanë të drejtë të marrin përfitime nga qeveria e Kosovës prej jo më pak se 100 euro çdo muaj, edhe pse përfituesit nga kjo skemë sociale nuk kanë të drejtë për të përfituar nga asnjë skemë tjetër pensionale.[127]

Përveç kësaj, ligji specifikon të drejtat e personave të verbër në lidhje me: banimin, kujdesin shëndetësor, arsimin, qasjen në informata; rehabilitimin; udhëtimin; shpenzimet e rrymës elektrike dhe të telefonit; përfitimet dhe të drejtat e tjera; dhe, mbrojtjen e të dhënave personale.[128] Ajo cfarë është me rëndësi të madhe, ky ligj i obligon institucionet e Kosovës që të vënë në dispozicion informatat zyrtar, si dhe materialet arsimore, në një format të qasshëm për personat e verbër (p.sh. në Braille ose

[120] Ibid., neni 9.2
[121] Shih Ligjin për mbështetje materiale familjeve të fëmijëve me paaftësi të përhershme, Nr. 03/L-022
[122] Ibid., neni 1.
[123] Ibid., neni 2.
[124] Ligji për Personat e Verbër, nr. 04/L-092, Neni 1
[125] Ligji për Personat e Verbër, nr. 04/L-092, Neni 4
[126] Ligji për Personat e Verbër, nr. 04/L-092, Neni 6
[127] Ligji për Personat e Verbër, nr. 04/L-092, Neni 7.2
[128] Ligji për Personat e Verbër, nr. 04/L-092, Nenet 8 – 16

audio)[129], dhe kërkon të bëhen përshtatjet e nevojshme për personat e verbër në lidhje me infrastrukturën publike, si dhe operatorët publike dhe privatë për udhëtime.[130]

Për më tepër, ai përcakton procedurat që kanë të bëjnë me statusin zyrtar të personave të verbër, përfshirë procedurën për regjistrimin e një shoqëruesi zyrtar dhe procedurën për përcaktimin e statusit zyrtar të një personi të verbër nga një Komision Mjekësor-Social, që konfirmohet përmes lëshimit të një "broshure të veçantë të verbërisë" secilit person të njohur zyrtarisht si të verbër.[131] Së fundmi, çfarëdo padie në lidhje me ligjin duhet të shqyrtohet përmes një procedure të përshpejtuar.[132]

4.6 Ligji i Punës

Gjatë periudhës së pasluftës, të drejtat e punës janë rregulluar përmes një kombinimi të legjislacionit jugosllavë dhe të ligjeve të reja që kishin kaluar nën administrimin e UNMIK-ut në Kosovë[133]. Ky legjislacion, edhe pse i mungonte përmbajtja për të drejtat themelore dhe ishte zbatuar vetëm pjesërisht, ishte i suksesshëm në vendosjen e marrëdhënieve të punësimit në ligj. Në vitin 2010, Kuvendi i Kosovës votoi për një Ligj të ri të Punës që ka përditësuar të drejtat dhe obligimet në lidhje me punësimin. Ky ligj ndalon diskriminimin në rekrutimin, trajnimin, promovimin, kushtet e punësimit, masat disiplinore, si dhe përfundimin e kontratës së punës, e cila përfshin diskriminim e personave me aftësi të kufizuar.[134]

Një kapitull i veçantë i Ligjit të Punës ka të bëjë me mbrojtjen dhe sigurinë e personave me aftësi të kufizuara në vendin e punës, të cilët gëzojnë mbrojtje të veçantë sipas këtij ligji. Një punonjës që ka rezultuar me aftësi të kufizuara pas një aksidenti në vendin e punës ka të drejtë të punojë në bazë të përshkrimit të punës që kishte para aksidentit, nëse ai mund të kryejë detyrat e tij pa rehabilitim profesional. Në qoftë se punonjësi nuk është në gjendje të vazhdojë në të njëjtin rol, ai/ajo më pas mund ti nënshtrohet një trajnimi profesional rehabilitimi, pas së cilit punëdhënësi është i detyruar të i ofrojë një rol të ri punonjësit që do të korrespondon me aftësitë e tij/saj[135].

4.7 Udhëzimi Administrativ nr. 2/2003 për prezantimin e të miturve dhe personave me aftësi të kufizuara mendore në Media

Ky udhëzim administrativ ka të bëjë me format, kushtet dhe procedurat e paraqitjes dhe ekspozimit të foshnjave të braktisura, të miturve dhe personave me paaftësi mendore në Media, kur ata janë nën përgjegjësinë e një kujdestari ligjor, ose institucioneve profesionale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale[136]. Institucionet që u janë besuar përgjegjësitë ligjore për personat me paaftësi

[129] Ligji për Personat e Verbër, nr. 04/L-092, Nenet 10 – 11
[130] Ligji për Personat e Verbër, nr. 04/L-092, Nenet 15 – 13
[131] Ligji për Personat e Verbër, nr. 04/L-092, Neni 17
[132] Ligji për Personat e Verbër, nr. 04/L-092, Neni 19
[133] Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27
[134] Ligji i punës nr. 03/L-212, neni 5
[135] Ibid., neni 44 dhe neni 47
[136] Udhëzim Administrativ Nr. 2/2003 për prezantimin e të miturve dhe personave me aftësi të kufizuara mendore në Media nr. 2/2003, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, neni 1.

mendore janë të detyruara të respektojnë të drejtën e tyre për jetë private dhe për të mbrojtur të dhënat e tyre personale dhe identitetin[137].

4.8 Udhëzimi Administrativ nr. 09/2004 për procedurat e paraqitjes së kërkesës për pension të aftësisë së kufizuar

Ky udhëzim administrativ përcakton procedurat për paraqitjen e kërkesave të pensioneve për personat me aftësi të kufizuara.[138] Neni 4.4 bën një përjashtim nga kërkesa për nënshkrim në rastet kur kërkuesi nuk është në gjendje për të nënshkruar personalisht, dhe i jep të drejtën për të zyrtarit të pensioneve për të vënë një shenjë në vend të nënshkrimit.

4.9 Udhëzimi Administrativ nr. 15/2004 për zbatimin e pensioneve për persona me aftësi të kufizuara

Me këtë udhëzim administrativ, Departamentit të Administratës së Pensioneve dhe zyrave të saj rajonale i janë dhënë përgjegjësi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për të menaxhuar pensionet për personat me paaftësi. AU gjithashtu parashikon krijimin e një komisioni mjekësor dhe procedurat për konsultime mjekësore dhe të pagesave.

4.10 Udhëzimi Administrativ nr. 07/2010 dhe 03/2009 mbi kompletimin e udhëzuesit administrativ për përcaktimin e procedurave zbatuese për realizimin e aë drejtës në ndihmë materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim të rregullojë zbatimin e Ligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me paaftësi të përhershme. AI rregullon se si dhe nën çfarë kushtesh një aplikim i sërishëm për pension mund të bëhet. Kur aplikacioni i një familje me një fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale është refuzuar edhe pse ka ndjekur në mënyrë korrekte të gjitha procedurat, neni 3.2 siguron një shans të dytë për të aplikuar, dy vjet pas marrjes së një përgjigje negative nga komisioni i mjekëve.

4.11 Strategjia dhe plani i veprimit për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës 2009-2011 dhe Plani kombëtar I veprimit për persona me aftësi të kufizuara

Me këtë dokument të rëndësishëm strategjik politik, qeveria e Republikës së Kosovës ka për qëllim të përcaktojë hapat e nevojshëm që duhet të ndërmerren në mënyrë që të përmirësohet zbatimi, promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe për të informuar qytetarët e Kosovës për të drejtat e njeriut në përgjithësi. Edhepse strategjia ka skaduar, deri në miratimin e një strategjie të re, ky do të mbetet dokument udhëzues për qeverinë e Kosovës lidhur me personat me aftësi të kufizuara.

[137] Poaty, neni 2, paragrafi 2.1 dhe neni 3, paragrafi 3.1

[138] Është paraparë që plotësimi i kërkesës duhet të ndërmerret si vijon: zyrtari për pensione jep një formular që duhet të plotësohet nga personi me aftësi të kufizuara, të nënshkruhet, dhe të dërgohet përsëri, me dokumente të bashkangjitura personale dhe mjekësore. Shihni Udhëzimin Administrativ nr. 09/2004, neni 4, paragrafi 4.3

Kjo qasje siguron masa ad-hoc për trajtimin e problemeve të veçanta, dhe masave për veprimet në vazhdim për të përmirësuar gjendjen aktuale të të drejtave të njeriut në Kosovë. Plani i veprimit paraqet prioritetet dhe veprimet që duhet të ndërmerren në mënyrë që të zgjidhen problemet ekzistuese dhe për të rritur nivelin e standardeve të të drejtave të njeriut. Në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në nenin 3 të Strategjisë për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, plani i veprimit përcakton masa të veçanta dhe konkrete për secilin institucion përgjegjës.

Ky dokument strategjik identifikon çështjet kryesore për njerëzit me paaftësi duke përfshirë shkallën e ulët të integrimit të personave me paaftësi, që përfaqësojnë 10% të qytetarëve që jetojnë në Kosovë, sidomos në arsim, punësim, transportin publik dhe shërbimet e përgjithshme publike. Mungesa e legjislacionit të përshtatshëm për shëndetin mendor është gjithashtu një çështje e rëndësishme, së bashku me mungesën e përfshirjes adekuate të fëmijëve me paaftësi në jetën sociale, si dhe integrimin e pamjaftueshëm dhe risocializimin e personave me paaftësi në jetën sociale.

Brenda kategorisë së njerëzve me paaftësi, ka grupe veçanërisht të cenueshme/ndjeshme siç janë gratë, fëmijët, të rinjtë, komunitetet pakicë dhe të kthyerit me paaftësi. Sipas Planit Kombëtar të Veprimit për personat me paaftësi, sigurimi i barnave dhe i pajisjeve mjekësore për njerëzit me paaftësi duhet gjithashtu të marrë parasysh apo të kujdeset nëse ka burime në dispozicion[139].

4.12 Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane

Njerëzit me paaftësi përballen me sfida të veçanta për integrimin dhe mirëqenien e tyre në shoqëri, veçanërisht në fushën e arsimit, trajnimit dhe punësimit, por edhe në lidhje me pensionet, mbështetjes së familjes, dhe të transportit. Nevoja për të adresuar këto sfida të veçanta është pranuar nga disa instrumente të së drejtës ndërkombëtare. Gurthemeli ligjor në lidhje me personat me paaftësi janë *Konventa* e Kombeve të Bashkuara *për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara* (në tekstin e mëtejmë, *Konventa*) *dhe Deklarata mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara* (në tekstin e mëtejmë, *Deklarata*). Ndonëse asnjëra nuk është ligjërisht e detyrueshme, ato kanë fuqi të pamohueshme morale dhe janë dëshmuar të dobishme në ofrimin e udhëzimeve për shtetet. Një dokumente të tjetër ligjor i përmendur në këtë seksion është *Deklarata Universale për të Gjenomin e Njeriut dhe të Drejtat e Njeriut*.

Të drejtat themelore dhe anti-diskriminimi

Përkufizimi ndërkombëtarisht i pranuar për persona me aftësi të kufizuara është relativisht i gjerë, domethënë "çdo person i paaftë për të siguruar nga ai/ajo vet, tërësisht ose pjesërisht, nevojat e një individi normal dhe/ose të jetës sociale, si pasojë e mangësisë, ose të lindur, ose jo, në aftësitë e tij/saj fizike ose mendore"[140]. Asnjë dallim nuk është bërë në lidhje me origjinën, seriozitetin, apo natyrën e aftësisë së kufizuar. Ligji ndërkombëtar thekson shumë qartë se nuk do të ketë gradë të të drejtave dhe

[139] *Planin Kombëtar te Veprimit për personat me aftësi të kufizuara në Republikës se Kosovës 2009- 2011*, 2009-2011, faqe. 23-27 Shih tabelën te pjesa për Shëndetin prej faqe 23-27 te Planin Kombëtar i Veprimit për personat me aftësi te kufizuar te Republikës se Kosovës 2009- 2011

[140] *Deklarata për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara,* neni 1

të dinjitetit njeriut, por barazi për të gjithë. Vështirësia apo pamundësia për të jetuar një "jetë normale" nuk duhet të shihet si një arsye për përjashtim, por më tepër ajo duhet të adresohet në mënyrë që njerëzit me aftësi të kufizuara për të ushtruar "të njëjtat të drejta themelore si-bashkëqytetarët e tyre të së njëjtës moshë, që nënkupton para së gjithash të drejtën për të gëzuar një jetë të denjë, normale dhe sa më të plotë të jetë e mundur"[141].

Në të drejtën ndërkombëtare, diskriminimi është përkufizuar si "çdo dallim, përjashtim, ose kufizim në bazë të aftësisë së kufizuar që ka qëllim apo efekt të kufizimit apo zhvlerësimit të njohjes, gëzimit apo ushtrimit, mbi baza të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile apo ndonjë fushe tjetër"[142]. Në këtë mënyrë, "të drejtën e personave me paaftësi për të përfituar nga masat e dizajnuara për të siguruar pavarësinë e tyre, integrimin social dhe profesional dhe pjesëmarrjen në jetën e komunitetit" [143] duhet të kuptohen si përpjekje për të bërë barazinë ndërmjet të gjitha qenieve njerëzore një realitet. Është e theksuar qartë se këto masa nuk duhet të shihen si futje e llojeve të reja të diskriminimit, që do të thotë se "ndalimi i diskriminimit duhet të jetë pa paragjykime për mirëmbajtjen ose miratimin e masave me qëllim për të parandaluar ose kompensuar mangësitë e vuajtura nga një grup i personave të një feje apo besimi, paaftësisë, moshës apo orientimit seksual"[144].

Trajnimi dhe punësimi

Vështirësia e përjetuar shpesh nga njerëzit me aftësi të kufizuara për të fituar qasje në arsimim, trajnim dhe punësim adekuat është e njohur nga e drejta ndërkombëtare. Konventa mbron të drejtën e njerëzve me aftësi të kufizuara për shkollim dhe të mësuar gjatë gjithë jetës, për të siguruar zhvillimin "nga personat me aftësi të kufizuar tek personaliteti i tyre, talenti dhe kreativiteti, si dhe aftësitë e tyre mendore dhe fizike, në masën e potencialit të plotë [...] duke u mundësuar personave me aftësi të kufizuar të marrin pjesë në mënyrë efektive në një shoqëri të lirë"[145]. Ai gjithashtu thekson të drejtën e njerëzve me aftësi të kufizuara për të "punuar, në baza të barabarta me të tjerët; kjo përfshin të drejtën për mundësinë për të fituar për jetesën me punë të zgjedhur lirisht apo të pranuar në tregun e punës dhe mjedisin e punës që është i hapur, përfshirës dhe i arritshëm për personat me aftësi të kufizuara"[146].

Hapa të veçantë që do të merren nëpërmjet legjislacionit dhe/ose në vendin e punës, përfshijnë "mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, të kenë kushte të favorshme pune, duke përfshirë mundësitë e barabarta dhe shpërblim të barabartë për punë me vlerë të barabartë , kushte të sigurta dhe të shëndetshme të punës, duke përfshirë mbrojtjen nga ngacmimet, dhe korrigjimin e ankesave [...]; tu mundësojë personave me aftësi të kufizuar të kenë qasje në programet e përgjithshme teknike dhe këshilluese profesionale, shërbimet e punësimit dhe formimit profesional dhe të vazhdueshëm [...]; punësimin e personave me aftësi të

[141] Ibid., neni 3
[142] *Konventa për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara,* neni 2
[143] *Karta e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore,* Neni 26
[144] Preambula e Direktivës së Këshillit Evropian 2000/78/EC, neni 26
[145] *Konventa për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara, neni* 24(1)
[146] Ibid., neni 27(1)

kufizuar në sektorin publik, dhe për të promovuar punësimin e personave me aftësi të kufizuar në sektorin privat nëpërmjet politikave dhe masave të duhura, të cilat mund të përfshijnë programe afirmative veprimi , masa nxitëse dhe masa të tjera"[147].

Ky legjislacion riafirmon të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në punësim të rëndësishëm dhe të përshtatshëm, si dhe të përfitojnë nga masat për të arritur këtë qëllim. Shteti, si ligjvënës, por edhe nëpërmjet punësimit të tij konkret dhe praktikave të punësimit, mbart një përgjegjësi të veçantë ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Transporti dhe Qasja

Në shikim të parë, duke siguruar që njerëzit me aftësi të kufizuara kanë qasje në institucionet private dhe në shërbime dhe në transport të përshtatur mund të duket një detaj relativisht i parëndësishëm. Megjithatë kjo është një fushë ku hapat konkretë të qeverisë, të aktorëve privatë dhe të shoqërisë si tërësi mund të kenë efekt të jashtëzakonshëm në integrimin e personave me aftësi të kufizuara në jetën e përditshme. Neni 19 i Konventës në veçanti trajton çështjen e qasjes, duke u kërkuar shteteve të "marrin masat të duhura për të siguruar qasje personave me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në mjedisin fizik, në transport, në informacion dhe komunikim, duke përfshirë informacionin dhe teknologjitë e komunikimit dhe të sistemeve, si dhe të objekteve të tjera dhe shërbimeve të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane ashtu edhe në zonat rurale".

Qasja kuptohet jo vetëm si aftësi fizike për të arritur një vend, por gjithashtu edhe kapaciteti për të kuptuar dhe për të komunikuar informacione dhe ofrimin e teknologjive të përshtatshme dhe ndihmës së specializuar. Neni 20 trajton në mënyrë më specifike lëvizjen personale, duke kërkuar për që të "sigurohet lëvizshmëria personale me pavarësinë më të madhe të mundshme për personat me aftësi të kufizuara". Kjo përfshin ofrimin e ndihmave mobile dhe të teknologjive ndihmëse, dhe çdo lloj tjetër të ndihmës së transportit, kur është financiarisht e mundshme, për të gjitha këto njerëzit me aftësi të kufizuar duhet të vihen në dijeni (bëhen të vetëdijshëm) sa më shumë që të jetë e mundur.

Shërbimet Sociale, Mbështetja e Familjes, dhe Pensioni

Integrimi i njerëzve me paaftësi në shoqëri në një mënyrë të barabartë dhe me respekt dhe duke siguruar që atyre u janë dhënë mundësitë për të zhvilluar plotësisht potencialin e tyre kërkon një aparat të gjerë të përkujdesjes sociale, si dhe mbështetje për familjet me një anëtar me aftësi të kufizuara. Deklarata bën një dispozitë e përgjithshme duke numëruar shkurtimisht se çfarë të drejtash duhet të jepen për të përmbushur këtë objektiv, domethënë "të drejtën e trajtimit mjekësor, psikologjik dhe funksional, duke përfshirë edhe proteza dhe pajisje ortotike, për rehabilitimin mjekësor dhe social, arsimimit, formimit profesional dhe rehabilitimit, ndihmë , këshillim, shërbime të vendosjes dhe shërbime të tjera të cilat do t'i ndihmojë të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe shkathtësitë deri në maksimum".[148]

[147] *Konventa për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara, neni* 27(1b, 1d, 1g, 1h)
[148] *Deklarata për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 6*

Megjithatë, e drejta ndërkombëtare njeh gjithashtu të mundshëm trajtimin diskriminues apo përjashtues, trajtim të diferencuar të njerëzve me aftësi të kufizuara, veçanërisht në lidhje me vendbanimin, dhe për këtë arsye vazhdon të parashikojë se "personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të jetojnë me familjet e tyre ose me prindërit strehues dhe të marrin pjesë në të gjitha grupet sociale, veprimtaritë krijuese apo rekreative. Asnjë person me aftësi të kufizuara nuk duhet t'i nënshtrohet [...] trajtimit të ndryshëm se sa trajtimit që kërkohet nga kushtet e tij/saj ose nga përmirësimi i cili mund të rrjedh prej tij/saj. Nëse qëndrimi i një personi me aftësi të kufizuara në një institucion të specializuar është esencial/domosdoshëm, kushtet e mjedisit dhe jetesës në to do të jenë sa më afër me ato të jetës normale të një personi të moshës së tij/saj"[149]. Lehtësirat e dhe shërbimet e nevojshme duhet të vihen në dispozicion për njerëzit me aftësi të kufizuara, por gjithashtu duhet t'u përgjigjen me të vërtetë nevojave të tyre si dhe të jenë jo-pushtuese, fjala kryesore duhet të jetë përfshirja, "për të parandaluar izolimin dhe veçimin nga komuniteti"[150].

Masat konkrete që kanë për qëllim për të përmirësuar standardet e kushteve të jetesës dhe sociale të personave me aftësi të kufizuara janë: "qasja e personave me aftësi të kufizuar [...] në programe të mbrojtjes sociale dhe programe të reduktimit të varfërisë; [...] qasja e personave me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre që jetojnë në situata të varfërisë për ndihmë nga shteti me shpenzime të lidhura me aftësinë e kufizuar, përfshirë trajnimin e duhur, këshillimin, asistencën financiare dhe kujdesin gjatë pushimeve; [...] qasja e personave me aftësi të kufizuar në programet e strehimit publik [...] qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara programet për përfitimet e pensionit"[151].

Të gjitha këto objekte/masa janë veçanërisht të rëndësishme për aq sa ato ndërtohen mbi të drejtat themelore të përmendura më parë dhe masat konkrete integruese për të krijuar kushte afatgjate të integrimit, integrimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara.

4.13 Rastet

Në fillim të vitit 2012, ECMI Kosova dhe CLARD kanë pranuar një rast në lidhje me personat me aftësi të kufizuara dhe punësimin.

Përfituesja kishte punuar si profesionist i TI-së në një Shtëpi të Shëndetit në sektorin publik. Megjithatë, për shkak të një sëmundjeje, ajo kishte humbur shikimin. Rrjedhimisht, punëdhënësi i saj kishte argumentuar se ajo nuk ishte më në gjendje që të bënte të njëjtën punë dhe e kishte shkarkuar atë nga kjo pozitë, por e kishte mbajtur në vendin e punës, pa terma të referencës. Përfituesja më pas kishte ndjekur një numër kursesh trajnuese për të mësuar për të përdorur Braille dhe që të përdorte kompjuterin në atë gjendje që ishte. Ajo kishte argumentuar se me këtë trajnim ishte në gjendje të merrte përsipër disa nga përgjegjësitë e saja të mëparshme. Megjithatë, punëdhënësi i saj nuk kishte pranuar t'i jepte asaj asnjë përgjegjësi konkrete të punës.

[149] *Deklarata për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 9*
[150] *Konventa për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara, neni* 19b
[151] Konventa për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara, *neni* 28b-d

Kjo situatë ilustron besimin e përhapur të punëdhënësit se punësimi i personave me aftësi të kufizuara është një formë e bamirësisë, dhe se njerëzit me aftësi të kufizuara janë krejtësisht të paaftë për të qenë të angazhuar në punë efektive. Për më tepër, kjo situatë paraqet shkelje të *Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin, Rehabilitimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara*, i cili i detyron punëdhënësit të "punësojnë persona me aftësi të kufizuara, me kushte të përshtatshme"[152], pasi punëdhënësi nuk kishte bërë asnjë përpjekje për të siguruar këto "kushte të përshtatshme".

4.14 Konkluzione dhe rekomandime

Ligji për Pensionet në Kosovë dekurajon dhe sanksionon njerëzit me aftësi të kufizuara të cilët janë në gjendje të punojnë, duke theksuar se "personi i cili e merr pensionin e aftësisë së kufizuar është i detyruar t'i kthej të gjitha pagesat e pensionit të aftësisë së kufizuar, të marra prej ditës së parë të punësimit apo vetëpunësimit"[153]. Rekomandohet që ky seksion i ligjit **të ndryshohet për të mundësuar njerëzit me aftësi të kufizuara për t'u punësuar duke ruajtur një përqindje të arsyeshme të pensionit të tyre.** Në gjendjen e tanishme, ligji përcakton pengesat për nismat e personave me aftësi të kufizuara të hyjnë në fuqinë punëtore dhe për sigurinë dhe mirëqenien e tyre sociale.

Gjithashtu, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të monitorojë nga afër zbatimin e plotë të nenit 6.2 të ligjit, pasi që vetëm një numër i vogël i njerëzve me aftësi të kufizuara marrin pagesa të cilat janë retroaktive deri në datën e plotësimit të kërkesës, siç e përcaktuar në ligj.

Ligji mbetet i paqartë në lidhje me kushtet e sakta për sa i përket paaftësisë së përhershme. Njerëzit që vuajnë nga disa kushte të rënda dhe sëmundjeve kronike, të tilla si kushtet e zemrës, diabeti, kolesterolit të lartë, çrregullime psikologjike dhe morale, paralizë të pjesshme ose amputim, përballen me një mungesë informacioni në lidhje me zbatimin e procedurave për pensionet e aftësisë së kufizuar dhe janë shpesh janë konsideruar si të papërshtatshme. Në këtë mënyrë, **ligji duhet të ndryshohet për të qartësuar se çfarë e bën një person të ketë të drejtë në pension të aftësisë së kufizuar,** dhe që plotësisht njeh gamën e gjerë të kushteve dhe sëmundjeve që ndikojnë në aftësinë e dikujt për të punuar.

Ekziston një nevojë për **të rritur ndërgjegjësimin e publikut** për sa i përket Ligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme duke organizuar fushata informuese, të cilat do të sigurojnë informacion të detajuar rreth të drejtave të garantuara me këtë ligj për fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe tu ndihmojë familjeve për të kuptuar procedurën për të aplikuar për përkrahje materiale.

Për më tepër, ekziston nevoja për të rritur ndërgjegjësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara për sa i përket Ligjit të ri të Punës, duke siguruar informacion të detajuar në lidhje me ligjin e ri dhe duke identifikuar se çfarë të drejta u janë dhënë/garantuar atyre. Inspektorati i Punës duhet të fuqizohet për

[152] Ligji për Aftësimin, Riaftësimin, Rehabilitimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, Nr. 03/L-019, Neni 12.1.
[153] Ligji mbi Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, Nr. 2004/ 3 Neni 9.2

të mbikëqyrur dhe monitoruar të gjitha ligjet që lidhen me punën, dhe të vënë theksin në krijimin e bashkëpunimit të ngushtë me organizata të cilat mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim për të zbatuar plotësisht Ligjin e punës.

Përkundër faktit se ekzistojnë raste të shumta ku njerëzit me aftësi të kufizuara janë të diskriminuar, ata janë shpesh ngurrues për të filluar procedurat dhe të mbrojnë të drejtat e tyre sipas ligjit. Prandaj është shumë vështirë të vlerësohet se si është i përhapur diskriminimi në praktikë. Një procedurë e iniciuar nga CLARD për të kërkuar mbrojtje nga diskriminimi deri më tani nuk çoi në asnjë sanksion kundër institucioneve që kanë bërë shkelje. **Ky ligj duhet të promovohet, veçanërisht me gjyqtarë**, të cilët janë aktorët kryesorë përgjegjës për zbatimin e saj, në mënyrë që të inkurajojë ata që t'i kushtojnë më shumë vëmendje rasteve të diskriminimit dhe të bëjnë gjykime të përshtatshme.

Nenet 4.4 dhe 4.3 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2004 për Procedurat e Aplikimit për Pension të Aftësisë së Kufizuar: njëra thotë që parashtruesit e kërkesës duhet të nënshkruajnë personalisht formën e tyre të kërkesës për pensionet, ndërsa tjetra i lejon nëpunësit të pensioneve që të vë një shenjë në formën e aplikimit në vend të nënshkrimit të parashtruesit të kërkesës. Parashtruesit e kërkesës që nuk janë në gjendje të nënshkruajë duhet t'u lejohet të përdorin gjurmët e gishtave të tyre. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk mund të përdorin shenjat e gishtave të tyre, në raste si gjymtimi, duhet të kontaktohet zyra e regjistrimit civil për të përcaktuar se çfarë procedure është e vlefshme për identifikimin e personit. Nëpunësi i pensioneve, si zyrtar për pranimin e kërkesave për pensionet e aftësisë së kufizuar, nuk duhet të lejohet në asnjë rast që të nënshkruajë kërkesën, pasi kjo mund të vë atë në një situatë të konfliktit të interesit. Ndihmësi apo kujdestari juridik i personit me aftësi të kufizuara duhet të kenë të drejtë të nënshkruajë formularin e aplikimit kur është e përshtatshme, për shembull kur ai/ajo person nuk është në gjendje ta bëjë këtë.

Për më tepër, **njerëzit që janë plotësisht dhe përherë të kufizuar në lëvizjen e tyre nuk duhet tu kërkohet të takojnë nëpunësin e pensioneve personalisht.** Institucioni përgjegjës duhet të krijojë një ekip që do të bëjë verifikimin e të dhënave të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në formularin e aplikimit. Ky ndryshim në legjislacion do të jetë veçanërisht i rëndësishëm për njerëzit me aftësi të kufizuara në moshën e daljes në pension, të cilët shpesh përjetojnë pengesa të rënda për lëvizjen e tyre.

Ekziston një nevojë urgjente për të **miratuar një Plan Veprimi të përditësuar** për njerëzit me aftësi të kufizuara. Ç'është e rëndësishme, një dokument i tillë i përditësuar duhet të adresojë çështjet aktuale lidhur me **qasjen në medikamente dhe pajisje mjekësore** për personat me aftësi të kufizuara, të cilat aktualisht nuk janë shpesh në dispozicion në sasi të mjaftueshme ose nuk janë në dispozicion fare në barnatoret publike.

Së fundi, Kosova deri më tani nuk ka kaluar asnjë legjislacion në lidhje me shëndetin mendor në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut. **Mbetet një nevojë urgjente për qeverinë e Kosovës për të përgatitur një projekt-ligj që synon të mbrojë njerëzit me aftësi të kufizuara intelektuale**.

KAPITULLI 5 Komunitetet minoritare

5.1 Kushtetuta

Kushtetuta e Kosovës mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që jetojnë në Kosovë. Kushtetuta thekson se "Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore"[154], dhe garanton barazi të plotë dhe efektive për të gjithë qytetarët e saj. Kushtetuta përcakton se "gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Gjuha turke, boshnjake dhe rome mund të kenë statusin e gjuhëve zyrtare në nivelin komunal ose do të jenë në përdorim zyrtar në të gjitha nivelet në pajtim me ligj."[155]

Duke reflektuar rëndësinë e të drejtave të komuniteteve në Kosovë, Kushtetuta e Kosovës ka një kapitull të plotë (Kapitulli III) që i dedikohet të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre. Ky kapitull thekson se çdo anëtar i një komuniteti mund të "zgjedhë lirisht për t'u trajtuar apo për të mos u trajtuar si i tillë" (neni 57). Ajo gjithashtu siguron përfaqësim të barabartë në institucionet publike (neni 61), kërkon përfaqësimi të komuniteteve përmes disa posteve të veçanta në nivel komunal (neni 62), Pjesëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtë që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin dhe atributet e tyre si komunitet. (neni 57), dhe përcakton detyrimet e shtetit për të siguruar "barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve" (Neni 58). Më në fund, Kapitulli III gjithashtu parashikon krijimin e një Këshilli Konsultativ për Komunitete (neni 60), i përbërë nga, midis të tjerash, përfaqësuesit e komuniteteve, me mandat për t'u mundësuar pjesëtarëve të komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme në nismat legjislative dhe politike, dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse.

Kushtetuta gjithashtu mbron të drejtat e komuniteteve në procesin legjislativ. Në Kuvendin që përbëhet prej 120 vendeve, ka garantuar 20 vende për partitë që përfaqësojnë komunitetet pakicë, me një numër specifik të vendeve të caktuara për komunitete të ndryshme (neni 64.2). Përveç kësaj, kushtetuta kërkon krijimin e Komisionit parlamentar për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve (neni 78), dhe siguron që legjislacioni që mbulon çështje të caktuara do të konsiderohet legjislacion me interes vital, i cili kërkon një shumicë të dyfishtë për ndryshime, miratimin ose shfuqizimin e tyre, si shumicën e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës ashtu edhe shumicën e deputetëve që mbajnë ulëse të garantuara për komunitetet (Neni 81). Përfundimisht, çdo ndryshim i Kushtetutës në vetvete kërkon një shumicë të dyfishtë prej dy të tretave, të shumicës së deputeteve të Kuvendit dhe shumicës së deputetëve që mbajnë vendet të garantuara për komunitetet (Neni 144).

[154] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Seksioni 3.1
[155] Ibid., neni 5, paragrafi 1 & 2

5.2 Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë

Qëllimi i këtij ligji është që t'u mundësojë komuniteteve që të kultivojnë, zhvillojnë dhe shprehin identitetin e tyre, duke parashikuar masa afirmative të nevojshme për promovimin e barazisë së plotë dhe efektive përmes masave të veçanta që duhet të vihen në zbatim nga Qeveria e Kosovës.[156] Ai ofron një përkufizim të përgjithshëm të komuniteteve, si:

> ‘‘grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë. Këto grupe janë komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptas, goran, malazias, kroat, dhe komunitete të tjera. Pjesëtarët e komunitetit shumicë në Republikën e Kosovës, të cilët si tërësi nuk janë shumicë në një komunë të caktuar po ashtu i gëzojnë të drejtat e radhitura në këtë ligj siç janë: identiteti, gjuha, kultura, edukimi, religjioni, shëndetësia, dhe të tjera.”[157]

Së bashku me *Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve*, ky është ligji më i rëndësishëm në lidhje me të drejtat e komuniteteve. Ai përmban dispozita mbi: identitetin; gjuhën; kulturën; mediat; fenë; arsimin; mundësitë ekonomike dhe sociale; shëndetësinë; pjesëmarrjen politike; dhe Këshillit Konsultativ për Komunitetet. Ky ligj mbron të drejtën e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre që të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë lirisht kulturën dhe identitetin e tyre.[158] Ai gjithashtu garanton barazinë e komuniteteve dhe i mbron ata nga diskriminimi.[159]

Ky Ligji gjithashtu përcakton disa dispozita themelore në lidhje me gjuhën, të tilla si statusi zyrtar i gjuhës shqipe dhe serbe dhe alfabeteve të tyre në nivel qendror, si dhe i gjuhës turke, boshnjake dhe rome, në nivelin komunal. Megjithatë, për udhëzime më specifike, ai i referohet Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.[160]

Sa i përket kulturës, ky ligj garanton të drejtën e komuniteteve që lirshëm të shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre. Ndër të tjera, ai mbron të drejtën e komuniteteve për të krijuar shoqata, për të festuar festat e tyre, dhe për të mbajtur kontakte të papenguara ndërmjet tyre dhe personave nga shtetet e tjera. Për më tepër, ai siguron mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare të të gjitha komuniteteve.[161]

Neni 6 i Ligjit merret me çështjet e mediave. Ajo përcakton të drejtën e komuniteteve për të krijuar mediat e tyre dhe që të kenë programet e komuniteteve të tyre në mediat elektronike publike. Në veçanti komuniteti serb ka të drejtën e tyre për një kanal televiziv të pavarur në gjuhën serbe, të

[156] Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Nr. 03/L-047, Nenet 1 – 2
[157] Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-047, faqe. 2-10
[158] Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Nr. 03/L-047, Neni 2
[159] Ibid., Neni 3
[160] Ibid., Neni 4
[161] Ibid., Neni 5

licencuar dhe që transmeton në mbarë Kosovën. Së fundmi, komunitetet gjithashtu duhet të përfaqësohen në organet rregullatore të mediave.[162]

Neni 7 shpall se Kosova nuk ka fe zyrtare, dhe se çdo person ka të drejtën e lirisë së besimit, ndërgjegjes dhe fesë. Për më tepër, ky nen i jep mbrojtje të veçantë Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë.[163]

Sa i përket arsimit, të gjithë pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të marrin arsimim publik në gjuhën e tyre, në nivelin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm, dhe se gjithashtu duhet të mësohet njëra nga gjuhët zyrtare të Kosovës. Në të gjitha nivelet e arsimit njerëzit kanë të drejtë që të studiojnë në gjuhën zyrtare që zgjedhin vetë. Të gjithë pjesëtarët e komuniteteve janë të lirë që të themelojnë institucione të tyre arsimore private. Së fundmi, institucioneve arsimore në gjuhën serbe u lejohet të përdorin tekstet e ofruara nga Ministria e Arsimit e Serbisë.[164]

Sa u përket mundësive ekonomike dhe sociale, ky ligj thekson se Qeveria e Kosovës do të luftojë diskriminimin direkt dhe indirekt. Burrat dhe gratë do të kenë mundësi të barabarta, si dhe pjesëtarët e komuniteteve do të përfaqësohen në mënyrë të barabartë në ndërmarrjet dhe institucionet publike.[165]

Përmes këtij ligji gjithashtu sigurohet qasja e barabartë në kujdesin shëndetësor. Për më tepër, informatat në lidhje me kujdesin shëndetësor duhet të publikohen në të gjitha gjuhët e komuniteteve, si dhe do të ndërmerren masa të veçanta për të siguruar kujdes të kënaqshëm shëndetësor për komunitetet e rrezikuar në aspektin social dhe ekonomik.[166]

Ky ligji siguron pjesëmarrjen efektive të komuniteteve në proceset e vendimmarrjes politike dhe mbron të drejtën e pjesëtarëve të komuniteteve për të formuar parti politike dhe për të kandiduar për poste dhe pozita në të gjitha nivelet e qeverisë. Ky ligji gjithashtu thekson se partitë politike, përveç atyre që synojnë të përfaqësojnë një komunitet, nuk mund t'i mohojnë një personi anëtarësimin në to në bazë të përkatësisë së tyre një komuniteti të caktuar.[167]

Neni 12 i Ligjit diskuton Këshillin Konsultativ për Komunitetet, i cili përcakton hollësisht mandatin, anëtarësinë dhe rregullimin e funksionimit të tij.[168]

5.3 Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Në mënyrë që të krijojë një sistem të qëndrueshëm të administratës vendore dhe të përmirësojë efikasitetin e shërbimeve publike në Kosovë, Kuvendi ka miratuar Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale. Ligji

[162] Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-047, Neni 6.
[163] Ibid., Neni 7
[164] Ibid., Neni 8
[165] Ibid., Neni 9
[166] Ibid., Neni 10
[167] Ibid., Neni 11
[168] Ibid., Neni 12

përcakton vetë-qeverisjen lokale si "e drejtë dhe aftësi e autoriteteve lokale siç e përcaktuar me këtë ligj dhe brenda kufijve të tyre, të rregullojnë dhe menaxhojnë një pjesë substanciale të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës lokale"[169]. Ligji gjithashtu krijon bazën ligjore dhe kuadrin për vetëqeverisje të qëndrueshme, duke përfshirë "statusin ligjor të komunave, kompetencat e tyre dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëveshjet ndër-komunale dhe bashkëpunimin ndër-komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror."[170]

Ky ligj parasheh krijimin e disa institucioneve komunale për mbrojtjen e komuniteteve në Kosovë. Kuvendet Komunale të Kosovës duhet të krijojnë një Komitet Komunal për Komunitete me përgjegjësinë për të shqyrtuar politikat komunale, praktikat dhe aktivitetet për të siguruar se të drejtat dhe interesat e Komuniteteve respektohen plotësisht dhe të nxjerrin rekomandime për Kuvendin Komunal.[171] Për më tepër, në komunat ku komunitetet përbëjnë së paku dhjetë për qind (10%) të popullsisë, Nënkryetari për Komunitete duhet të jetë i emëruar, të këshillojë Kryetarin lidhur me çështjet e komunitetit'[172],si dhe një Zëvendës-Kryesues për Komunitete duhet të jetë instaluar për të formuar "një pikë kontakti për adresimin e shqetësimeve të komuniteteve jo-shumicë"[173]. Megjithatë, është e diskutueshme nëse pragu prej dhjetë për qind (10%) është i justifikuar, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se roli i Nënkryetarit për Komunitete është edhe të respektojë të drejtat e veçanta, sidomos në lidhje me përdorimin e gjuhëve: nëse një komunitet përbën mbi 5% të popullsisë në një komunë të caktuar, gjuha e tyre njihet si gjuhë zyrtare, me status të barabrtë me gjuhët e tjera, dhe nëse një komunitet përbën mbi 3% të popullsisë, gjuha e tyre njihet si gjuhë në përdorim zyrtar.

Për më tepër, ligji parashikon sigurimin e të drejtave të zgjeruara për pjesëmarrje në zgjedhjen e komandantit lokal të stacionit të policisë dhe kompetenca të zgjeruara në fushën e kulturës për komunat me shumicë serbe. Në lidhje me shëndetin dhe arsimin, ligji përshkruan dhënien e kompetencave të zgjeruara në lidhje me arsimin universitar në komunën e Mitrovicës së Veriut, si dhe në kujdesin shëndetësor sekondar në komunat Mitrovicë e Veriut, Graçanicë, Shtërpcë. Në mënyrë domethënëse, ligji gjithashtu shprehimisht i lejon komunave që të bashkëpunojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me institucionet e Republikës së Serbisë[174].

5.4 Ligji për Përdorimin e Gjuhëve

Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në mënyrë që të respektojë identitetin gjuhësor të të gjithë njerëzve që jetojnë në Kosovë dhe për të krijuar një mjedis për të gjitha komunitetet që të shprehin dhe të ruajnë gjuhën dhe kulturën e tyre. Ligji ripohon/riafirmon se gjuhët zyrtare dhe të barabarta në Kosovë janë gjuha shqipe dhe ajo serbe[175], ndërsa "gjuhët e tjera të

[169] Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, neni 3.
[170] Ibid., neni 2.1.
[171] Ibid. neni 53.
[172] Ibid. neni 61.
[173] Ibid. neni 55.
[174] Ibid. neni 30.
[175] Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, Nr. 02/L-37, Neni 1.1.

komuniteteve, siç janë gjuha turke, boshnjake dhe rome mund të jenë gjuhë në përdorim zyrtar" në nivelin komunal.[176].

Përdorimi i gjuhëve në institucionet komunale

Një gjuhë është gjuhë zyrtare në nivel komunal nëse ajo është gjuha amtare e të paktën pesë për qind (5%) të banorëve të asaj komune[177], dhe një gjuhë e tillë do të ketë një status të barabartë, në atë komunë, me gjuhët zyrtare të Kosovës. Pavarësisht nga kjo dispozitë, gjuha turke është përcaktuar si një gjuhë zyrtare në Komunën e Prizrenit[178]; ashtu si në nenin 2.4, një gjuhë do të konsiderohet gjuhë në përdorim zyrtar në nivel komunal nëse ajo është gjuha amtare e të paktën tre për qind (3%) të banorëve të komunës, apo në qoftë se ajo gjuhë është folur tradicionalisht në komunë. Personave që u përkasin komuniteteve gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar gjithashtu kanë të drejtë, në komunikimin e tyre me autoritetet komunale, të "paraqesin parashtresat gojore ose të shkruara dhe dokumente, si dhe të pranojnë përgjigje në gjuhën e tyre"[179].

Përkundër këtyre dispozitave ligjore, është vënë re në nivelin lokal që anëtarët e komuniteteve shpesh përjetojnë vështirësi në komunikim me institucionet komunale në gjuhën e tyre amtare, nëse ata janë një komunitet pakicë në një komunë të caktuar[180].

Përdorimi i gjuhëve në procedurat gjyqësore

Ligji përcakton që një person i cili është i arrestuar apo i akuzuar për vepër penale dhe që nuk flet ose nuk kupton gjuhën (t) e procedurave gjyqësore ka të drejtë të informohet me kohë rreth arsyeve për arrestimin dhe për çdo akuzë kundër tij/saj apo në gjuhën që ai/ajo e kupton[181]. Për më tepër, "personat që u përkasin komuniteteve gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare dhe që marrin pjesë në procedura penale, kanë të drejtë të paraqesin shkresat, dëshmojnë dhe të dëgjojnë faktet për rastin dhe çdo dëshmi kundër tyre, në gjuhën e tyre amtare"[182]. Gjykata dhe organet e prokurorisë janë të detyruara të sigurojnë përkthim falas (pa pagesë) për ata që janë të përfshirë në procedurën penale.

Këto dy dispozita mund të kuptohen së bashku si një garanci e përgjithshme që çdo procedurë gjyqësore do të kryhet në mënyrë të tillë që të gjithë njerëzit e përfshirë mund të jenë të informuar dhe të komunikojnë në gjuhën e tyre amtare, pavarësisht nga statusi i saj zyrtar apo ndonjë mungese si pasojë.

Përdorimi i gjuhëve në arsim

Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve specifikon se anëtarët e komunitetit kanë të drejtë të marrin arsimimin publik në gjuhën e tyre amtare.[183] Në të njëjtën kohë, një gjuhë zyrtare sipas zgjedhjes duhet gjithmonë

[176] Ibid., neni 1.2.
[177] Ibid., Neni 2.3.
[178] Ibid., neni 2.3.
[179] Ibid., neni 8.1.
[180] Shih Raportin e OSBE-së për Vler4ësimin e të Drejtave të Komuniteteve (botimi i dytë), dhjetor 2010, fq. 15
[181] Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, Nr. 02/L-37 neni 15
[182] Ibid., neni 17.2
[183] Ibid., Neni 20.1.

të studiohet[184]; dhe një nxënës, me prindërit e tij/saj ka të drejtë të "vendosë se në cilën gjuhë zyrtare të dhënat e tij/saj të shkollës do të mbahen dhe në cilën gjuhë do të lëshohen raportet, nga ana e institucioneve arsimore ku ai/ajo ndjek mësimet."[185]

Përdorimi i gjuhëve në media

Sipas nenit 25, çdo person në Kosovë ka të drejtë të themelojë medie dhe kohën e transmetimit në Transmetues publik, në gjuhën sipas zgjedhjes së tij/saj.

Emrat personal dhe emrat e qytetit, rrugës dhe emrat topografikë

Sipas nenit 27.1, një person ka të drejtë të ketë emrin dhe mbiemrin e tij/saj të regjistruar në të dhënat publike civile dhe të shkruar në dokumentet e identifikimit personal në gjuhën zyrtare të zgjedhur sipas tij/saj, që përfshin sistemin me shkrim[186]. Megjithatë, ka pasur disa çështje praktike që lidhen me ligjin sipas të cilit "shenjat zyrtare që shënojnë apo përfshijnë emrat e komunave, fshatrave, rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike, do të paraqiten në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët që kanë statusin e gjuhëve zyrtare në komunë"[187].

Sipas Raportit të Vlerësimit të të Drejtave të Komuniteteve (2012) botuar nga OSBE Kosovo, ekzistojnë disa çështje lidhur me shenjat topografike, si në Vushtrri ku shenjat në rrugën kryesore përmbajë disa versione të ndryshme në gjuhën serbe. Në Skenderaj shenjat topografike të lexuar "Skenderaj/Skenderaj", ndërsa në Mamuşa/Mamushë/Mamuša shenjat nuk të përfshijnë versionin në gjuhën serbe. Në shumë komuna, shenjat topografike nuk janë të plota ose nuk ekzistojnë[188].

Komisioni i Gjuhëve

Për të siguruar, promovuar dhe mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, dhe në përputhje me të, Qeveria e Kosovës ka themeluar, sipas nenit 32 të *Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve*, Komisionin e Gjuhëve, përgjegjës për sigurimin e "njohjes së statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare dhe pajtueshmërinë me këtë ligj."[189]

Komisioni i Gjuhëve është reformuar kohët e fundit, për shkak se në formatin e tij paraprak ishte konsideruar se nuk ishte në gjendje të ushtronte mandatin e tij në mënyrë efektive. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, i vitit 2011, përshkruan problemet në lidhje me Komisionin e Gjuhëve si në vijim: "Mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare rrezikon qasjen ndaj shërbimeve publike shumëgjuhëshe dhe gjithashtu pjesëmarrjen efektive në jetën publike. Ndikimi i Komisionit të Gjuhëve

[184] Ibid., neni 21.1.
[185] Ibid., neni 24.1.
[186] Ibid., neni 27.2
[187] Ibid., neni 9.2
[188] Raporti i OSBE-së për Vlerësimin e të Drejtave të Komuniteteve
[189] Ligji për Përdorimin e Gjuhëve Nr. 02/L-37, Neni 23.2

është shumë e kufizuar për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe strukturave të komplikuara institucionale që kanë të bëjnë me të drejtat themelore."[190]

Prandaj Qeveria e Kosovës ka miratuar Rregulloren e Qeverisë nr. 07/2012 mbi Zyrën e Komisionarit të Gjuhëve, e cila ka hyrë në fuqi më 4 prill 2012 dhe ka zëvendësuar Komisionin e Gjuhëve me Komisionarin e Gjuhëve. Zyra e re e Komisionarit të Gjuhëve do të financohet nga buxheti i Kosovës dhe do të ketë një kod të veçantë buxhetor në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Ajo do të ketë stafin e vet dhe do të mbështetet nga një këshill për politika të gjihës dhe një rrjet për politika të gjuhës.

5.5 Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës

Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës rregullon institucionet publike të arsimit dhe ka për qëllim për të siguruar arsimim publik në të gjitha nivelet, nga niveli parashkollor deri në arsimin e lartë, në komunat e Kosovës. Ky ligj trajton edhe çështjen e licencimit, regjistrimit dhe punësimit të mësuesve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të minoriteteve, përkatësisht: "sistemi i licencimit [...] do t'i kushtojë vëmendje të veçantë nevojave të komuniteteve të cilat nuk janë shumicë në Kosovë, duke përfshirë edhe mundësinë efektive për dërgimin/delegimin e mësuesve nga vendet e huaja"[191].

Ky ligj u jep hapësirë komunave për të zgjeruar zhvillimin e arsimit në gjuhën serbe. Shkollat që ofrojnë mësim në gjuhën serbe janë të lejuara të ndjekin plan-programet dhe të përdorin tekstet e hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë, pas njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës (MASHT)[192]. Ligji i kërkon MASHT-it që të krijojë një komision të pavarur përgjegjës për shqyrtimin e materialit arsimor në gjuhën serbe, për të siguruar përputhshmërinë e tij me programin e arsimit në Kosovë. Komisioni është i përbërë nga anëtarë të komunitetit serb, përfaqësues ndërkombëtarë, si dhe përfaqësues nga MASHT-i. Ky komision merr të gjitha vendimet me shumicë votash[193]. Ky komision ka shqyrtuar plan-programin shkollor të Republikës së Serbisë në vitin 2010; megjithatë, deri më tani asnjë veprim nuk është ndërmarrë në rekomandimet e tij.

Ligji i kushton vëmendje të veçantë Mitrovicës së Veriut, së cilës i është dhënë liri e gjerë veprimi për sa i përket arsimit. Ligji parasheh që "Komuna e Mitrovicës së Veriut do të ketë autoritet për të ushtruar përgjegjësinë për universitetin [e saj] publik në gjuhën serbe në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës"[194]. MASHT-i është i obliguar me Ligj për t'i siguruar universitetit objekte dhe financim adekuat nga buxheti kombëtar dhe burime të tjera institucionale.[195]

[190] http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_en.pdf
[191] Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-068 neni 10.5.
[192] Ibid., neni 12
[193] Ibid., neni 13
[194] Ibid., neni 14d)
[195] Ibid., neni 14f)

5.6 Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës

Ky ligj rregullon arsimin parauniversitar në Kosovë, duke përcaktuar parimet e tij, duke vendosur kornizën institucionale për këtë dhe duke rregulluar menaxhimin dhe organizimin e tij. Ai në mënyrë të qartë thekson se "Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk mund të interpretohet si pakësim apo kufizim i ndonjë të drejtë të gëzuar nga Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre sipas ligjit në fuqi".[196] Për më tepër, ai e detyron Qeverinë e Kosovës dhe institucionet e saj arsimore që të "respektojnë dhe promovojnë të drejtat e komuniteteve", të "nxisin njohjen e kulturës, historisë dhe gjuhëve të të gjitha komuniteteve"[197], dhe që të sigurojë që arsimi parauniversitar të ofrohet pa diskriminim.[198]

Ajo që është me rëndësi, ky ligj siguron përfaqësimin e komuniteteve minoritare në organet kryesore arsimore, përfshirë Komitetin e Prindërve të Kosovës (16) dhe Këshillat Drejtues të shkollave[199], si dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin apo rishikimin e Kornizës së Kurrikulit të Kosovës.[200]

5.7 Udhëzimi Administrativ për zbatimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë dhe rishikimi i ndryshimeve për sa i përket Rastit: gjuha Rome me elemente te historisë dhe kulturës, nr. 7/2010

Me qëllim të zbatimit të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, MASHT ka nxjerrë një numër të udhëzimeve administrative. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të integrojë më mirë, kulturën, gjuhën, dhe historinë e popullit rom në programet arsimore, me qëllim për të nxitur mirëkuptim dhe respekt për këtë komunitet të margjinalizuar.

5.8 Udhëzimi mbi përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e gjuhëve Nr 2007/06

Udhëzimi Administrativ Nr. 2007/06 për përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve të lëshuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal jep informacion mbi procedurën për njohjen e gjuhëve zyrtare në nivel komunal. Nenin 3 i këtij Udhëzimi, me titull "njohja e menjëhershme e gjuhës në përdorim zyrtar", parashikon në nenin 3.2 se komuniteteve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare dhe që përbëjnë 5% ose më shumë të popullsisë së komunës, "Kuvendi Komunal do të njohë gjuhën e tyre si gjuhë zyrtare në komunë"[201]. Nëse lexohet në kombinim apo bashkë me nenin 3.1, UA i MAPL-së nr. 2007/06 duket të kërkojë, si parakusht për njohjen e gjuhës zyrtare të komunës në bazë demografike, "realizimin dhe publikimin e regjistrimit zyrtar nga institucionet e Kosovës [sic]."[202].

[196] Ibid, Neni 1.3
[197] Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L –032, Neni 3.5
[198] Ibid, Neni 3.6
[199] Ibid, Nenet 16 – 17
[200] Ibid, Neni 24.2
[201] Udhëzimi Administrativ mbi përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve [MAPL UA- Nr 2007/06], neni 3.2
[202] Udhëzimi Administrativ mbi përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve [MAPL UA- Nr 2007/06], neni 3.1

Megjithatë, duhet gjithsesi të theksohet se nenet e Ligjit për përdorimin e gjuhëve të cilat ofrojnë bazën ligjore për miratimin e UA të MAPL-së Nr. 2007/06 siç thuhet në Ligj dhe preambulën e Udhëzimit Administrativ, mos specifike nuk i japin mandat të veçantë Ministrisë për zhvillimin e udhëzimeve të cilat do të caktojnë procedurat për njohjen e gjuhëve zyrtare në komuna, por vetëm për gjuhët në përdorim zyrtar.

5.9 Rregullorja e Qeverisë Nr 07/2012 mbi Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve

Kjo rregullore përcakton kompetencat e qeverisë, përbërjen, organizimin dhe strukturën e zyrës së Komisionerit të gjuhëve, si dhe procedurat e vendimmarrjes së tij.[203] Zyra është e udhëhequr nga një Komisioner i Gjuhëve, i mbështetur nga një numër anëtarësh të stafit me orar të plotë, ndërsa Bordi i Politikave të Gjuhës siguron një mbikëqyrje të përgjithshme dhe këshilla. Për më tepër, rregullorja parashikon krijimin e një Rrjeti të Politikave Gjuhësore, që do të jenë mekanizmat kryesorë koordinues për çështjet gjuhësore për institucionet publike dhe ndërmarrjet.[204] Zyra e Komisionerit të Gjuhëve do të jetë përgjegjëse për, ndër të tjera: monitorimin dhe promovimin e pajtueshmërisë me Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve, hetimin e ankesave lidhur me të drejtat gjuhësore, ofrimin e këshillave dhe ndihmës për të drejtat gjuhësore, dhe, udhëheqjen e aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit.[205]

5.10 Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009 – 2013

Edhe pse kjo strategji është e rëndësishme për komunitetet në Kosovë, ajo fokusohet në komunitetet në procesin e kthimit. Prandaj një shpjegim i hollësishëm rreth kësaj strategjie do të jepet në Kapitullin 6.4.

5.11 Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas në Republikën e Kosovës, 2009 – 2015

Strategjia për integrimin e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptas në Republikën e Kosovës, jep udhëzime të përgjithshme mbi politikën e Kosovës për sa i përket komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptas, me qëllim që të "kontribuojë në krijimin e një shoqërie Kosovare në të cilën romët, ashkalitë dhe egjiptast janë të respektuar si qytetarë të barabartë, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore dhe nuk janë subjekt i ndonjë forme të diskriminimit"[206]. Strategjia përfshin 11 fusha të politikave, duke siguruar për çdo fushë një pasqyrë të gjendjes aktuale, problemet e rëndësishme dhe rekomandime rreth politikave. 11 fushat politike të mbuluara nga strategjia janë: (1) Kundër-diskriminimi, (2) Arsimi, (3) Punësimi dhe Fuqizimi Ekonomik; (4) Shëndeti dhe Çështjet Sociale, (5) Strehimi dhe Vendbanimet Joformale; (6) Kthimi dhe re-integrimi, (7) Regjistrimi dhe dokumentet; (8) Çështjet Gjinore; (9), Kultura, Mediat dhe Informimi; (10) pjesëmarrja politike dhe përfaqësimi; (11) Siguria (policore).

[203] Rregullorja e Qeverisë Nr 07/2012 mbi Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve, Neni 1.
[204] Rregullorja e Qeverisë Nr 07/2012 mbi Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve, Neni 15.
[205] Rregullorja e Qeverisë Nr 07/2012 mbi Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve, Neni 17.
[206] Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Republikën e Kosovës, fq. 12

Në dhjetor të vitit 2009, është miratuar një Plan Veprimi nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e Strategjisë. Si pjesë e këtij plani veprimi, një Grup teknik pune (Grupi i Punës) dhe një Komiteti Drejtues ndër-institucional (Komiteti) ishin themeluar për të mbikëqyrur përpjekjet e qeverisë së Kosovës për zbatimin e Strategjisë.

Deri tani nuk është ndarë ndonjë buxhet që do të caktohej në mënyrë specifike për zbatimin e Planit të Veprimit, për më tepër ekziston një ndërgjegjësim i kufizuar për strategjinë midis aktorëve kryesorë apo palëve të interesit. Prandaj, është raportuar vetëm një përparim modest.[207]

5.12 Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane

Respektimi dhe mbrojtja e minoriteteve është e mishëruar edhe në të drejtën evropiane dhe atë ndërkombëtare. *Deklarata Universale* e OKB-së *për të Drejtat e Njeriut* dhe *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike*, dy tekste këto themelore mbi të drejtat ndërkombëtare të njeriut, të dyja përmendin të drejtat kulturore, dhe identitetin fetar e gjuhësor, pa diskriminim.[208]

Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (FCNM) është një nga instrumentet më të rëndësishëm, ligjërisht të detyrueshëm, ndërkombëtar i projektuar për të mbrojtur të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare. Konventa hyri në fuqi më 1 shkurt 1998 dhe synon të nxisë barazinë e plotë dhe efektive të personave që u përkasin pakicave kombëtare në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore, së bashku me kushtet që do tu lejojnë atyre të shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë kulturën dhe identitetin. Ajo mbulon fushat e mëposhtme: të drejtën për një identitet të dallueshëm, barazinë efektive, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të dallueshme, jo-diskriminimin, të drejtat politike, lirinë e fesë, të drejtave e mediave, të drejtat gjuhësore, të drejtat arsimore, të drejtat e pjesëmarrjes, kontakte të lira ndërkufitare. Të drejtat dhe liritë e përcaktuara në FCNM [Konventën Kornizë] janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë (shih Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 22).

Edhe pse Kosova nuk është [shtet palë] nënshkruese e Konventës, ajo është subjekt i një marrëveshje të veçantë të monitorimit në përputhje me një marrëveshje mes UNMIK-ut dhe Këshillit të Evropës të viti 2004. Aktualisht, raportimi tek Këshilli i Evropës kryhet nga UNMIK-u, përmes misionit të OSBE-së në Kosovë. Marrëveshja e monitorimit zhvillohet çdo pesë vjet dhe përfshin tre faza kryesore. Së pari, UNMIK-u përgatit një raport mbi përputhshmërinë e Kosovës me FCNM-në {Konventa Kornizë] tek Këshilli i Evropës, së dyti, një komision i pavarur (Komisioni Këshillimor) jep një mendim ekspertësh për raportin e lëshuar nga UNMIK-u, të cilit gjithashtu i është dhënë një shans për të komentuar për këtë mendim. Së fundi, miratohet një rezolutë që përmban konkluzionet dhe rekomandimet për Kosovën lidhur me zbatimin e Konventës Kornizë.

[207] Për analizën e plotë të Strategjisë shih Raportin e OSBE-së (2011): 'Implementimi i Planit të Veprimit për Strategjinë për Integrimin e komuniteteve Rome, Ashkali, dhe Egjiptas në Kosovë".
[208] Ndër të tjera: neni 22 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, neni 2 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, neni 27 i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike.

Të drejtat e gjuhës në shoqëri: në arsim, vendin e punës, media dhe administratë

Të drejtat e komuniteteve pakicë të Kosovës për të përdorur gjuhën e tyre, në arsim dhe liria e shprehjes janë të lidhura ngushtë, një fakt ky i njohur nga e drejta ndërkombëtare dhe europiane. Në bazë të Nenit 58.2 të Kushtetutës, Kosova është e detyruar të respektojë standardet e parashikuara në Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, e cila përcakton se shtetet duhet të adoptojnë politika që sigurojnë "ofrimin e mënyrave dhe mjeteve të përshtatshme për mësimin dhe studimin e gjuhëve rajonale ose të pakicave në të gjitha fazat e duhura".[209]

Megjithatë, ky promovim i kulturave dhe gjuhëve të pakicave nuk duhet të kuptohet si një mbrojtje e njëanshme e pakicave kundër shumicës, por më tepër si një mjet për nxitjen e mirëkuptimit mes komuniteteve shumicë dhe pakicë. Prandaj, shtetet duhet të "bëjnë marrëveshje për të siguruar mësimin e historisë dhe kulturës e cila reflektohet nga gjuha rajonale ose e pakicës",[210] poashtu për jo-folësit e këtyre gjuhëve.

Karta më tej kërkon që shteti të marrë "veprim të vendosur për të promovuar gjuhët rajonale ose minoritare në mënyrë që të mbrojë ato"[211]. Më e rëndësishmja, këto hapa janë ndërmarrë kundër sfondit se "çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtë të përdorë lirisht dhe pa pengesa gjuhën e tij/saj të pakicës, në jetën private dhe publike, në të folur dhe në të shkruar"[212]. Kështu, të drejtën e arsimimit në një nga gjuhët e pakicave, dhe përdorimin i saj, mund të shihet si një trampolinë për një pjesëmarrje më të plotë, më kuptimplotë të shumicës dhe të komuniteteve pakicë. Si një vazhdim logjik, Karta Europiane gjithashtu shkon më tej duke vendosur se "personave që u takojnë pakicave kombëtare u janë dhënë mundësinë e krijimit dhe përdorimit të mediave të tyre"[213].

Së fundi, duhet përmendur se përgjegjësitë e autoriteteve të Kosovës nuk janë vetëm për promovimin e gjuhëve të pakicave në shoqëri. Institucionet janë të detyruar të respektojnë gjuhët e pakicave në marrëdhëniet e tyre me popullatën, përkatësisht "në zonat e banuara nga personat që i përkasin pakicave kombëtare tradicionalisht apo në numër thelbësor, në qoftë se ata persona e kërkojnë këtë dhe kur një kërkesë e tillë korrespondon me nevojë reale, Palët do të përpiqen të sigurojnë, për aq sa është e mundur, kushtet që do bëjnë të mundur përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet midis këtyre personave dhe autoriteteve administrative"[214].

OSBE-ja ka hartuar disa nga standardet më gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore. Dy dokumente të OSBE-së kanë domethënie të rëndësishme në fushën e të drejtave gjuhësore. E para, "Dokumenti i Kopenhagës", përfshin dispozita të hollësishme mbi përdorimin e gjuhëve si dhe jo-

[209] Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare, Neni 7 (1f).
[210] Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare, Neni Art.8(1g).
[211] Ibid., neni 7(1d)
[212] Ibid., neni 10(1)
[213] Ibid., neni 9(3)
[214] Ibid., neni 10(2)

diskriminim dhe arsimim.[215] Edhe pse nuk është ligjërisht e detyrueshme, ajo ka implikime te rëndësishme (të buta) ligjore dhe implikime politike dhe shumë e konsiderojnë atë të jetë më e avancuar se instrumentet e tjera.[216] Dokumenti i dytë, "Rekomandimet e Oslo", është një mjet praktik politik që u ofron shteteve dhe aktorëve të tjerë me një pikë reference të hollësishme në zhvillimin e politikave efektive për gjuhët e pakicave, përfshirë edhe në lidhje me përdorimin e gjuhëve në arsim, fe, media, jetën e komunitetit, dhe organizata jo-qeveritare (OJQ), si dhe në komunikimet me autoritetet publike, në procedurat gjyqësore, dhe në funksionimin e bizneseve private.[217]

Prona

Edhe pse nuk ka asnjë konventë ndërkombëtare që fokusohet posaçërisht në të drejtat e minoriteteve në pronë dhe banim, disa traktate ndërkombëtare kanë bërë të njohur cenueshmërinë e këtij grupi. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), njeh të drejtën e "posedimit të pronës" dhe të drejtën për "një nivel jetese të mjaftueshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banimin...".[218]. Për më tepër, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor garanton "të drejtën e të gjithëve, pa dallim race, ngjyre, ose kombëtare ose origjine etnike, të barazisë para ligjit, sidomos në gëzimin e të [...]: drejtës për të poseduar pasuri, si i vetëm ashtu edhe në bashkësi me të tjerët; [...] drejtës për strehim"[219]. Gjithashtu, përcaktohet shprehimisht në ligjin ndërkombëtar se "askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare ose të paligjshme në jetë (privatësi), familje, banesë ose korrespondencë"[220]. E drejta në pronës është e njohur edhe në nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Shëndeti dhe përfitimet sociale

Sigurimi i barazisë së mirëqenies për të gjithë është në qendër të instrumenteve ndërkombëtare të te drejtave të njeriut. DUDNJ përcakton të drejtën e të gjithë njerëzve për sigurimin shoqëror,[221] ndërkohë që Pakti Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK)[222] (nuk është ligjërisht e detyrueshme për Kosovën) garanton të drejtën "për të gëzuar standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor"[223]. Si pasojë, shteti është gjithashtu përgjegjës për "krijimin e kushteve që do të sigurojnë të gjitha shërbimet mjekësore dhe kujdesin mjekësor në rast të sëmundjes"[224]. Për më tepër, Organizata Ndërkombëtare e Punës, në pavlefshmërinë e saj, të Konventës

[215] Dokumenti i Kopenhagës Mbledhja e Konferencës për Dimension Human të OSBE-së, miratuar në Kopenhagë, 29 qershor 1990, shihni: http://www.OSBE.org/documents/odihr/1990/06/13992_en.pdf.
[216] Brett, Rachel (1996), 'Të Drejtat e Njeriut dhe OSBE', *Të Drejtat e Njeriut Tremestral* , Vol. 18, Nr. 3; faqe 668-693.
[217] Rekomandimet e Oslos Lidhur me të Drejtat Gjuhësore të Pakicave Kombëtare ('Rekomandimet e Oslos "), të përgatitur në shkurt 1998 nga Fondacioni për Marrëdhënie Ndëretnike me kërkesë të Komisionarit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare (Hagë: OSBE, 1998).
[218] *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 17.1 dhe 25.1.*
[219] *Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, neni* 5d(v, iii)
[220] *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike,* neni. 17(1)
[221] Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Neni 22.
[222] Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Neni 12(1).
[223] Ibid., neni 12(1)
[224] *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni* 12(1d)

për përfitimet e pleqërisë dhe të mbijetuarve (nuk është ligjërisht e detyrueshme për Kosovën), kërkon që shteti të marrë masa për "tu siguruar personave të mbrojtur sigurimin e përfitimit të pleqërisë"[225].

Të Drejtat e Punës

Duke pasur parasysh rëndësinë e kushteve të punës së një personi në sigurimin e të drejtave të tyre, përfshirë të drejtën për një standard të denjë jetese, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet të drejtave të punës. PNDESK është instrumenti kryesor ligjor ndërkombëtar për këtë çështje, i cili edhepse nuk është ligjërisht i detyrueshëm për Kosovën, ka implikime të rëndësishme të ligjit të butë. Në përputhje me PNDESK, gjithkush ka të drejtë "në paga të drejtë dhe shpërblim të barabartë për punë me vlerë të barabartë pa asnjë dallim të çfarëdo lloji"[226] dhe për "kushte të sigurta dhe të shëndetshme të punës".[227] Edhe pse anëtarëve të pakicave nuk u është dhënë në mënyrë të posaçme mbrojtje specifike në bazë të ligjit ndërkombëtar të punës, shteteve u kërkohet, kur është në të vërtetë e nevojshme, që të përfshijë masat e jo-diskriminimit në politikat e tyre kombëtare, "të projektuara për të promovuar, me metodat e përshtatshme për kushtet dhe praktikën kombëtare, barazinë e mundësive dhe trajtimin në lidhje me punësimin dhe profesionin, me qëllim për të eliminuar çdo lloj diskriminimi"[228].

Në këtë perspektivë, "masa të veçanta të dizajnuara për të përmbushur kërkesat e veçanta të personave të cilët, për arsye të tilla si gjinia, mosha, paaftësia, përgjegjësitë familjare ose statusi social apo kulturor, janë të njohur në përgjithësi të kërkojnë mbrojtje të veçantë apo ndihmë, nuk do të konsiderohen që të diskriminohen"[229]. Është e pranuar, pra, që minoritetet mund, dhe kur është e nevojshme, duhet të përfitojnë nga trajtimi i veçantë në mënyrë që të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre. Kjo gjithashtu përfshin të drejtën për të formuar, bashkuar dhe organizuar lirshëm sindikatat e tregtisë, [230], dhe për të hyrë në grevë në qoftë se ata konsiderojnë se të drejtat e tyre të punës nuk janë respektuar[231].

5.13 Rastet

Në vijim diskutohen dy raste që kanë të bëjnë me pretendime për diskriminim nga pjesëtarët e komuniteteve minoritare. Këto raste kryesisht tregojnë mosgatishmërinë e organeve administrative për t'u marrë me pretendimet për diskriminim, apo edhe për t'iu përgjigjur atyre, pasi që theksojnë nevojën për të vendosur procedura të qarta sa u përket përgjegjësive të organeve administrative në lidhje me *Ligjin Kundër Diskriminimit*.

Segregacioni në arsim

Gjatë vitit shkollor 2011 – 2012, ECMI Kosova ka marrë informata në lidhje me segreacionin në arsim në tri komuna të ndryshme të Kosovës. Në secilën nga këto komuna shkollat kishin krijuar një ose më

[225] *Invaliditeti, Konventa për përfitimet e Pleqërisë dhe të Mbijetuarve*, neni 14
[226] *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*, Neni**7(i.a)**
[227] *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni* 7(ii.b)
[228] *Konventa për Diskriminimin* (*në* punë dhe profesion), neni 2
[229] *Konventa për Diskriminimin* (*në* punë dhe profesion), neni 5(2)
[230] *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni* 8(1a)
[231] *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni* 8(1d)

shumë klasa me fëmijë pothuaj vetëm të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas. ECMI Kosova kishte ngritur këto çështje zyrtarisht me dy shkollat dhe komunat përkatëse. Edhe pse nuk është marrë asnjë përgjigje nga institucionet përkatëse, pas një kohe klasat ndara janë shpërbërë dhe fëmijët e prekur janë shpërndarë nëpër klasa të tjera.

Sidoqoftë, në vitin shkollor 2012 – 2013, ECMI Kosova ka marrë raporte se një nga tri shkollat që praktikonin këtë formë të diskriminimit një vit më parë sërish kishte formuar një klasë një-etnike. Pas një ankese tjetër, këtë herë e drejtuar Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nga e cila nuk është marrë ndonjë përgjigje, ECMI Kosova ka përkrahur një numër të prindërit e fëmijëve të prekur për të parashtruar një padi kundër komunës përkatëse, me pretendimin se ishte shkelur e drejta e fëmijëve të tyre për trajtim të barabartë dhe mos-diskriminim.

Diskriminimi në qasjen në patentë-shoferë

Në vitin 2012, një numër i pjesëtarëve të komunitetit rom kanë pretenduar se ishin viktima të një praktike diskriminuese të Departamentit të Automjeteve dhe Regjistrimit të Patentë-Shoferëve në Kosovë dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përkatësisht Zyrës së Divizionit për Patentë-Shoferë në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë, Zyra në Prishtinë).

Në Departamentit të Automjeteve dhe Regjistrimit të Patentë-Shoferëve në Kosovë, pjesëtarëve të komunitetit rom u ishte refuzuar mundësia për të shkëmbyer patentë-shoferët e lëshuar në Serbi me ato të lëshuar në Kosovë, me arsyetimin se ky shërbim ishte në dispozicion vetëm për pjesëtarë të komunitetit serb, ose se ishin vënë kërkesa shtesë, përkatësisht drejtimi i aplikuesve në Zyrën në Prishtinë, e cila më pas u kishte kërkuar atyre që të siguronin dokumentacionin që dëshmon përkatësinë e tyre etnike, dokumentacion ky i cili nuk ekziston në Kosovë.

Dy pjesëtarë të komunitetit rom ishin të gatshëm t'i parashtronin ankesë zyrtare Ministrisë së Punëve të Brendshme kundër kësaj praktike. Edhe pse nuk kishte marrë përgjigje zyrtare, ECMI Kosova ka marrë raporte se praktika është ndryshuar dhe pjesëtarët e komunitetit rom mund të këmbejnë patentë-shoferët e tyre. Pas ndryshimit të kësaj praktike, parashtruesit e ankesës nuk ishin të gatshëm të vazhdonin ndjekjen e kësaj procedure.

5.14 Konkluzione dhe rekomandime

Në përgjithësi, korniza ligjore për të drejtat e komuniteteve në Kosovë është në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e minoriteteve dhe të njeriut, por sidoqoftë zbatimi mbetet sfidë. Është shënuar përparim i rëndësishëm në themelimin me sukses të një numri Komunash me shumicë serbe, në përputhje me *Ligjin për Vetëqeverisje Lokale*, por pengesa të dukshme vazhdojnë të pengojnë krijimin e Komunës së re të Mitrovicës së Veriut. Gjendja e sigurisë në të cilën gjenden komunitetet në Kosovë është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme, në veçanti në pjesën jugore të Kosovës, dhe liria e lëvizjes është përmirësuar, ndonëse mbesin ndjenja të pasigurisë.[232]

[232] *Raport mbi lirinë e lëvizjes*, UNDP Kosova, 2009, fq. 22

Institucionet përgjegjëse duhet **të rrisin përpjekjet e tyre për zbatimin e Strategjisë për Integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas** në të gjithë sektorët e identifikuar, buxhet i mjaftueshëm duhet të ndahet për veprimet e nevojshme, si dhe duhet të përmirësohet koordinimi në mes të nivelit qendror dhe atij lokal dhe të zhvillohet një sistemi më i fortë për monitorim.

Zbatimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve mbetet jo i plotë. Është me rëndësi që, pas publikimit të rezultateve jozyrtare të Regjistrimit të vitit 2011, është bërë progres në drejtim të njohjes së gjuhëve zyrtare në nivelin komunal dhe të gjuhëve në përdorim zyrtar. Për më tepër, Zyra e re e Komisionarit të Gjuhëve duhet të funksionalizohet sa më shpejtë që të jetë e mundur. Gjithashtu duhet të bëhen përpjekje serioze për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të përkthimit në Kosovë, në veçanti sa i përket legjislacionit; dhe institucionet publike duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për të siguruar të gjitha dokumentet zyrtare në të gjitha gjuhët zyrtare.

Sa i përket arsimimit të komuniteteve minoritare, një çështje veçanërisht brengosëse është **funksionimi i vazhdueshëm i dy sistemeve të ndara të arsimit**, njërit që ofron mësim-nxënie përmes plan-programeve mësimore të Republikës së Kosovës dhe tjetrit që ofron mësim duke punuar me plan-programin mësimor të Republikës së Serbisë, pa kurrfarë ndërveprimi ose koordinimi. Një hap i rëndësishëm do të ishte miratimi dhe zbatimi nga Qeveria e Kosovës i një plan-programi për arsimim në gjuhën serbe. Një tjetër cështje është **se komuniteti boshnjak dhe ai turk nuk kanë qasje në të gjithë librat e kërkuar në gjuhën e tyre amtare,** në veçanti për arsimin e mesëm të lartë.

Ndonëse përfaqësimi politik i tyre është adekuat, **përfaqësimi i komuniteteve minoritare në shërbimin civil mbetet i pamjaftueshëm**, dhe Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë veprime konkrete për të adresuar këtë situatë, përfshirë, nëse është e nevojshme, nëpërmjet masave afirmative siç janë kuotat.

KAPITULLI 6. Të kthyerit dhe personat e riatdhesuar

6.1 Kushtetuta

Kosova ka një detyrim kushtetues për të respektuar standardeve dhe konventat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, e cila përfshin ato që lidhen me procesin e kthimit dhe riatdhesimit[233]. E drejta për t'u kthyer është e një rëndësie të veçantë për Kosovën, ku, pas konfliktit të vitit 1999 dhe trazirave të vitit 2004, një numër i madh i qytetarëve të Kosovës janë zhvendosur. Duke njohur rëndësinë e procesit të kthimit, Kushtetuta përcakton se "Republika e Kosovës promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre"[234].

6.2 Ligji për ripranim

Ky ligj "përcakton rregullat dhe procedurat për ripranimin e një personi i cili është ose shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaj, i cili nuk i plotëson ose i cili nuk i përmbush më kërkesat për hyrje ose qëndrim të aplikueshme në territorin e shtetit kërkues"[235]. Në nenin 7 të *Ligjit për Ripranim*, janë përcaktuar procedurat e procesit të riatdhesimit të cilat duhet të ndiqen.

6.3 Rregullorja nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim

Kjo rregullore, e miratuar në vitin 2010, e bën të detyrueshme për komunat për të vendosur një Zyrë Komunale për Komunitete dhe Kthim, pa marrë parasysh përbërjen etnike të komunës. Rregullorja përcakton mandatin e kësaj zyre duke përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe "krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar"[236], dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës.

6.4 Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009 – 2013

Objektivi i kësaj strategjie është për të siguruar qëndrueshmërinë e kthimit, për ta kuptuar si një proces gjithëpërfshirës që prek apo ndikon të gjitha aspektet e jetës (ekonomike, sociale dhe institucionale) në të gjitha nivelet. Strategjia nxjerr në pah politikat e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim nevojat që duhet të ndiqen në mënyrë që të balancohen dy elemente kryesore: stabiliteti i komuniteteve, dhe procesi i qëndrueshëm i kthimit në Kosovë. Strategjia trajton vizionin e përgjithshëm për një Kosovë shumetnike dhe demokratike, ku të drejtat e barabarta janë mbështetur me sukses.[237] Kjo Strategji synon të krijojë kushte të volitshme për kthim të qëndrueshëm dhe integrimin e komuniteteve pakicë në shoqërinë kosovare, duke përfshirë: "forcimin e të drejtave të komuniteteve dhe sigurimin e zbatimit të Ligjit aktual për Mbrojtjen dhe Promovimin e Komuniteteve, [dhe] sigurimin e qasjes për pjesëtarët e

[233] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.
[234] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 156.
[235] Ligji për ripranim, Nr. 03/L –208, neni 1.
[236] Rregullorja Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, neni 2.
[237] Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009-2013

komuniteteve në shërbime publike."[238] Prioritetet kryesore të strategjisë janë: "përmirësimi i kapaciteteve për zhvillimin dhe zbatimin e ligjeve, rregulloreve, dhe standardeve në lidhje me sigurinë, arsimin, shëndetësinë dhe shërbimet sociale, si dhe përdorimin e gjuhës, ngritjen e vetëdijes në mesin e anëtarëve të komunitetit në lidhje me vlerat e një shoqërie shumetnike, demokratike, të begatë dhe të barabartë; dhe për të siguruar përfaqësimin e barabartë të të gjitha komuniteteve në jetën publike" [239].

Strategjia përcakton tri kategori të të kthyerve në Kosovë, procesi i kthimit të të cilëve dhe institucionet përgjegjëse ndryshojnë shumë:

> "a) Kthimi spontan (Individual): Individët, familjet ose grupet të cilët janë kthyer pa ndonjë paralajmërim paraprak dhe nuk kanë marrë ndonjë ndihmë materiale para se të kthehen ose nuk kanë planifikuar kthimin e tyre më parë.
>
> b) Kthimi i asistuar: Bazuar në kërkesat individuale nga personat e zhvendosur, familjet ose grupet relativisht të vogla të të kthyerve, ku asistenca është siguruar para, gjatë dhe pas kthimit zakonisht nga komunat ose OJQ-të nëpërmjet programeve tashmë të krijuara.
>
> c) Kthimi i detyruar (Dëbim): Individët, familjet, grupet, statusi i refugjatit të të cilëve u hodh poshtë në vendet e treta (ky lloj i kthimit është nën ombrellën e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Zyrës së Kryeministrit)" [240].

Për më tepër, Strategjia përcakton pesë prioritete me qëllim të forcimit të procesit të kthimit, drejtuar kryesisht në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim:

> 1) Krijimin e një mekanizmi për të përmirësuar dhe lehtësuar procesin e kthimit;
>
> 2) Themelimin e një mekanizmi për të informuar më mirë të kthyerit në lidhje me kushtet e jetesës në Kosovë;
>
> 3) Ofrimi i një pakoje të plotë (gjithëpërfshirëse) ndihmëse për të kthyerit, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
>
> 4) Rritja e numrit të të kthyerve që marrin asistencë dhe përqendrimi për të ndihmuar familjet që janë të zhvendosur dhe jetojnë në qendra kolektive në mënyrë që të gjenden zgjidhje afatgjata; dhe
>
> 5) Promovimi i zonave urbane për rivendosjen (zonat/lagjet në të cilat shkollat, objektet shëndetësore dhe infrastruktura të tjera janë më lehtë të qasshme.[241]

[238] Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009-2013, III
[239] Ibid., faqe 20.
[240] Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009-2013, IV
[241] Ibid.

6.5 Strategjia e Rishikuar e Kosovës për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar

Në maj 2010, Qeveria e Kosovës zyrtarisht miratoi Strategjinë e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe më vonë atë vit (2010) Qeveria gjithashtu ka hartuar dhe miratuar një Plan Veprimi për të siguruar zbatimin e Strategjisë. Kjo strategji përcakton politikën e Kosovës për riintegrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë dhe është një rishikim i strategjisë origjinale në këtë fushë të politikës, të miratuar nga Qeveria e Kosovës në tetor 2007. Strategjia mbulon disa fusha, duke përfshirë ndihmën gjatë pranimit fillestar, qasjen në dokumente civile, koordinimin ndërmjet ministrive, mbështetje për grupet e rrezikuara, strehim dhe çështjet pronësore, si dhe mekanizmat e koordinimit për Strategjinë. Rekomandimet kryesore të Strategjisë janë:

> "A. Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Riatdhesim dhe Gjendje Civile
> B. Ndryshimi i strategjisë dhe planit të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar, duke siguruar që rekomandimet nga ky vlerësim janë marrë parasysh.
> C. Negocimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale për riatdhesim me BE (*en-bloc*) ose individualisht me shtetet anëtare të BE;
> D. Krijimi i një fondi fillestar për riintegrimin e personave të riatdhesuar, të jetë i përbërë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe nga donatorë potencial;
> E. Ngritja e Kapaciteteve Institucionale dhe Njerëzore në nivelin qendror dhe lokal për të trajtuar këtë proces në mënyrë më efektive;
> F. Përmirësimi i komunikimit dhe koordinimit ndër-institucional në nivel qendror dhe lokal me qëllim eliminimin e mangësive;
> G. Përmirësimi i komunikimit me shtetet kërkuese, në veçanti këmbimin bilateral të informacionit për personat potencial për tu riatdhesuar në Kosovë".[242]

6.6 Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane

Personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV), refugjatët, të kthyerit, dhe të riatdhesuarit përballen me sfida të vazhdueshme për të drejtat e tyre dhe mirëqenien në Kosovë. Ky seksion do të merret më konkretisht me të drejtat themelore të identitetit ligjor, përfaqësimit politik dhe qasjes së barabartë në drejtësi, banim dhe të drejta pronësore, nevojat socio-ekonomike dhe nevojat themelore, dhe integrimin në shoqëri. Këto aspekte nuk janë të pavarura nga njëra-tjetra, por janë shpesh të ndërthurura shumë: përpjekja e suksesshme e bërë nga autoritetet në një fushë mund të ndikojnë pozitivisht në një tjetër, dhe dështimet mund të ndikojnë në përparimet e bëra në vende/aspekte të tjera. Ndërsa Konventa e Kombeve të Bashkuara e vitit 1951 e lidhur me Statusin e Refugjatëve është instrument autoritar i së drejtës ndërkombëtare mbi refugjatët, aktualisht nuk ka asnjë ekuivalent universal, ligjërisht i detyrueshëm për të zhvendosurit dhe të kthyerit. Megjithatë, meqë personat e zhvendosur në veçanti janë bërë një çështje shqetësuese për komunitetin ndërkombëtar, OKB-ja ka hartuar një sërë Parimesh Udhëzuese mbi zhvendosjen e brendshme. Ky dokument mund të shihet si zgjerim i Konventës së vitit 1951. Duhet të përmendet se asnjë nga marrëveshjet ndërkombëtare të përmendura më lart nuk janë ligjërisht të detyrueshme për Kosovën. Megjithatë, ato paraqesin standarde të rëndësishme të njohura ndërkombëtarisht lidhur me këtë çështje.

[242] Strategjia e Rishikuar e Kosovës për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, maj 2010, faqe 6.

Meqë kufijtë midis personave të zhvendosur (PZHBV), refugjatëve, të kthyerve dhe riatdhesuarve janë shpesh të paqartë, dhe duke pasur parasysh faktin se, siç shpjegohet më sipër, dispozitat e ligjeve ndërkombëtare nuk mbulojnë plotësisht personat e zhvendosur, të kthyerit dhe të riatdhesuarit, shumë nene të përmendura këtu e tutje do të zbatohen me qëllim përtej grupeve të tyre të synuara. Lidhur me të riatdhesuarit, autoritetet e Kosovës kanë nënshkruar marrëveshje me disa vende, duke përfshirë Belgjikën, Austrinë, Suedinë, Zvicrën dhe Gjermaninë, që kanë të bëjnë me riatdhesimin e individëve, kryesisht shqiptarë të Kosovës dhe pjesëtarë të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë.[243] Në mungesë të njohjes së tyre si refugjatë nga instrumentet e lartpërmendura të së drejtës ndërkombëtare, të riatdhesuarit shpesh përjetojnë një situatë po aq problematike pas kthimit në Kosovë dhe për këtë arsye do të përfshihen këtu. Në të vërtetë, një aparat jo i plotë së drejtës ndërkombëtare nuk duhet të çojë në dështim në ofrimin e mbrojtjes sipas së drejtës ndërkombëtare për të gjithë njerëzit jetët e të cilëve janë prekur nga zhvendosja.

Të drejtat themelore

Të zhvendosur, refugjatët, të kthyerit dhe të riatdhesuar janë veçanërisht të rrezikuar nga diskriminimi dhe kërcënimet ndaj të drejtave të tyre themelore, veçanërisht të drejtave të tyre për një identitet ligjor, për të sjellë ankesat e tyre para drejtësisë, dhe të marrin pjesë në jetën politike dhe të zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Përveç ndalimit të diskriminimit i përmbajtur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Parimet udhëzuese përcaktojnë se "personat e zhvendosur të cilët janë kthyer në shtëpitë e tyre apo vendet e banimit të përhershëm apo të cilët janë rivendosur në një pjesë tjetër të vendit nuk do të diskriminohen si pasojë e të qenit të zhvendosur"[244], duke përfshirë të drejtat e tyre për lirinë e shprehjes, fenë dhe opinionin, punësimin dhe aktivitetin ekonomik, si dhe të drejtën të komunikojnë në gjuhën e tyre.

Hapi i parë për t'u siguruar që personat e zhvendosur, refugjatët, të kthyerit, dhe të riatdhesuar mund në mënyrë efektive të mbrojnë të drejtat e tyre është sigurimi i njohjes së tyre para ligjit. Për këtë qëllim, u kërkohet autoriteteve që t'u "lëshojnë atyre të gjitha dokumentet e nevojshme për gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave të tyre ligjore, të tilla si pasaportat, dokumentet personale të identifikimit, certifikatat e lindjes dhe të martesës"[245]. Një dispozitë e veçantë është bërë për të theksuar barazinë e grave dhe burrave në qasje në dokumente personale dhe të drejtën e tyre që ato të lëshohen në emrat e tyre[246]. Në thelb (para së gjithash), kjo do të thotë se personat e zhvendosur, refugjatët, të kthyerit, dhe të riatdhesuar nuk janë thjesht marrës pasiv të të drejtave, por aktorë që mund dhe duhet të "marrin pjesë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë në çështjet publike në të gjitha nivelet dhe të kenë qasje të barabartë në shërbimet publike"[247].

[243] Për një listë të marrëveshjeve të tilla, konsultoni/klikoni: http://romarights.files.wordpress.com/2010/04/kosovo_readmission_agreements.pdf
[244] Parimi 29(1) I Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit;
[245] Parimi 20 (2) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit;
[246] Parimi 20 (3) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit;
[247] Parimi 29 (1) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit;

Të Drejtat pronësore dhe banesore

PZHBV-të, refugjatët, të kthyerit, dhe të riatdhesuar janë përballur shpesh me vështirësi të mëdha në shprehjen dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre për të rimarrë pronën e tyre apo për të marr kushte themelore të jetesës. Parimet Udhëzuese për Zhvendosjen e Brendshme theksojnë se "çdo qenie njerëzore ka të drejtë për t'u mbrojtur kundër zhvendosjes së tij/saj në mënyrë arbitrare nga shtëpia e tij/saj ose nga vendbanimi i përhershëm"[248]. Megjithatë, në qoftë se ngjarje të mëdha dhe të pakontrollueshme, të tilla si lufta, fatkeqësi emergjente apo natyrore, shkaktojnë, zhvendosje "prona dhe pasuria e personave të zhvendosur në të gjitha rrethanat duhet të mbrohet [...] kundër akteve si në vijim: grabitjes; sulmeve direkt ose pa dallim apo akteve të tjera të dhunës; [...] duke u bërë objekt për masë ndëshkimore, dhe duke u shkatërruar, ose duke u përvetësuar si formë e dënimit kolektiv"[249]. Prona e tyre duhet gjithashtu të "mbrohet nga shkatërrimi dhe përvetësimi arbitrar dhe të paligjshëm, pushtimi ose përdorimi"[250], një çështje kjo me të cilën përballen shumë PZHBV, refugjatë, të kthyer, dhe riatdhesuar pas kthimit në shtëpitë e tyre. Nuk duhet të ketë fitim ekonomik apo përparësi të çdo lloji nga akti i shpërnguljes së njerëzve apo nga pasuritë e tyre, dhe "kur rikthimi i këtyre pronave dhe pasurive nuk është i mundur, autoritetet kompetente do të sigurojnë ose të ndihmojnë këta persona në marrjen e kompensimit të duhur ose ndonjë tjetër formë e rimbursimit të drejtë"[251]. Dispozita të ngjashme janë bërë në Protokollin ligjërisht të detyrueshëm të Bashkimit Afrikan në Mbrojtje dhe ndihmë për personat e zhvendosur brenda vendit.

Siguria dhe nevojat themelore

Dispozitat e sipërpërmendur të ligjit ndërkombëtar në të vërtetë tashmë kishin qenë të hartuara me qëllim të përmirësimit konkret të, mirëqenies së personave të zhvendosur, refugjatëve, të kthyerve, dhe të riatdhesuarve. Por, meqë nevojat për sa i përket sigurisë, çështjeve socio-ekonomike dhe nevojave themelore janë shpesh çështje të ngutshme për këto kategori, ne do të përmendim këtu disa dispozita specifike që ilustrojnë rëndësinë e standardeve themelore të jetesës, si një kusht për integrimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë: "në minimum, pavarësisht nga rrethanat, dhe pa diskriminim, autoritetet kompetente do t'u sigurojnë personave të zhvendosur qasje të sigurt në: ushqim thelbësor dhe ujë të pijshëm, strehim themelor dhe banim; veshje të përshtatshme, dhe shërbime themelore mjekësore dhe sanitare"[252]. Këtu, "përpjekje të veçanta duhet të bëhen për të siguruar pjesëmarrjen e plotë të grave në planifikimin dhe shpërndarjen e këtyre furnizimeve bazë"[253].

Krahas kushteve themelore të jetesës, shëndeti fizik dhe psikologjik është një fushë e shqetësimit të madh: "të gjithë PZHBV-të e plagosur dhe të sëmurë si dhe ata me aftësi të kufizuara do të marrin në masë të plotë dhe me sa më pak vonesë që të jetë e mundur, kujdesin mjekësor dhe vëmendje, që u duhet, pa asnjë dallim për ndonjë arsye tjetër se sa ato mjekësore. Kur është e nevojshme, personat e

[248] Parimi 6 (1) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit;
[249] Parimi 21 i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit;
[250] Parimi 20 (3) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit;
[251] Parimi 29 (2) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit;
[252] Parimi 29 (2a-d) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit
[253] Parimi 18 (3) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit

zhvendosur do të kenë qasje në shërbimet psikologjike dhe sociale"[254]. Dimensioni gjinor i kujdesit shëndetësor është theksuar më tej, duke theksuar se "vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet nevojave shëndetësore të grave, duke përfshirë qasjen tek ofruesit e kujdesit shëndetësor për femra dhe shërbime, të tilla si kujdesi shëndetësor riprodhues, si dhe këshillimi i përshtatshëm për viktimat e keqtrajtimit seksual dhe abuzimeve të tjera"[255].

Integrimi në shoqëri

Sigurimi i integrimit afatmesëm deri afatgjatë i personave të zhvendosur në shoqëri është një detyrë e vështirë që përfshin një rrjet të gjerë të masave, duke filluar nga ofrimi i arsimit dhe shëndetësisë deri te nxitja e aktivitetit ekonomik dhe pjesëmarrjes politike. Autoritetet kombëtare kanë "detyrë parësore dhe përgjegjësi për të krijuar kushtet, si dhe të sigurojnë mjetet, të cilat u lejojnë personave të zhvendosur të kthehen vullnetarisht, në siguri dhe me dinjitet, në shtëpitë e tyre apo vendbanimet e përhershme, ose të rivendosen vullnetarisht në një pjesë tjetër të vendit. Këto autoritete do të përpiqen për të lehtësuar riintegrimin e PZHBV-ve të kthyer apo të rivendosur"[256].

Sa i përket arsimit, Parimet Udhëzuese u kërkojnë autoriteteve të "sigurojnë që personat e tillë, në veçanti fëmijët e zhvendosur, të marrin arsim i cili duhet të jetë falas dhe i detyrueshëm në nivelin fillor. Arsimi duhet të respektojë identitetin kulturor, gjuhën dhe fenë"[257], dhe të lejojë "participim të plotë dhe të barabartë të grave dhe vajzave"[258]. Për më tepër, shteti duhet të ndërmarr hapa për të lehtësuar njohjen e arsimit të fituar më parë: "vështirësitë praktike të hasura nga përfituesit e mbrojtjes së statusit të refugjatit ose statusit të mbrojtjes plotësuese lidhur me legalizimin e diplomave të tyre të arritura/fituara ne vende te treta, certifikatave apo dëshmive të tjera të kualifikimit formal duhet të merren në konsideratë."[259]

Konventa e vitit 1951 thekson se të drejta të ngjashme për refugjatët në lidhje me kujdesin shëndetësor, arsimin, mirëqenien sociale dhe qasjen në punësim, të drejta që duhet të jenë të barabarta me ato të shtetasve, apo at të drejta që zakonisht u jepet të huajve në një situatë të ngjashme.[260] Fuqizimi i popullatës së zhvendosur në procesin e tyre të rivendosjes, që do të thotë tu besohet atyre sa më shumë që të jetë e mundur vendim-marrje për çështjet që ndikojnë drejtpërsëdrejti tek ata, është parë si një rrugë e nevojshme drejt integrimit: "përpjekje të veçanta duhet të bëhen për të siguruar pjesëmarrjen e plotë të PZHBV-ve në planifikimin dhe menaxhimin e kthimit të tyre ose të rivendosjes dhe riintegrimit."[261]

[254] Parimi 19 (1) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit
[255] Parimi 19 (2) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit
[256] Parimi 28 (1) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit
[257] Parimi 23 (2) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit
[258] Parimi 23 (3) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit
[259] Konsiderata Nr. 32 e Direktivës së Këshillit 2004/83/EC e datës 29 prill 2004 për standardet minimale për kualifikimin dhe statusin e shtetasve të vendeve të treta apo personave pa shtetësi si refugjatë ose si persona të cilët përndryshe kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë.
[260] Nenet 26-29 të Konventës së Kombeve të Bashkuara lidhur me Statusin e Refugjatëve
[261] Parimi 28 (2) i Parimeve Udhëzuese të KB-së për zhvendosjen brenda vendit

6.7 Konkluzione dhe rekomandime

Gjatë viteve të fundit Kosova ka nënshkruar disa marrëveshje riatdhesimi me vendet europiane. Për më tepër, procesi i riatdhesimit ka qenë i lidhur me procesin drejt liberalizimit të vizave, dhe ka përfunduar kështu deri në krye të prioriteteve të politikës së Kosovës. Megjithatë, disa çështje me interes meritojnë të përmenden. Së pari, edhe OSBE-ja edhe UNICEF-it kanë vërejtur **se përgjigjja e komunave, aktorëve kryesorë në procesin e kthimit, ka qenë e pabarabartë dhe shpesh e pamjaftueshme ose joadekuate.**[262] Për më tepër, UNICEF-i ka raportuar **se riatdhesimi i romëve, ashkalive dhe egjiptasve ka efekte të dëmshme në edukimin e tyre,** me një shumicë të fëmijëve që braktisin shkollën pas riatdhesimit të tyre,[263] ndërsa OSBE-ja thekson se, ndonëse fondet e mjaftueshme janë ndarë për të mbështetur personat e riatdhesuar, kjo në shumicën e rasteve ende nuk ka rezultuar në "veprime dhe iniciativa konkrete".[264] Në dritën e këtyre gjetjeve, Kosova seriozisht duhet të rishqyrtojë politikën e saj të riatdhesimit, veçanërisht lidhur me fëmijët e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë dhe duhet të përmirësojë rolin e komunave në procesin e kthimit dhe riatdhesimit.

Në ndërkohë, procesi i kthimit vullnetar po vazhdon me një ritëm të ngadaltë por të qëndrueshëm me dhe 2261 pjesëtarë të komuniteteve minoritare janë kthyer në vitin 2010.[265] Komisioni Evropian ka identifikuar çështjet e mëposhtme si pengesat kryesore për procesin e kthimit të qëndrueshëm "Qasja e kufizuar në pronë, procedurat e vonuara për kthimin e pronave dhe mundësitë e pakta ekonomike."[266] OSBE Kosovo gjithashtu përmend ndikimin negativ në procesin e kthimit vullnetar të "plaçkitjes së shpeshtë të pronave të pabanuara të personave të kthyer, dëmtimit të objekteve të rëndësishme fetare ose kulturore dhe ngacmimit rastësor të nivelit të ulët të të kthyerve".[267]

[262] Përgjigjet e komunave për zhvendosjen dhe kthimin në Kosovë, misioni i OSBE-së në Kosovë, nëntor 2010 & Integrimi Temë për Kushtet: Një raport për situatën e romëve, ashkalive dhe egjiptasve të Kosovës në Gjermani dhe pas riatdhesimit të tyre në Kosovë, zyra e UNICEF-it në Kosovë, 2010;

[263] Integrimi temë për kushtet: raport mbi situatën romëve, ashkalive dhe egjiptasve të Kosovës në Gjermani dhe pas riatdhesimit të tyre në Kosovë, Zyra e UNICEF-it në Kosovë, 2010;

[264] OSBE Kosovo, *Vlerësimi i progresit në zbatimin e kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës*, Shtator 2011.

[265] Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2010;

[266] Ibid.

[267] OSBE Kosovo, *Një vlerësim i procesit të kthimit vullnetar në Kosovë*, Tetor 2012.

CHAPTER 7. Institucionet

7.1 Institucionet e nivelit qendror

7.1.1 Ministria e Drejtësisë

Misioni i Ministrisë së Drejtësisë është që të sigurojë që sistemi gjyqësor i Kosovës të funksionojë në mënyrë efikase, të pavarur dhe të paanshme, dhe të jep siguri dhe drejtësi të barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ministria e Drejtësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, është e detyruar që të trajtojë të paraburgosurit, të burgosurit, viktimat e dhunës, viktimat e trafikimit, dhe dëshmitarët me profesionalizëm dhe dinjitet. Roli i saj është hartimi i legjislacionit në pajtim me Kushtetutën e Kosovës, harmonizimi i ligjeve të Kosovës me standardet e BE-së, zhvillimi i bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, dhe lehtësimi i qasjes në institucionet e drejtësisë për pjesëtarët e komuniteteve pakicë.[268]

Departamenti për Çështje Ligjore

Departamenti për Çështje Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë është përgjegjës për të siguruar që të gjitha projektligjet dhe aktet e tjera ligjore të Kosovës, janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së. Për më tepër, Departamenti është përgjegjës për hartimin dhe ndryshimin e ligjeve të rëndësishme për sistemin gjyqësor të Kosovës dhe dorëzimin e këtyre projektet në qeveri për miratim. Strategjia Legjislative Vjetore e Kosovës përcakton se në cilat ligje specifike punon çdo vit Departamenti për Çështje Juridike.[269]

Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, është një njësi e fokusuar posaçërisht në ofrimin e ndihmës për viktimat e dhunës në familje, në formën e informacionit, mbështetjes për sa i përket qasjes në sistemin e drejtësisë dhe, nëse është e nevojshme, masat e sigurisë. Divizioni gjithashtu synon të krijojë një rrjet të Mbrojtësve të Viktimave (MV-ve) në tërë Kosovën për të mbështetur viktimat gjatë përfshirjes së tyre në procesin e drejtësisë.[270]

7.1.2 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e punës dhe politikave të mirëqenies sociale në Kosovë. Mandati i saj mbulon një gamë të gjerë aktivitetesh, duke përfshirë:

- Zhvillimin e punës dhe politikave të mirëqenies sociale dhe hartimin dhe zbatimin e legjislacionit në këto fusha;

[268] Faqja e internetit e Ministrisë së Drejtësisë: http://www.md-ks.org/?page=2,157
[269] Faqja e internetit e Ministrisë së Drejtësisë: http://www.md-ks.org/?page=2,27
[270] Faqja e internetit e Ministrisë së Drejtësisë: http://www.md-ks.org/?page=2,49

- Përkrahjen dhe promovimin e marrëdhënieve jo-diskriminuese të punës dhe procedurave e punësimit;
- Propozimin e masave për rritjen e punësimit dhe zvogëlimin e papunësisë dhe të propozojë masa për të përmbushur nevojat e ndihmës sociale të qytetarëve në nevojë;
- Mbështetjen e politikave dhe praktikave të punës për mbrojtjen e familjeve dhe të miturve;
- Vendosjen e standardeve të sigurisë në punë dhe mbrojtjen në punë dhe të mbikëqyr implementimin e tyre;
- Zhvillimin dhe mbikëqyrjen e programeve për trajnim profesional për personat e papunësuar dhe ata që kërkojnë punë;
- Sigurimin e ndihmës financiare për familjet dhe individët në nevojë;
- Administrimin dhe mbështetjen e zhvillimit të sistemit të sigurimit social, duke përfshirë pensionet dhe përfitimet e papunësisë;
- Ofrimin e mbështetjes financiare dhe sociale, urgjente dhe të përhershme, nëpërmjet institucioneve dhe shërbimeve të themeluar për këtë qëllim për qytetarët në nevojë[271].

Departamenti i Mirëqenies Sociale

Nën ombrellën e MPMS-së, Departamenti i Mirëqenies Sociale (DMS) ka mandat për të zhvilluar legjislacion të ri dhe të vendosur standardet e duhura në lidhje me shërbimet sociale dhe mbrojtjes, dhe për të mbështetur grupet financiarisht të rrezikuara duke përdorur kritere legjitime dhe transparente. Misioni i DMS-së është për të zbutur varfërinë dhe të ofrojë shërbime sociale dhe përkujdesje institucionale për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim etnie apo besimi, me një fokus për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit. Nën këtë deklaratë misioni, objektivat kryesore të DMS-së janë si më poshtë:

- Ofrimi i ndihmës për familjet në nevojë, duke përcaktuar kriteret e përshtatshmërisë, natyrën dhe nivelin e kësaj ndihme;
- Zhvillimi i politikave sociale duke u bazuar në situatën aktuale në Kosovë dhe standardet ndërkombëtare të mbrojtjes sociale;
- Ritja e cilësisë së shërbimeve sociale dhe zhvillimi i strategjive, politikave dhe standardeve për shërbimet sociale në Kosovë;
- Ritja e bashkëpunimit midis institucioneve profesionale, OJQ-ve, dhe palëve të tjera të interesuara për përmirësimin e shërbimeve sociale për qytetarët;

[271] Faqja e internetit e MPMS: http://mpms.rks-gov.net/sq-al/linqe/rethmpms.aspx

- Përparimi i shërbimeve dhe kujdesi për të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara intelektuale, duke u ofruar atyre strehim dhe kushte të mira jetese në institucione të tilla si: Shtëpi të Pleqve, Institucionin special në Shtime, dhe shtëpi të komunitetit[272].

DMS synon që në të ardhmen të zhvillojë më tej politikat sociale për mbrojtjen dhe avancimin e interesave të grupeve në nevojë nëpërmjet masave konkrete:

- Zbatimi i *Ligjit për Ndihmën Sociale* dhe modifikimin i kritereve të përshtatshmërisë për ndihmë sociale për të siguruar ofrimin e saktë të saj për grupet më të pa-favorizuara shoqërore dhe ekonomike;
- Zhvillimi i infrastrukturës sociale dhe strehimi i përkohshëm për grupet e pambrojtura, sidomos fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara;
- Sigurimi i mundësive të barabarta për të gjithë banorët e Kosovës (në shërbimet sociale, pagesat nëpërmjet Qendrës Sociale të Punës, dhe komuna) dhe lufta kundër diskriminimit;
- Zhvillimi i teknologjive të informacionit dhe të komunikimit, monitorimin e transferove financiare, transparencës, dhe efikasitetit;
- Zhvillimi dhe aftësimi i personelit në administratë dhe në institucionet e DMS-së.

7.1.3 Ministria për Komunitete dhe Kthim

MKK ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të grupeve të pakicave dhe të kthyerve, duke përfshirë të drejtën e kthimit, siç përcaktohet në nenet 3 dhe 4 të Kushtetutës së Kosovës. Mandati i saj mbulon një gamë të gjerë aktivitetesh, duke përfshirë me sa vijon:

- Krijimin e kushteve të favorshme për një proces të kthimit të qëndrueshëm, duke promovuar besimin, dialogun dhe pajtimin në mes të komuniteteve përmes strategjive dhe programeve të ndryshme;
- Të sigurojë që politikat në nivel qendror dhe në nivel lokal përmbajnë dispozita për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, të drejtave të njeriut dhe interesave të të kthyerve, duke përfshirë lëvizjen e lirë, përdorimin e gjuhëve të pakicave, lirinë e shprehjes, përfaqësimin e barabartë, qasjen në gjykata, të drejtave të strehimit, dhe shërbimeve të tjera vendore;
- Ofrimin e udhëzimeve për koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve të ministrive, komunave dhe organeve të tjera që synojnë mbrojtjen dhe avancimin e interesave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, dhe siç kërkohet, nën autoritetin e Kryeministrit, shqyrtimin e praktikave, dokumenteve dhe arkivave të këtyre organeve;
- Monitorimin dhe mbështetjen e përpjekjeve të komunave për të zgjidhur çështjet e të kthyerve, për të siguruar këshilla për zyrat komunale për komunitete, dhe zhvillimin e strategjive komunale për të kthyerit;
- Bashkëpunimin me Ministritë, Komunat dhe organet e tjera për të adresuar procesin e kthimit dhe nevojat humanitare të lidhura, dhe zbatimin e *Strategjisë për të Drejtat e Njeriut*;
- Ngritja e vetëdijes/ndërgjegjësimit publik për të drejtat e pakicave, përfshirë të drejtën për t'u kthyer[273].

[272] Faqja e internetit e MPMS http://mpms.rks-gov.net//

7.1.4 Zyra për Qeverisje të Mirë

Duke vepruar nën Zyrën e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore ka kryesisht rol këshillëdhënës dhe monitorues vis-à-vis ministrive të përfshira në çështjet e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta, dhe çështjeve gjinore. Mandati i saj është i gjerë, duke përfshirë me sa vijon:

- Shqyrtimin e draft-Legjislacionit të përgatitur nga dega e ekzekutivit për pajtueshmëri me standardet e aplikueshme të te drejtave të njeriut dhe të praktikave të qeverisjes së mirë në bashkëpunim me Zyrën e shërbimeve për ndihmë juridike, dhe të i ofrojë këshilla dhe rekomandime Kryeministrit dhe ministrive përkatëse në përputhje me rrethanat;
- Shqyrtimin e politikave të ekzekutivit, procedurave dhe praktikave për përputhje me standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut, praktikave të qeverisjes së mirë dhe mundësive të barabarta, dhe të i ofrojë këshilla dhe rekomandime Kryeministrit dhe ministrive përkatëse në përputhje me rrethanat;
- Ndihmon në zhvillimin dhe zbatimin e fushatave të informimit publik dhe skemave të tjera reklamuese për të nxitur ndërgjegjësimin publik për standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, transparencën në qeverisje, barazinë gjinore, mundësitë e barabarta dhe parime të tjera të bazuara në qeverisje demokratike;
- Konsultohet me përfaqësuesit e komunitetit dhe zhvillon organe konsultative sipas nevojës, për të adresuar qeverisjen e mirë, të drejtat e njeriut, mundësitë e barabarta dhe çështjet gjinore;
- Lehtëson zhvillimin e politikave të ndjeshme gjinore dhe punon për avancimin e statusit të grave, në bashkëpunim me shoqërinë civile;
- Monitoron aktivitetet kundër mashtrimit dhe korrupsionit në degën ekzekutive dhe nxit/promovon vetëdijesimin kundër mashtrimit;
- Promovon vendimmarrjen demokratike dhe konsultimin me bazë të gjerë brenda qeverisë;
- Inkurajon pjesëmarrjen e publikut në qeverisje;
- Nxjerr vërejtje dhe rekomandime;
- Shqyrton, sipas nevojës, dosjet dhe dokumentet e Qeverisë në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësive të zyrës, varësisht nga autorizimi i Kryeministrit[274].

ZQM/ZKM kryen përgjegjësitë dhe funksionet e saj në përputhje me direktivën administrative të UNMIK-ut Nr. 2004/7 të datës 22 prill, 2004 për zbatimin e Rregullores Nr.2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes[275].

7.1.5 Zyra për Çështje të Komuniteteve

